



Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave

Komuna e Deçanit
2021-2025

Në bashkëpunim me:

Green Art Center - Prishtina "GAC"

2020

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE NGA KRYETARI I KOMUNËS	7
SHKURTESAT	8
PËRKUFIZIMET E MBETURINAVE	9
1 HYRJE DHE KONTEKSTI PËR MENAXHIM TË INTEGRUAR TË MBETURINAVE KOMUNALE	11
1.1 Hartimi i planit lokal për menaxhim të integruar të mbeturinave	11
1.2 Metodologjia	12
2 POLITIKAT, STRATEGJIA DHE KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE	12
2.1 Baza ligjore dhe instrumentet juridik për menaxhim të mbeturinave	12
2.2 Principet e menaxhimit të mbeturinave	13
2.3 Kuadri ligjor në Kosovë mbi mbeturinat	14
2.4 Rolet dhe përgjegjësitë	14
3 ASPEKTI INSTITUCIONAL	16
3.1 Organizimi në nivel qendror	16
3.2 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave në nivel komune	16
4 KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS	20
4.1 Përshkrim i përgjithshëm i komunës	20
4.2 Vlerat natyrore dhe turistike	21
4.3 Infrastruktura rrugore	22
4.4 Aspekti socio – ekonomik	22
4.5 Gjendja e përgjithshme mjedisore	24
5 KONTEKSTI LOKAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE	25
5.1 Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave në komunë	25
5.2 Mbuleshmëria me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave	26
5.3 Forma e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave urbane	26
5.4 Përmbledhje e gjetjeve në menaxhim mbeturinash	27
5.5 Riciklimi i mbeturinave	28
5.6 Kompostimi	28
5.7 Administrimi i mbeturinave të vëllimshme dhe rrymave tjera	28
5.8 Deponimi i mbeturinave	29
5.9 Shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shërbime tjera mirëmbajtjeje	29
5.10 Mjetet për ofrimin e shërbimit	29
5.11 Financat dhe të hyrat financiare	30
5.12 Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga vlerësimi i gjendjes fillestare	32
5.13 Nevojat dhe prioritetet	32
6 PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE KOMUNALE	34
6.1 Planifikimi strategjik dhe vizioni	34
6.2 Objektivat Objektivat dhe Rezultatet e PMIM	35
7 VLERËSIMI DHE ANALIZA E PËRBËRJES SË MBETURINAVE KOMUNALE	40
7.1 Kriteret për planifikim	40
7.2 Gjenerimi i mbeturinave	40
7.3 Përbërja e mbeturinave në komunën e Deçanit	42
7.4 Projektioni i rritjes së mbeturinave 2020 – 2025	45
8 PLANI PËR MINIMIZIMIN E MBETURINAVE	48
8.1 Riciklimi i mbeturinave	49

8.2	Programe për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave	51
8.3	Planifikimi dhe integrimi i sistemeve për ndarje në burim	51
8.3.1	Ndarja në burim e mbeturinave të riciklueshme përmes sistemit parësor	51
8.3.2	Ndarja në burim e mbeturinave të riciklueshme përmes sistemit dytësor	53
8.4	Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave organike - kompostimi i mbeturinave	58
8.5	Menaxhimi i mbeturinave voluminoze dhe ndërtimore	63
9	ZHVILLIMI I PLANIT PËR MENAXHIM TË INTERGUAR TË MBETURINAVE	64
9.1	Alternativa e përkohshme për reduktimin e mbeturinave komunale	64
9.2	Alternativa e qëndrueshme për reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale	65
9.3	Organizimi i shërbimit të qëndrueshëm për mbeturinat të vëllimshme dhe mbetjeve jourbane	67
10	RI-ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE DHE NË NIVEL KOMUNAL	71
10.1	Plani financiar i shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve	74
10.2	Kosto operative të shërbimit	75
10.3	Kosto kapitale	76
10.4	Kostot investive për realizimin e PMIM	79
11	PLANIFIKIMI I MBULIMIT TË KOSTOVE	85
12	KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL	88
12.1	Rregullorja komunale	88
12.2	Zbatimi i rregullores dhe sanksionet	89
12.3	Licencimi mjedisor	89
12.4	Pjesëmarrja e sektorit privat	89
12.5	Mbështetja politike	90
13	NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK	90
13.1	Metoda për komunikim dhe informim	90
13.2	Pjesëmarrje qytetare	91
14	PLAN VEPRIMI	91

LISTA E FIGURAVE

Fig. 1: Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave	13
Fig. 2: Struktura organizative e komunës së Deçanit	17
Fig. 3: Struktura organizative e NPL "Higjiena"	18
Fig. 4: Harta e Pozitës gjeografike të komunës së Deçanit	20
Fig. 5: Orari i operimit (referent 2019-2020)	26
Fig. 6: Diagrama e përbërjes së mbeturinave (raporti GIZ 2012/ AMMK 2014)	43
Fig. 7: Rritja e sasisë së mbeturinave deri 2025 sipas fraksioneve të gjeneruara në Komunën e Deçanit	47
Fig. 8: Fraksionet e mbeturinave në vit (2020)	48
Fig. 9: Kapaciteti i rritjes së gjenerimit të mbeturinave sipas rrymave të përbërjes	50
Fig. 10: Shporta për fraksione të riciklueshme (letë-karton, plastikë dhe kanaqe)	52
Fig. 11: Zona qendër	55
Fig. 12: Skema praktike të kompostimit në mjedis të hapur për Mbeturinat organike, skemë kompostimi në shtëpi	59
Fig. 13: Skema e organizimi të qendrës në tërësi (Deçan)	64
Fig. 14: Skema e impiantit të kompostimit	66
Fig. 15: Organizimi i hapësirës për dërgimin e mbetjeve të riciklueshme dhe mbetje të vecanta (voluminoze, tro shtëpiake riciklueshme etj) prej kompanisë dhe prej qytetarëve / Plan demonstrative	69
Fig. 16: Skema e menaxhimit të mbeturinave – Skenari 1	71

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Statistika për Komunën e Deçanit	22
Tabela 2. Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve	22
Tabela 3: Numri i klienteve në faturim	25
Tabela 4. Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbeturinave	27
Tabela 5. Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave	29
Tabela 6. Logjistika e operimit për grumbullimin e mbeturinave	30
Tabela 7. Të dhëna lidhur me inkasimin për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, Higjiena	31
Tabela 8. Kostot potenciale të të ardhurave	31
Tabela 9. Objektivi i I sipas PMIM	35
Tabela 10. Objektivi i II sipas PMIM	36
Tabela 11. Objektivi i III sipas PMIM	37
Tabela 12. Objektivi i IV sipas PMIM	38
Tabela 13. Objektivi 5.1 sipas PMIM	39
Tabela 14. Objektivi 5.2 sipas PMIM	39
Tabela 15. Gjenerimi i mbeturinave për banor në komunë të Deçanit referuar sasisë së deponimit (periudhë gjashtë mujore)	41
Tabela 16. Gjenerimi i mbeturinave për periudhë 1 vjeçare në komunën e Deçanit	42
Tabela 17. Përbërja e mbeturinave në komunën e Deçanit sipas gjenerimit	43
Tabela 18. Përbërja e mbeturinave të fraksionit të thata/të riciklueshme	44
Tabela 19. Karakteristikat e përbërjes së deponive ilegale në komunën e Deçanit	44
Tabela 20. Projektioni i Rritjes së popullsisë	45
Tabela 21. Rritja e popullsisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Deçanit gjatë 5 viteve të ardhshme	45
Tabela 22. Rritja e gjenerimit të sasisë vjetore të mbeturinave për kokë banorë	46
Tabela 23. Llojet e mbeturinave vjetore të gjeneruara në Komunën e Deçanit	46
Tabela 24. Përbërja vjetore e mbeturinave të amvisërisë (2020)	47
Tabela 25. Investimi në shporta-infrastrukturë	52
Tabela 26. Lista e institucioneve	55

Tabela 27. Pilotimi për Ndarje në burim të fraksionit të riciklueshëm përmes sistemit me rrjeta metalike	56
Tabela 28. Infrastruktura bazike për ndarje në burim të fraksionit të Riciklueshme (2021-2022)	57
Tabela 29. Zgjerimi I skemës së ndarjes në burim në tërësi territoriale në afate të caktuara (2021-2025)	57
Tabela 30. Kostot e ngritjes së një sistemi të kompostimit shtëpiak.....	59
Tabela 31. Kosto për zhvillimin e aktivitetit për kompostim	61
Tabela 32. Planifikimi i kostove do të përmbledhet në tabelën në vijim sipas fazave	66
Tabela 33. Kostot e përafërta për ndërtimin e qendrës së grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme dhe riciklueshme sipas planit kohor 2022 – 2023	68
Tabela 34. Shpenzime operative	75
Tabela 35. Projektionet e investimeve kapitale	77
Tabela 36. Tabela përmbledhëse e investimit	79
Tabela 37. Projektioni i të hyrave të shërbimit prej MM	86
Tabela 38. Projektioni i të hyrave të shërbimit/Inkasimi	86
Tabela 39. Projektioni i të ardhurave prej skemës së ndarjes në burim në nivel territorial	89
Tabela 40. Kosto referente sipas tregut të shitjes të materialit të riciklueshëm	88
Tabela 41. Plani I Veprimit	92

Parathënie nga Kryetari i Komunës

Të nderuar qytetarë të Komunës së Deçanit,

Plani për Menaxhim të IntegrUAR të MbeturINave komunale është I një rëndësie të veçantë për Komunën e Deçanit. Qëllimi kryesor i këtij plani është krijimi një strategjie për integrim dhe optimizimin e planeve për menaxhim të mbeturinave komunale, me qëllim përmbushjen e objektivave të komunës për maksimizimin e efikasitetit të shërbimit për qytetarë dhe minimizimin e impakteve mjedisore dhe financiare duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës në fushën e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të saj.

Hartimi i planit lokal për menaxhim të integrUAR të mbeturinave është mbështetur në pjesëmarrjen aktive të institucioneve përkatëse lokale dhe atyre qendrore, të komunitetit dhe organizatave joqeveritare.

Realizimi I programeve dhe aktiviteteve të propozuara në plan do t'i referohet mundësive për zhvillim ekologjik të komunës së Deçanit dhe qasjes sistematike dhe gjithëpërfshirëse me implikime aftagjate për jetën e qytetarëve të komunës sonë.

Ky dokument do t'ju shërbejë të gjithë akterëve, institucioneve vendore dhe institucioneve qeveritare të huaja, që të përkrahin në investime në fushën e mjedisit në Komunën e Deçanit dhe zbatimin e planeve që fokusohen në menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave.

Zhvillimi I politikave mjedisore për reduktim, riciklim apo trajtim të duhur të mbeturinave do të nënkuptojë krijimin e mundësive për zhvillimin ekonomik në këtë sektor në nivel komunal dhe nivel vendi si dhe shfrytëzimin sa më racional të resurseve natyrore.

Për realizimin e këtij plani, dua të falënderoj organizatën joqeveritare Green Art Center –Prishtina (GAC) për mbështetje dhe përkrahjen e vazhdueshme profesionale për përmirësim të gjendjes mjedisore në komunën e Deçanit dhe hartimin e planeve konkrete në menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave, me rëndësi të veçantë për komunën tonë.

Ndërkohë, si komunë dhe bashkarisht do të punojmë në vazhdimësi për të krijuar kushte për ruajtjen e mjedisit dhe mbështetjen ndaj iniciativave reduktuese dhe ricikluese.

Kryetari i Komunës

Bashkim Ramosaj

Shkurtesat

AKMM	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjensia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DMSHSHP	Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike
GAC	Green Art Center Prishtina
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit
NPL	Ndërrmarrja publike komunale
MM	Menaxhimi mbeturinave
MIM	Menaxhimi integruar I mbeturinave
PMIM	Plani lokal për menaxhim të interguar të mbeturinave
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
PMMI	Plani lokall i Menaxhimit të Mbeturinave Inerte
SRKMM	Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave

Përkufizimet e Mbeturinave

Përkufizimet që janë përdorur në këtë document janë ato që janë përdorur në Ligjin Nr.2012/04-L-060 për Mbeturinat.

Bio-mbeturinë – mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat engjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit.

Deponi – vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

Deponim përfundimtar i mbeturinave – operimet të cilat ofrojnë zgjidhje përfundimtare për mbeturinat të cilat nuk mund të ripërdoren apo përpunohen, duke mos rrezikuar mjedisin apo shëndetin e njeriut.

Deponim – çdo operim i cili nuk është përpunim, as në rastet kur operimi ka për pasojë sekondare rikuperimin e substancës apo energjisë.

Kompostim – trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit, i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushte të kontrolluara.

Konsumator – personi icili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin eshërbimeve ose merr shërbime tëcaktuara sipas Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinat”, Republika e Kosovës.

Kullim – çdo lëng që rrjedh ose i shpërlarë nga mbeturinat e deponuara dhe që shkarkohet nga deponia ose gjendet brënda deponisë.

Liçenca për menaxhimin e mbeturinave –leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinat”, Republika e Kosovës.

Mbeturinë – substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë.

Mbeturina industriale – mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari të tjera prodhuese.

Mbeturina inerte – mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

i.mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiete tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

ii.i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mbeturina komerciale – mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industrial.

Mbeturina komunale – mbeturina nga amvisëritëdhe mbeturina nga aktivitetet e tjera të cilat,për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Mbeturina medicinale – mbeturina të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale.

Mbeturina të parrezikshme – mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

Mbeturina të rrezikshme – mbeturinat që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme.

Mbeturina të veçanta – mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohentë veçanta.

Mbeturina të vëllimshme – mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

Mbledhje – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.

Mbledhje e ndarë – nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi imbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

Menaxhim i mbeturinave – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.

Parandalim – masat e ndërmarra para se substanca, materiali apo produkti të bëhet mbeturinë, për të redukuar:
I.sasinë e mbeturinës, përfshirë ri-shfrytëzimin e produkteve ose zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve;
li.efektet negative të mbeturinave për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
lii.përmbajtjen e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

Përdorimi mbeturinave – çdo operim, veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar.

Përpunim i mbeturinave – operim, rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet e tjera të cilat përndryshe do të duhej të përdoreshin për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë implant apo në ekonominë e gjerë.

Person – person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

Prodhuesi mbeturinës – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime të tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.

Riciklim – çdo operim i përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substance, qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshin rikthimin e materialeve organike, por nuk përfshin përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave.

Ri-përdorim – çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent, i cili nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar.

Stabilizim i mbeturinës – çdo trajtim i mbeturinës me metodën e caktuar me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Zotëruesi mbeturinës – prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinë.

1. HYRJE DHE KONTEKSTI PËR MENAXHIM TË INTEGRUAR TË MBETURINAVE KOMUNALE

1.1 Hartimi i planit lokal për menaxhim të integruar të mbeturinave

Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave komunale (PMIM) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbeturinave duke harmonizuar me politikën në nivel qendror dhe atë lokal për menaxhimin e mbeturinave komunale.

PMIM mundëson orientimin strategjik për të ardhmen e sektorit për menaxhim të mbeturinave për Komunën e Decanit si edhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis akterëve të ndryshëm në nivel lokal. Plani Lokal i Menaxhimit të Integruar të Mbeturinave (PMIM) është më shumë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e grumbullimit, trajtimit, riciklimit dhe impianteve respektive të trajtimit të mbeturinave në nivel komunal.

Qëllimi i PMIM është parashtrimi i qartë i politikave të menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal, duke harmonizuar interesat e të gjithë akterëve dhe publikut, të cilit ky shërbim i ofrohet për të siguruar një menaxhim më efikas dhe të qëndrueshëm, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme, duke përfshirë impiantet e përshtatshme për trajtimin e mbeturinave sipas llojeve.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare të paracaktuara në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Identifikimin e prioriteteve në sektorin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbeturinave;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standartet e menaxhimit të tyre
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Zhvillojë bashkëpunimin me shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të organizatave joqeveritare, biznesin, ekspertizë të jashtme, duke shpjeguar teknikat specifike që institucionet lokale mund të përdorin, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.

1.2 Metodologjia

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në hartimin e planeve komunale për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave, Komuna Deçanit në partneritet me Green Art Center-Prishtina dhe përmes asistencës teknike të ekspertizës së angazhuar prej Institutit për Zhvillim Të Qëndrueshëm (ISD), u mundësua hartimi i Planit Lokal për Menaxhim të IntegrUAR të MbeturINAVE për Komunën e Deçanit.

Në fazën e parë u themelua grupi i punës me përfaqësues nga zyrtarë të komunës dhe përfaqësues të Green Art Center – Prishtina (GAC). GAC si bashkëpunëtor me Komunën e Deçanit ishte pjesë e zhvillimit të Planit Lokal Menaxhim të IntegrUAR të MbeturINAVE që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që i përshtaten më shumë politikave të Komunës. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e komunës, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan dhe u ranë dakort gjatë takimeve të grupit të punës si edhe janë bazuar dhe harmonizuar me prioritetet e Komunës në Kuadër të planit për menaxhim të mbeturinave komunal.

Konkretisht të shprehura në mënyrë të listuar hapat bazë të ndjekura në procesin e planifikimit të menaxhimit të mbeturinave janë si mëposhtë:

Hapi 1. Krijimi i strukturave organizative

Hapi 2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Hapi 3. Planifikimi operacional i menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave

Hapi 4. Planifikimi financiar për menaxhimin të qëndrueshëm të mbeturinave

Hapi 5. Konsultimet për zbatueshmërinë e planit me përfaqësuesit kryesorë të komunës.

Procesi i konsultimit ka parashtruar nevojat në sektorin e menaxhimit të mbeturinave që i nevojiten komunës, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme. Përfaqësuesit e Komunës së Deçanit kanë asistuar gjatë lëvizjeve në terren si edhe kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit në gjithë territorin e komunës përmes ofrimit të të dhënave për analizim të detajuar gjatë përgatitjes së planit.

2. POLITIKAT, STRATEGJIA DHE KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE

2.1 Baza ligjore dhe instrumentet juridik për menaxhim të mbeturinave

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e MbeturINAVE (SRKMM 2013 – 2022) dhe Plan i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e MbeturINAVE (PRKMM 2013-2017 referuar faës së parë sipas SRKMM) ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Kosovës për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave deri në 2022, duke synuar minimizimin e mbeturinave që në burim si dhe zvogëlimin e rrezikshmërisë prej tyre, të zbatohet riciklimi dhe trajtimi (mekanik, biologjik, energjetik) deri te ripërdorimi dhe shfrytëzimi i mbeturinave. Me këtë strategji dhe planin e veprimit për mbeturina, synohet të përmirësohet gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave duke ndërtuar konceptin e drejtë dhe modern për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave.

Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë së Kosovës për të përmirësuar sektorin e mbeturinave në lidhje zbatimin e politikave për reduktimin e mbeturinave, riciklimin, kompostimin apo përpunimin e tyre për përfitim energjie. Në kuadër të Strategjigjisë së Republikës së

Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave janë vendosur objektiva, të cilët synojnë përmirësimin e mënyrës së menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Realizimi i synimeve dhe prioriteteve sipas kësaj strategjie janë përmbledhur sipas këtyre objektivave:

Objektivi 1: Masat e përgjithshme për forcimin e sistemit për menaxhimin dhe monitorimin e mbeturinave;
Objektivi 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturën për mbeturina;
Objektivi 3: Rritja e shkallës së vetëdijësimit, ndërgjegjësimit dhe informimit

Strategjia Kombëtare e Mbeturinave përshkruan mekanizmat kyç për investimet në sektorin e mbeturinave dhe ka parashikuar nevojat për financim sipas dy fazave. Sipas planifikimeve të nivelit qendror, në mënyrë që të arrihet përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e mbeturinave, është llogaritur që një kosto investimesh prej 133.85 milion euro ku tregohet se jo më shumë së gjysma e fondeve të përgjithshme do të sigurohen nga të ardhurat publike, përderisa pjesa tjetër do të sigurohet nga burime tjera. Në mënyrë që të mirë menaxhohen mbeturinat në nivel nacional, vendi është ndarë në nivel strategjik në 7 regjione bazuar në kufijtë gjeografikë sipas regjioneve aktuale. Këto njësi janë parë si strukturë bazë, por nuk përjashtohet mundësia e bashkimit apo bashkëpunimit midis këtyre zonave për të përfituar nga ekonomia e shkallës (referuar LIGJI NR. 04/L-060 Për Mbeturina). Në vazhdim, çështjet e këtyre regjioneve të mbeturinave do të menaxhohen nga një strukturë apo grup i zonës së mbeturinave që përbëhet nga partnerë mjedisorë rajonal dhe lokalë.


Plani Kombëtar i Mbeturinave ka përmbledhur dhe sygjerruar disa masa dhe veprime për mirë menaxhimin e mbeturinave komunale dhe rrymave tjera (referuar vetëm planit për fazën e parë të SRKMM në planin kohor 2013-2017), nga teknologjitë e trajtimit të mbeturinave deri tek minimizimi dhe riciklimi e tyre.

2.2 Principet e menaxhimit të mbeturinave

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:

- ❖ *Hierarkia e mbeturinave:* Hierarkia e mbeturinave përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në menaxhimin e mbeturinave në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në menaxhimin e mbeturinave duke vendosur “parandalimin dhe ripërdorimin” në majë dhe depozitim si alternativën më pak të favorshme.

Figura 1. Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave



- ❖ *Parimi reduktues:* Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbeturinave. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbeturinave qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre.

- ❖ *Parimi parandalues*: Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbeturinat në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbeturinat. Ky parim mundëson vënien në lëvizje të mekanizmave institucional dhe kontrollues të cilët nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme arrijnë të adresojnë potencialet që vijnë nga mbeturinat e rrezikshme si edhe gjenerimin e tepruar të mbeturinave urbane.
- ❖ *Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë*: Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që Mbeturinat të menaxhohen më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me Mbeturinat e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.
- ❖ *Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit*: Prodhuesit, nga prodhimtaria e të cilëve krijohet mbeturina janë përgjegjës për zgjedhjen e teknikave më të përshtatshme dhe më të pranueshme për mjedisin. Prodhuesit e mbeturinave janë të detyruar të bartin koston e të gjitha masave parandaluese për ndotjen e mjedisit, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave. Sipas parimit “Ndotësi paguan”: Ata që ndotin mjedisin duhet të bartin koston totale të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë për koston e masat parandaluese dhe eliminimin e dëmit të shkaktuar nga aktivitetet e tyre.

2.3 Kuadri ligjor në Kosovë mbi mbeturinat

Qeveria e Kosovës është e angazhuar në procesin e anëtarësimit në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit të shtetit të Kosovës në përputhje me instrumentet legjislative të BE-së.

Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është pjesërisht e harmonizuar me Acquis të Bashkimit Europian (BE) për sektorin e mbeturinave. Aktualisht, Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit (MEA) është duke bërë përpjekje për harmonizim të plotë, ku qëllimi kryesor i kornizës aktuale ligjore për menaxhimin e mbeturinave është shmangja dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i elementeve të ripërdorshme të mbeturinave, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; si dhe përfundimisht deponimi i mbeturinave në mënyrë miqësore ndaj mjedisit.

Ligji kryesor që rregullon sektorin e mbeturinave në Kosovë është Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat (“Ligji për mbeturinat”). Ky ligj është veçanërisht i rëndësishëm kur shpjegohet rregullimi i sektorit të mbeturinave në Kosovë në raport me ligjet e tjera, veçanërisht ato që adresojnë krijimin, menaxhimin dhe udhëheqjen e ndërmarrjeve publike (p.sh.harmonizimi me: Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare).

Ligje të tjera që në një farë mënyre ndikojnë në rregullimin e sektorit të mbeturinave përfshijnë:

1. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Ligji për Vetëqeverisjen Lokale”);
2. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar nga ligjet që ndryshojnë Ligjin për Ndërmarrjet Publike Ligji nr. 05/L-009 dhe Nr. 04/L-111 (“Ligji për NP”);
3. Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 (“LSHT”);
4. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet që ndryshojnë dhe plotësojnë Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-237 i vitit 2014, 05/L-068 i vitit 2016 dhe nr. 05/L-092 i vitit 2016 (“Ligji për PP”);
5. Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat (“Ligji për PPP”);
6. Ligji Nr. 04/L-024 për Ndhimën Shtetërore (“Ligji për Ndhimën Shtetërore”);

7. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit ("Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit");
8. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinorë ("Ligji për Planifikim Hapësinorë");
9. Ligjet tjera që kanë ndikim të kufizuar në rregulloren e menaxhimit të mbeturinave përfshijnë: Ligji për Ndërtim, Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Ujëra, Ligji për Kimikatet, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes, Ligji për Produktet Biocide, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimeve dhe Mbeturinave. Komponentët kryesorë të këtyre mbeturinave janë: guri, betoni, tulla, komponentë hekuri, komponentë plumbi, komponentë elektrik, etj.

2.4 Rolet dhe përgjegjësitë

Bazuar në politikën kombëtare për mbeturina, Pas miratimit të Ligjit për Mbeturinat, komunat kanë marrë përgjegjësi shtesë lidhur me menaxhimin dhe administrimin e mbeturinave, duke përfshirë obligime shtesë në lidhje me mbledhjen e tarifës së mbeturinave si dhe përzgjedhjen e modelit të operatorit në pajtim me Ligjin. Përveç kësaj, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përcaktoi menaxhimin e mbeturinave si kompetencë e plotë dhe ekskluzive e komunave. Bazuar në këto kompetenca, komunat kanë autorizimin ligjor për krijimin e strukturave, mekanizmave si dhe për parashikimin e një buxheti të ndarë për menaxhimin më të mirë dhe më efikas të sektorit të mbeturinave brënda territoreve të tyre administrative.

Pushteti lokal

Pushteti lokal, ose organi ekzekutiv në nivel lokal (Komuna), është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës lokale për menaxhimin e mbeturinave, e cila duhet të jetë në harmoni me Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave. Konkretisht ato janë përgjegjëse për:

- Hartimin dhe miratimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave;
- Përcaktimet e lokacioneve, bazuar tek plani hapësinor, sipas nevojave përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Përcaktimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Caktimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për grumbullimin e mbetjeve.

Kompanitë rajonale/komunale të menaxhimit të mbeturinave

Në përgjithësi edhe pse dispozitat e Ligjit për Mbeturinat parashohin bazë ligjore për liberalizimin e sektorit të mbeturinave duke hapur tregun për operatorët privat në menaxhimin e mbeturinave, ende ky shërbim ofrohet prej ndërmarrjeve publike që operojnë dhe ofrojnë shërbime të menaxhimit të mbeturinave për komunat. Të themeluara si Ndërmarrje Publike në bazë të Ligjit për NP-të dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, këto kompani kanë si aktivitet kryesor realizimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe bartjen e mbeturinave të grumbulluara në deponitë sanitare. Konkretisht, në Kosovë janë të regjistruara dhe veprojnë 8 Kompani publike që mbulojnë rajonë të caktuara administrative me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, ndër të cilat shtatë prej tyre janë Kompani Rajonale të mbeturinave dhe një prej tyre ka statusin si ndërmarrje publike komunale e cila ofron shërbimin vetëm në komunën e Deçanit (Ndërmarrja publike Komunale "Higjiëna" Decan).

Kompanitë e tilla janë të regjistruara dhe veprojnë si Shoqëri Aksionare, ku një komunë e caktuar ose një numër komunash i zotërojnë aksionet në këto kompani. Këto kompani janë kompani publike përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen nga vendbanimet dhe deri tek deponitë e mbeturinave.

Kompanitë rajonale publike e ofrojnë shërbimin për disa komuna në një rajon të caktuar dhe komunat që mundësohen me shërbim nga këto kompani kanë përfaqësuesin e tyre në bordin e kompanisë.

Roli dhe përgjegjësia e këtyre kompanive është po aq e rëndësishme bazuar në kuadrin ligjor për mbeturinat dhe detyrimet për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave, marrin parasysh që detyrimet brenda kompanive të Komunave si aksionarë të këtyre kompanive,

Kompanitë e tjera

Kompanitë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK). Këto kompani janë kompani shtetërore dhe janë përgjegjëse për menaxhimin e deponive regjionale të mbeturinave të komunave.

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH. A.), është kompani e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e korporatizuar dhe e regjistruar si Shoqëri Aksionare konform Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

Kompanitë e licensuara, apo sektori privat, janë kompani të cilat licensohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ofrojnë shërbimet për grumbullimin, trajtimin, riciklimin, transportimin dhe deponimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

3. ASPEKTI INSTITUCIONAL

3.1 Organizimi në nivel qendror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organi legjislativ i vendit, është përgjegjës për pjesën e miratimit të ligjeve, në këtë rast në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe në monitorimin e zbatimit të tyre nga komisionet ligjore të formuara. Më konkretisht ai është përgjegjës për: i) miratimin e ligjit për mjedisin, ligjit për mbeturinat dhe kuadrin ligjor relevant për fushën përkatëse; ii) nxjerrjen e strategjive për mbrojtjen e mjedisit; iii) dhënien e rekomandimeve dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve nga komisionet e kuvendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, është organi përgjegjës për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave si dhe për nxjerrjen e udhëzimeve administrative qeveritare.

Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit (MEA) është organi, i cili propozon, harton dhe mbikqyrë zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit pranë kësaj ministrie, është organi përgjegjës për aspektet e politlkës kombëtare dhe kuadrit ligjor dhe rregullator për menaxhimin e mbeturinave. Konkretisht detyrat e këtij departamenti janë:

- Propozon, harton dhe siguron bazën për krijimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- Harton dokumente Strategjike dhe legjislacionin për fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Propozon masa dhe projekte për rehabilitimin e zonave të "nxehta";
- Përcakton dhe propozon investimet dhe financimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Kryen aktivitete administrative dhe profesionale për anëtarësim në Konventa, Traktate, Marrëveshje dhe Organizata ndërkombëtare, për mbrojtjen e mjedisit;
- Ofron mbështetje profesionale, për çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- Shqyrton dhe përgatit propozim vendim për kërkesat e palëve, për çështje të ndryshme mjedisore;
- Përgatit raporte të ndryshme për çështje mjedisore.

Ky departament në strukturën e tij ka katër divizione në varësi të tij: i) Divizioni për Edukimin dhe Ndërgjegjësimin Mjedisor; ii) Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale; iii) Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate; Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës. Divizioni i cili është drejtëpërdrejtë përgjegjës për sektorin e mbeturinave është Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate.

Ky divizion ndër detyrat dhe përgjegjësitë më të rëndësishme ka:

- Hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plan Veprimin për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Përgatitjen e programeve për monitorim dhe raportet për gjendjen ekzistuese të mbeturinave;
- Dhënien e licensave për menaxhimin e mbeturinave dhe dhënien e lejeve për eksport, import dhe tranzit të mbeturinave;
- Mbikqyrjen e zbatimit të kuadrit ligjor dhe menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

3.2 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave në nivel komune

Bazuar në legjislacionin kombëtar, respektivisht LIGJI NR. 04 / L-060 Për Mbeturina, grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre (Ligji nr. 03/I-040 "Për vetqeverisjen lokale", 2008). Sipas Ligjit për Mbeturina, autoritetet kompetente për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë janë Ministria dhe Komunat. Kompetencat e komunave në pajtim me Ligjin për Mbeturina përfshijnë:

- Krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij;
- Përgjegjës për planin komunal për menaxhimin e mbeturinave dhe zbatimin e tij;
- Hartimin e raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave;
- Rregullimin e përgjegjësiave dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimin e tyre, organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;
- Mirëmbajtjen dhe përkujdesjen për sistemin e informimit të publikut dhe raportimit për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe aktet tjera ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Zbatimin e procedurave të prokurimit, përzgjedhjen e personave të licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brënda territorit të tyre;
- Caktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale;
 - Evidentimin e vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimin e projekteve për sanimin e tyre me shënimet për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, lloji i ndotjes, sasia e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera me rëndësi për realizimin e projekteve.

Përveç kësaj, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat do të kenë kompetenca të plota dhe ekskluzive për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimet dhe kanalizimet atmosferike, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale. Në pajtim me Ligjin për Mbeturinat dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat nxjerrin akte nënligjore që rregullojnë.

Referuar ndarjes administrative-territoriale çdo lloj shërbimi që komuna ofron në territorin që administron dhe komunitetit banues planifikohen dhe financohen nga kjo komunë. Diagrami më poshtë ilustron strukturën e komunës në lidhje me organizimin e sektorit/departamentit për menaxhimin e mbeturinave:




Figura 2. Struktura organizative e komunës së Deçanit

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhim të mbeturinave për komunën e Deçanit janë të ndara sipas kompetencave dhe janë paraqitur si më poshtë:

- Komuna kontraktin operatorët (publik apo privat) për aktivitetet e Menaxhimit të Mbeturinave, duke u bazuar në ligjin përkatës.
- Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike (DMSHSHP) është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera komunale.
- DMSHSHP është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave
- Drejtoria e Financave është përgjegjëse për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- Drejtoria për Urbanizëm, është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të Komunës së Deçanit, ndihmon në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës.
- Drejtoria për Punë Inspektuese, është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregullores komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë.
- Ndërmarrja publike komunale "Higjiena" ofron shërbim sipas statutit të saj duke ushtruar kompetenca ekzekutive.

Në diagramin më poshtë ilustron struktura organizative në ndërmarrjen publike komunale "Higjiena", si operator publik komunal i cili është përgjegjës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale në komunën e Deçanit.




Figura 3. Struktura organizative e NPL "Higjiena"

Ndër të tjerash, ligji instrukton komunat të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal për mbeturina. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e menaxhimit të mbeturinave, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin në vijim. Kuadri rregullator lokal duhet të përfshijë:

- Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave: është përgjegjësi e Komunës së Deçanit të hartojë këtë rregullore e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimit të mbeturinave brënda territorit administrativ të komunë, të hartojë procedura për ankesat e banorëve, si dhe për aplikimin e sanksioneve. Rregullorja duhet të miratohet nga Këshilli Komunal.
- Rregulloren komunale për tarifat e mbeturinave: kjo rregullore ka për qëllim të krijojë një sistem efektiv për mbulimin e kostos së shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave. Rregullorja e tarifave të mbeturinave përfaqëson një politikë komunale afatgjatë për mbulimin e kostos, nivelin e tarifave dhe sistemin e mbledhjes së tyre dhe vendos rregulla specifike për autoritetet lokale si dhe për komunitetin lokal dhe biznesin.

Komuna e Deçanit posedon Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (2018 - 2022) ku sipas këtij plani janë përcaktuar qëllimet dhe objektivat për menaxhimin e mbeturinave në komunë. Referuar objektivave të vendosura të komunës sipas PKMM, ato janë:

Qëllimi 1: Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të grumbullimit të mbeturinave

Qëllimi 2: Inicimi i procesit për ndarje të mbeturinave në burim duke synuar që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që përfundojnë në deponi.

Qëllimi 3: Grumbullimi, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogëlimit të sasisë që përfundon në deponi

Qëllimi 4: Reformat administrative

Qëllimi 5: Vetëdijësimi

Bazuar në objektivat e vendosura, një studim i detajuar i gjendjes mjedisore dhe sektorit të menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal adresojnë zhvillimin e programeve nxisin qëndrueshmërinë e sistemit primar të grumbullimit të mbeturinave dhe aplikimin e skemave për reduktim dhe ndarjen në burim për riciklim të tyre.

4 KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS

4.1 Përshkrim i përgjithshëm i komunës

Komuna e Deçanit shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit dhe pothuajse gjendet në qendër të Ballkanit, në vijën ajrore është larg nga Deti Adriatik 90 km, kurse 220 km larg nga Deti Egje. Drejtimi i shtrirjes së territorit të Komunës së Deçanit është veriperëndim - jug-lindje në mes gjatësisë lindore: 20° 5' e 20° dhe 20° 32' e 8" dhe në mes gjatësisë veriore: 42° 33' e 30" dhe 42° 26' e 3" dhe sipas Sistemit Global të Pozicionimit: Veri - 47° 00' dhe 47° 20' dhe Lindje - 20° 52' dhe 20° 06'.

Në perëndim kufizohet me Republikën e Shqipërisë në gjatësi prej 5.5 km ndersa në veriperëndim kufizohet me Malin e Zi 12.5 km. Në veri kufizohet me Komunën e Pejës: PT-2424 deri 460 (Maznik) me gjatësi prej 38.5 km . Në jug-lindje kufizohet me Komunën e Gjakovës nga PT - 460 deri të Gunga e Hereqit - në Jug nga PT 489 me gjatësi prej 24.05 km. Në jug dhe perëndim kufizohet me Komunën e Junikut 24.35m .




Figura 4. Harta e Pozitës gjeografike të komunës së Deçanit

Komuna e Deçanit ka një popullsi afërsisht 40.019 (sipas të dhënave prej ASK-Agjensia e Statistikave të Kosovës*). Numri i ekonomive familjare raportohet të jetë 5,887 ekonomi familjare. Gjithashtu, në total në të gjithë territorin e komunës janë të regjistruara 1834 biznese dhe 34 institucione¹.

4.2 Vlerat natyrore dhe turistike

Komuna e Deçanit është mjaft e pasur me pasuri natyrore, të cilat përfshijnë: 8.940.40 ha tokë bujqësore, 14.420 ha tokë pjellore dhe 5.479.6 ha pyje.

Kompleksi i vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna është i pasur me florë dhe faunë të zhvilluar, si dhe me reliev karakteristik të llojit të veçantë. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojllojshmërinë e shkëmbinjve dhe të mineraleve. Zona e quajtur "Pishat e Deçanit" me sipërfaqe prej 15 ha gëzon nga MEA statusin special të peizazhit të mbrojtur. Në territorin e Deçanit gjenden lokacionet tjera me interes për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit si: Maja e Ropsit me sipërfaqe prej 20.00 ha e cila paraqet një rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut si dhe Kozhnjeri me sipërfaqe 150 ha i cili përfaqëson rezervat shtazor i llojit dhia e egër (*Rupicapra rupicapra* L.).

Lugina fluviale g-glaciale e Lumbardhit të Deçanit, e cila prej burimit deri në vendderdhje në Drinin e Bardhë, me gjatësi 40 km, ka një pjerrtësi vertikale rreth 2000 m. E tërë hapësira rreth Deçanit, gjegjësisht në malet që e rrethojnë, janë me liqene akullnajore dhe me lugina të lumenjve, të cilat kanë formë të grykës dhe janë shumë tërheqëse për vizitorë. Pyjet e llojllojshme, kullotat e shumta, fauna e pasur, ajri i freskët dhe i pastër malor i Alpeve Shqiptare, kanë mundësuar që Deçani të afirmohet si qendër rekreativo-turistike dhe ku valorizimi turistik i Deçanit theksohet me ndërtimin e pushimorës piktoreske rrëzë malit të rrethuar me pyje të pishave dhe të gështenjës në afërsi të së cilës gjendet edhe gryka e Lumbardhit të Deçanit si dhe me investimet në sektorin e zhvillimit turistik të kësaj komune.

i. Flora

Territori i Komunës së Deçanit përfaqëson zonë shumë të pasur me pyje dhe me tipe tjera vegjetacioni. Flora e kësaj treve rradhitet në zona në të cilat bëjnë pjesë:

- Gjetherënëset e fushave: Janë bimë, të cilat i ka kultivuar individi nëpër megja të arave dhe livadheve si: shelgu, verra, plepa, bagrena, vidha si dhe shumë llojshmëri te pemëve: molla, dardha, arra, etj.
- Zona e gështenjave: Nga Juniku deri në Strellc në lartësi mbi detare prej 500 deri 1000m ku dallohet zona e pasur me gështenja ,ky lloji i pemëve ka rëndësi të madhe si nga fryti ashtu nga lënda drunore.
- Zona e pyjeve gjetherënëse: Në lartësi derë në 1500m dallojmë pyjet gjetherënëse si bungu, ahu, shkoza lajthia frashri, panja etj. Shërbejnë si lëndë djegëse dhe në ndërtimtari.
- Zona e pishnajave: Në zonën e pishnajave paraqiten relikte dhe lloje endemike si: pisha e bardhë, pisha e zezë, bredhi i kuqë, bredhi i bardhë, molika etj. Këto lloje të drunjve kanë rëndësi të madhe si në ndërtimtari ashtu edhe në industri.

¹ * Në të gjitha të dhënat e marra dhe elaboruara në kuadër të planit do të përdoret numri i popullsisë i llogaritur nga Agjensia e Statistikave të Kosovë

- Zona e kullosave: Mbi lartësitë 2000-2500m paraqitet zona e kullosave e cila është hapësirë shumë e përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë. Kjo zonë është e pasur edhe me bimë mjekuese dhe më së shumti haset si: boronica, pelini, lincuri, dhe të gjitha llojet çajit.
- Zona e shkëmbinjve të zhveshur: Ngjitur me zonën kullosave në lartësi mbi 2500m shtrihet zona e zhveshur së cilës i mungon çdo lloji i vegjetacionit.

ii. Fauna

Fauna e Bjeshkëve të Nemuna paraqet një rezervat shumë të pasur me lloje të ndryshme të kafshëve të egra të cilat jetojnë në pyje të dendura si : ariu , ujku ,dhelpira , lepuri , vjedulla ,derri i eger , reqebulli , kaprolli ,ketri etj si dhe një lloj-llojshmëri shumë e madhe e shtazëve që ndërtojnë fole të përhershme ose sezonale. Në bazë raporteve të deritanishme konstatohet se përbëhet prej 8 llojeve të peshqeve, 13 lloje ujëtokësorë , 10 lloje rrëshqitës 148 lloje shpendësh, 36 lloje gjitarë ,dhe 129 lloje fluturash.

iii. Klima

Në veçori të klimatike të territorit të Komunës së Deçanit rol vendimtar luan edhe relievi. Afersia e Bjeshkëve të Nemuna kushtëzohet klimë të ashpër.

Ditët me diell zgjasin rreth 44 % prej ditëve të mundshme që është një vlerë e lartë. Mesatarisht numri i ditëve me diell mbi 9 orë në Deçan është 92 ditë gjatë vitit, e mbi 2000 m lartësi mbi detare rreth 115 ditë. Megjithatë Deçani gjindet në l.m.d. Prej 600 m temperaturat mesatare vjetore nuk lëshohen nën 0° C. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare mujore 0.2° C ndërkohë që muaji më i nxehtë është korriku me temperaturë të mesme mujore prej 21.5° C.Në Deçan nuk ka ditë me temperaturë të mesme ditore më të ultë se -15° C. ose me të lartë se +30° C.

Sasia mesatare vjetore e rreshjeve në territorin e Komunës së Deçanit leviz prej 900- 1500 ml/ m². Mesatarisht, gjatë vitit ka 126 ditë me të reshura.Më së paku të reshura ka gjatë muajt korrik, gusht dhe shtator 6-8 ditë mesatarisht me sasi deri në 70 ml/ m². Kurse sasia më e madhe është gjatë gjysmës së ftohtë të vitit ku sasia e të reshurave arrin deri 1500ml/m² në ditë.

4.3 Infrastruktura rrugore

Sipas informacioneve lokale të ofruara nga zyrtarë komunalë, Gjatësia e përgjithshme e rrugëve lokale në Komunën e Deçanit është rreth 172 km dhe 2 ura. ku prej tyre 138.9 km janë rrugë të asfaltuara dhe rrugë të paasfaltuara/ në gjatësi rreth 33.40 km. Pasqyra e rrjetit rrugor që e përshkon territorin e Komunës së Deçanit është si më poshtë:

- o Rrugë magjistrale: Pejë - Gjakovë e përshkon territorin e Komunës së Deçanit në gjatësi prej 24 km.
- o Rrugë rajonale: Carrabreg - Voksh në gjatësi prej 6 km është e asfaltuar

Referuar këtyre të dhënave mund të konstatohet se rreth 81 % e rrugëve kryesore (në zonë urbane dhe rurale) në komunën e Deçanit janë të asfaltuara.

4.4 Aspekti socio – ekonomik

Sipas të dhënave të Censurit të vitit 2011 popullsia rezidente e Komunës është 40,019 banorë, të shpërndarë në 37 vendbanime me një numër total të amvisërive prej 5,887 ekonomi familjare. Në tabelën në vijim është paraqitur popullsia e Deçanit sipas regjistrimit të vitit 2011 (të dhënat nga ASK-ja)

Në tabelën më poshtë jepen të dhëna më të detajuara:

Tabela 1. Statistika për Komunën e Deçanit

NJA	Nr. Popullsisë ASK	Nr. Populls. Urbane	Nr. Populls. Rurale	Nr. Ek.familjare	Nr. B	Nr. Inst
Total	40,009	3,834	36,185	5,887	1,834	34

Tabela 2. Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve

Nr. rendor	Emri i vendbanimit	Nr amvisërive	Nr. rendor	Emri i vendbanimit	Nr amvisërive
1	Baballoq	1,611	20	Llukë e Epërme	1,463
2	Beleg	833	21	Llukë e Ulët	510
3	Belle	8	22	Maznik	451
4	Carrabreg i	1,458	23	Papiq	175
5	Carrabreg i Ulët	2,076	24	Pobërxhë	1,325
6	Dashinoc	301	25	Pozhar	427
7	Deçan	3,834	26	Prapaqan	746
8	Drenoc	1,054	27	Prekolluk	290
9	Dubovik	1,069	28	Prilep	2,183
10	Dubravë	280	29	Rastavicë	1,248
11	Glllogjan	992	30	Ratish i Epërm	212
12	Gramaçel	1,106	31	Ratish i Ulët	565
13	Hulaj	159	32	Sllup	341
14	Irzniq	1,753	33	Strellc i Epërm	3,374
15	Isniq	3,902	34	Strellc i Ulët	2,131
16	Kodralli	815	35	Shaptej	596
17	Lëbushë	1,154	36	Voksh	575
18	Lumbardh	723	37	Vranoc i Vogël	102
19	Lloqan	503		TOTAL	40,009

Numri i bizneseve gjithsej rezulton përafërsisht 1, 834, kryesisht të llojit të mësëm të ulët. Numri mbetet për t'u saktësuar; cilat biznese janë aktive dhe cilat joaktive.

Komuna e Deçanit është komunë në zhvillim e sipër për sa l përket veprimtarisë turistike të konsiderueshme gjatë sezonit dimëror dhe veror duke qenë se është e shtrirë përgjatë vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna.

Pjesëmarrja e veprimtarive prodhuese dhe shërbyese në krahasim me veprimtaritë tjera ekonomike është më e vogël, duke treguar një pjesëmarrje më të madhe në biznesin privat.

Sipas statistikave, në vitin 2018 janë 1834 biznese të regjistruara në zyrën për regjistrim të bizneseve, ndër të cilat aktivitetet biznesor ushtrojnë 330 biznese në qendrën urbane kurse 447 në lokalitete tjera rurale.

Në bazë të dhënave mbi numrin e punëtorëve të punësuar në bizneset e regjistruara në Komunën e Deçanit e të prezantuara në pasqyra statistikore mbi regjistrimin e bizneseve shihet se në komunën e Deçanit gjithsejt të punësuar janë 3500 punëtorë.

i) Industria

Sektori i industrisë është i dëmtuar që nga lufta dhe i njëjti nuk është në funksion. Do të kishte shumë rëndësi, që fabrikat e dikurshme, si: Fabrika auto-pjesëve "Ramiz Sadiku" në Isniq, e pompave me piston në Isniq, rrjetit të armiruar në Deçan, përpunimit të mjaltit "APIKO" në Deçan, fabrikat për përpunimin e drurit, mobileve po të funksiononin do të kishin efekt pozitiv në uljen e papunësisë. Disa nga këto objekte janë privatizuar sipas AKM-ës dhe funksionojnë shumë pak, duke mos ndikuar pothuajse aspak në uljen e papunësisë.

ii) Bujqësia dhe blegtoria:

Në këtë zonë është grupuar toka pjellore e cila shtrihet përgjatë dhe në mes të rrjedhave të lumenjve, të disa kodrave si rrafshnaltat dhe tërë sipërfaqja e zonave rurale. Komuna e Deçanit disponon me 8.940 ha tokë bujqësore që përfshinë 31% të sipërfaqes së tërësishme të komunës së Deçanit (29 700 ha), e cila në bazë të kualitetit të tokës shprehur në përqindje të sipërfaqes është:

Tokë e mirë – klasa I, II, III, 60 % ; Tokë e mesme – klasa IV 25 % ; Tokë e varfër – klasa V, VI 15 %

Ndër të cilat do të përfshihen:

- Tokë në pronësinë private janë 7980 ha
- Tokë në pronësinë shoqërore janë 960 ha.
- Tokë e lërueshme është 51, 2 % ose 5916 ha.
- Sipërfaqe e mirë me kullosa natyrale (mbi 7,000.00 ha).

Numri i popullësisë që jeton në hapësirat rurale është rreth 90 %, ku mosha e popullësisë me kapacitet punës që jeton në viset rurale është 18 – 60 vjeq. Nga bujqësia sigurojnë të ardhura mbi 65 % e banorëve të Komunës, përmes kulturave kryesore që janë: misri, gruri, pemet dhe përimet. Zonat për prodhim bujqësor janë të identifikuar kryesisht në viset rurale, ku shumica e familjeve kanë sipërfaqe të pamjaftueshme të tokës dhe të ndarë në disa parcela, gjë që pamundëson zbatimin teknologjisë bashkëkohore në prodhimtarinë bujqësore. Në teritorin e komunës veqojmë këto Zona të Prodhimit Bujqësor: Strellc: Shurdenet, Bohriqet; Isniq: Nënë Drum. Luginat, Kodrat, Peshutat etj. Prapaqan: Fusha e Thatë; Lumbardh: Livadhet e Mëdha; Irzniq: Pemishta; Carrabreg: Livadhet e Gata, Gerdajat; Prejlep: Rrepishtat, Plugishtat; Gramaqel: Shavaret; Lloqan: Qesta; Drenoc: Malijet e Drenocit; Baballoq: Devollet. Referuar të dhënave, sipërfaqet me pemishte në komunën e Deçanit janë gjithnjë e më shumë në rritje, kryesisht në sektorin privat.

Referuar të dhënave, sipërfaqet me pemishte në komunën e Deçanit janë gjithnjë e më shumë në rritje, kryesisht në sektorin privat. Krahës bujqësisë, blegtoria e komunës së Deçanit fokusohet kryesisht në sektorin e bletarisë dhe rritjen e kafshëve si lopë qumështore, gjedhë, pula etj. Para kushtet janë shumë të favorshme për një blegtori intensive dhe me perspektiv të gjatë të zhvillimit duke u referuar në resurset e mëdha natyrore që disponon komuna e Deçanit.

4.5 Gjendja e përgjithshme mjedisore

Gjendja e mjedisit do të paraqesë situatën e komponentëve kryesor të mjedisit, si: toka, uji, ajri, biodiversiteti etj. Në nivel vendi, gjendja e përgjithshme mjedisore në Kosovë nuk paraqitet e mirë si pasojë e ndërtimeve shpeshherë pa plan urbanistik, ndotjes nga trafiku, menaxhimi jo përkatës i mbeturinave dhe ujërave të zeza apo si pasojë e aktiviteteve ekonomike dhe industriale që krijojnë ndotje në mjedis. Problemet serioze mjedisore lidhen me shfrytëzimin joracional të burimeve natyrore të cilat pastaj shkaktojnë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, prishin pejsazhin, kërcënojnë biodiversitetin dhe burimet natyrore.

Në Komunën e Deçanit, si pasojë aktiviteteve të ushtruara nga faktori njeri, janë dëmtuar në masë të madhe fondi pyjor, degradim i lumenjve dhe brigjeve të tyre, sipërfaqet e gjelbëruara nga hedhja e

pakontrolluar e mbeturinave etj. Gjendja e “Lumëbardhit” të Deçanit dhe “Lumëbardhit” të Lloqanit nuk është aq e mirë, nga shfrytëzimi pa kriter i rërës dhe i zhavorrit, ndërtimit të hidrocentraleve, hedhjes së mbeturinave, derdhja e ujërave të ndotura (zeza) kanë ndikuar në cilësinë dhe sasinë e ujit.

Prezenca e deponive ilegale prej së kaluarës si dhe depozitimi i tyre në brigje të lumenjve, prrockave, ndikon në ndotjen e tyre e tokës dhe ujrave, po ashtu shfaqjen e dukurive si, erozioni dhe vërshimet në tokat bujqësore, që shtrihen përgjatë këtyre lumenjve. Burim kryesor në ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në Komunën e Deçanit vazhdon të vijë prej mungesës së sistemit të kanalizimit për ujërat e ndotura (të zeza) në pjesën rurale të territorit komunal. Kryesisht në pjesën rurale mungon sistemi i kanalizimit dhe ku ujërat e ndotura grumbullohen në gropat septike, të cilat nuk janë të ndërtuar sipas kriterëve të ndërtimit. Gropat septike individuale janë në trajtë të gropave grumbulluese, që mund të ndikojnë në ndotje të ujërave nëntokësore, por edhe në ato sipërfaqësore.

Referuar raporteve të mëhershme lidhur me gjendjen e mjedisit në komunë, progress i konsiderueshëm që është bërë nga komuna e Deçanit në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, si rrjedhojë e së cilës komuna ka shtrirë shërbimin e grumbullimit në nivel territorial duke shërbyer të gjitha ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet si dhe duke eliminuar të gjitha deponitë ilegale me mbetje kryesisht të amvisërive apo të përziera. Përkundër aktiviteteve të komunës, verifikohen prezencë të deponivë ilegale me përbërje të llojeve të mbeturinave kryesisht të ndërtimit dhe demolimit, apo të përziera, problematikë kjo që duhet të adresohet për zgjidhje prej komunës së Deçanit në planifikimin dhe përcaktimin e hapësirave për trajtimin e këtyre llojeve të deponive. Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin rrezik permanent për banorët e Komunës, ku përmes përmes zbrëthimit të materieve emetojnë lëndë toksike të dëmshme për shëndetin e njeriut duke u shpërndarë edhe në ujërat nëntoksorë si pasojë e përzierjes me rreshjet e shiut (prezencë e materialit asbest tek mbetjet që derivojnë prej prishjeve të ndërtimit).

Njëherësh është e domosdoshme zhvillimi i planeve dhe praktikave që favorizojnë menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve duke stimuluar zhvillimin e programeve të ndarjes në burim të mbeturinave të riciklueshme apo atyre organike, programe këto që duhet të fillojnë që nga mbledhja e ndarë e mbeturinave nga ekonomitë shtëpiake. Gjithashtu, në plane të saj komuna duhet të ndërmarrë plane konkrete për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme, mbeturinave spitalore etj. Aktualisht, sasia e mbeturinave urbane për kokë banorit përlllogaritet rreth 0.7 kg mbetje për banorë referuar të dhënave të matjes së sasisë totale të grumbulluar në gjashtë mujorin e parë të vitit referent 2020 përlllogaritur për numrin e qytetarëve rezidentë në komunën e Deçanit.

5 KONTEKSTI LOKAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

5.1 Situata aktuale e shërbimi të grumbullimit të mbeturinave në komunë

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në komunën e Deçanit ofrohet në tërë territorin e komunës. Kompania publike “Higjiëna” deklaron që ofron shërbimin për 100% të popullsisë sipas ekonomive familjare bazuar në të dhëna të regjistruar nga vet kompania në teren. Kjo kompani kryen faturimin dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat e pastrimit nga amvisëritë, bizneset dhe institucioneve publike.

Nga të dhënat e mundësuar nga kompania publike dhe komuna, për vitin 2019 nga komuna keyhen shërbim në 4180 ekonomi familjare rezidente dhe 1639 ekonomi familjare jorezidente, në numër total 6349 ekonomi familjare duke i përfshirë të dyja kategoritë e amvisërive.

Gjithashtu shërbimi i grumbullimit të mbeturinave kryhet në të gjitha bizneset aktive dhe institucionet në tërësi territoriale.

Tabela 3. Numri i klienteve në faturim (referuar të dhënave të ASK dhe të paraqitura nga NTP "Higjiena")

Komuna	Klientë gjithsej në zonën kadastrale				Klientë të faturua = shërbyer			
Qyteti/Fshat	Ekonomi familjare ASK	Bisnese.	Insitucione	Totali në shërbim	Ek fam Resident joresidend	Bisnese.	Insitucione	Totali në shërbim
Deçan	5,887	1,834	34	7,755	6,349	409	34	6,792

Kompania e cila është e licencuar për administrimin e mbeturinave dhe punon në bazë të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Deçanit, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina e miratuar nga Kuvendi i Komunës në vitin 2014. Si kompani publike punon sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregëtare. Aspektet operationale të menaxhimit të mbeturinave në Deçan udhëheqen nga NPL "Higjiena"SH.A. Për të cilën aksionare kryesore me 100% është vetë Komuna. NPL "Higjiena" është kompani publike, e cila operon me vetëfinancim. Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve, respektivisht konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset dhe instiucionet. Po ashtu kompania ofron shërbim në grumbullim të mbeturinave derë më derë dhe vetë-inkason mjetet për shërbimin e ofruar rreth 82% paguajnë tarifën e grumbullimit të mbeturinave. Kjo kompani shërbimin e saj e zhvillon duke u bazuar në Dy aktiviteteve: primar (grumbullimi dhe depozitimi i mbeturinave) dhe sekondar (me kontrata të veçanta si larje fshirje, mirëmbajtje hapësirash të gjelbra etj).

Kompania nuk e bën grumbullimin e mbeturinave të ngurta ndërtimore si dhe mbeturinat të hekurit, ndersa mbetjet shtazore grumbullohen me kërkesë nga Komuna dhe me procedurë dhe kontrata të vecanta dhe gjatë groposjes ato dezinfektohen përmes gëlqerosjes. Aktivitetet e saj, kompania i realizon përmes departamenteve operative dhe shërbimit për konsumatorë, të cilat përbëjnë tërësinë e ndërmarrjes.

Lidhur me krahasimin e të dhënave dhe raporteve mbulueshmëria e territorit të Komunës së Deçanit me ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është 100%, zvogëlimin e shkallës së hedhjes ilegale në 70% (referuar raporteve të deponive ilegale sipas krahasimit të viteve referente 2019 dhe 2018). Referuar PKMM këto të dhëna do të përkrijnë me përmbushjen e Qëllimit 1: Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të grumbullimit të mbeturinave; Qëllimi 4: Reformat administrative(50%); Qëllimi 5: Vetëdijësimi (80% shërbimin primar të grumbullimit).

5.2 Mbuleshmëria me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave

Shërbimi në Komunën e Deçanit është i ndarë në tri kategori (A, B dhe C). Kategoria A karakterizohet nga grumbullimi kolektiv (zona qendër e qytetit), ndërsa kategoria B karakterizohet në grumbullim derë më derë në zonat urbane dhe rurale. Në kategorinë C ka edhe disa zona ku shërbimi ofrohet në sajë të kontratave që nënshkruhen prej bizneseve apo institucioneve me Kompaninë "Higjiena". Për sa i përket zonës Qendër në banimet kolektive shërbimi bëhet një herë gjatë 24 orëve në shtatë ditë të javës. Sa i përket zonën rurale automjetet e grumbullimit gjatë ditëve të javës do të kenë në shërbim edhe disa fshatra në zonat e afërta të qytetit të Deçanit dhe shërbimi do të bëhet gjatë gjithë javës si dhe ditën e Shtunë.

Në tabelën më poshtë tregohet si si janë të shpërndarë në territorin e komunës sistemet e grumbullimit të mbeturinave referuar kapacitetit teknik dhe zonave të grumbullimit:

Orari i shërbimit te grumbullimit te mbeturinave N.P.L "Higjiena"- Deçan															
Dita		E Hene		E Marte		E Merkre		E Enjte		E Premte		E Shtune		E Diele	
Kapaciteti	Aseti	AM	PM	AM	PM	AM	PM	AM	PM	AM	PM	AM	PM	AM	PM
	IVECO	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2
	MAN-1	Unaza	Institucion	Unaza	Ledinat	Unaza	Poberxh	Unaza	Institucione	Unaza	Lebushë	Unaza		Unaza	
	MAN-2	1-1/1	1-1/2	Carrabregu I Ulet		Lloqan	Voksh	Ratish I Ep.	Dashinoc,Maznik						
	MAN-2	1-2/1	1-2/2	Carrabregu I Eperm		Sllup	Drenoc	Llukë e Ep.	Beleg	Strellc I Ulët		Baballoq	Gramaqel		
7490	Volvo	Isniq-1		Prilep		Irzniq	Prekollukë	Pozhar	Kodrali	Strellc I Epërm-2					
	MAN-3	Isniq-2		Rastavicë		Glogjan	Dubovik	Lumbardh	Llukë e Ulët	Dubovik	Papiq				
	Traktor														

Figura 5. Orari I operimit (referent 2019-2020)

Sipas të dhënave të ofruara, shërbimi ofrohet për 6349 ekonomi familjare rezidente apo jorezidente (përfshirë mërgimtarë), për 1834 biznese active dhe joactive dhe 34 institucione në komunë. Sasia 6 mujore e grumbulluar e mbeturinave llogaritet të ketë qenë (gjysëm vjetori i parë 2020) rreth 3,974.90 ton mbeturinë apo 622 ton në muaj.

5.3 Forma e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave urbane

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave konsiston në mbledhjen e mbeturinave urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brënda kontenerëve publikë dhe atyre individualë si dhe rreth tyre, dezinfektimi i kontenerëve dhe vendit përreth, transportimi i mbeturinave urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit.

Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit përfshin gjithë zonën e administrimit komunal (100%).

Sistemi aktual i pikave të grumbullimit mbeturinave (PGM) përbëhet nga kontenerë metalik me rrota me volum 1.1m³, të pozicionuar në anë të rrugëve në pika të përbashkëta publike të miratuara paraprakisht nga autoritet komunale sipas planit për riorganizimin e zonës qendër në komunën e Deçanit. Largësitë mesatare midis PGM variojnë sipas dendësisë së popullsisë me frekuencë 100-150 m distancë, në zonën e qendrës ku është e përqendruar pjesa më e madhe e bizneseve, institucioneve dhe banorëve si dhe zonat e tjera të qytetit të Deçanit, në 200-400m.

Njëkohësisht ekzistojnë dhe lokacione të përbashkëta individuale/kolektive ku kontenerët janë të pozicionuar brënda territoreve të institucioneve apo subjekteve private.

Gjendja aktuale PGM paraqitet e mirë, megjithëse ekziston një seri problemesh si përse i përket dëmtimeve të kontenerëve dhe higjienës si pasojë e sjelljes qytetare. Në zonën urbane ky shërbim kryhet në nivel të kënaqshëm dhe vërehet që PGM janë të pastra dhe desinfektuara pothuajse rregullisht nga ndërmarrja e pastrimit.

Kompania NPL"Higjiena" ofron shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për ekonomitë familjare (amvisëritë) dhe për institucionet e bizneset e komunës. Konkretisht kompania zhvillon këtë sistem të grumbullimit të mbetjeve sipas kategorizimeve:

Grumbullimi i mbeturinave në ekonomitë familjare (amvisëritë) duke përdorur dy sisteme për grumbullimin e mbeturinave:

A.Sistemi derë më derë, i cili aplikohet në amvisëritë me banim individual, ku mbeturinat hidhen në konteinerë plastikë me kapacitet 120-240litra, dhe grumbullohen 1 herë në javë nga kompania;

B.Sistemi i grumbullimit të mbeturinave me konteiner 1.1 m³, i cili aplikohet në ato njësi ekonomike familjare me banim kolektiv (ndërtesa shumëkatëshe) apo në koncentime të institucioneve publike, apo bizneseve të vogla, ku shërbimi ofrohet nga kompania dhe realizohet një herë në ditë në banesa kolektive në zonën unazë të qendrës; Nëpër institucione shërbimi kryhet varësisht zbrazjeve me frekuencë 1 herë në javë.

Kryesisht gjendja fizike e konteinerëve është e mirë dhe vendlokacionet e pikave të grumbullimit janë të organizuara mirë dhe me rrethojat estetike (gjithsej 5 lokacione të grumbullimit të mbeturinave me prezencë prej 2- 5 konteinerë 1.1m³).

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ofrohet në 37 fshatra të komunës së Decanit (100%) Në këto fshatra shërbimi është i plotë dhe kryhet 4 herë në muaj.

5.4 Përmbledhje e gjetjeve në menaxhim mbeturinash

Në tabelën e mëposhtme do të përmbliidhen të dhëna të ëprgjithshme të mjedisit që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e mbeturinave në Komunë.

Tabela 4. Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbeturinave

Të dhëna të përgjithshme	Komuna Deçan
Matje mbi përbërjen e mbeturinave?	JO
Pika të deponive ilegale të grumbullimit të mbetjeve	21
Vende të autorizuara të depozitimit të mbeturinave (PGM)	5
Vende të pa autorizuara për depozitimin e mbeturinave	21
Venddepozitime ilegale që janë eliminuar	40
Vend i caktuar për deponimin e mbetjeve inerte	Në zonën e qytetit
% E mbetjeve që shkojnë në deponinë e Pejës	100% mbeturinë amvisërie
% E mbetjeve në venddepozitim të autorizuar	0%
% E mbetjeve në venddepozitime ilegale	Nuk ka të dhëna
Sistem për ndarje në burim	Jo
Sasia e mbetjeve e mbledhur dhe e përpunuar (ton/vit)	0
% E mbetjeve të mbledhura dhe të përpunuara	0
A ka nisma për kompostim?	Jo

Në bazë të këtyre të dhënave në Komunën e Deçanit:

- Gjenden rreth 5 pika të grumbullimit të mbeturinave të plotësuar me infrastrukturë me kontenierë;
- Gjenden gjithsej Vende të pa autorizuar për depozitimin e mbeturinave, kryesisht të natyrës së mbetjeve inerte, të përziera dhe voluminoze. Referuar të dhënave prej 61 në total, 41 deponi ilegale janë pastruar dhe 21 janë aktive të parehabilituara;
- Mbeturinat komunale depozitohen në deponinë komunale të Pejës;
- Komuna posedon një vend të caktuar për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve inerte, në zonën e qytetit megjithatë është në faza të funksionalizimit.

5.5 Riciklimi i mbeturinave

Sektori i riciklimit në Kosovë është në hapat fillestarë të zhvillimit. Aktualisht kjo industri është e lokalizuar në biznese të vogla që kryesisht merren me sortimin e materialit të riciklueshëm dhe shitjen e tij për tregun vendor apo të jashtëm. Tregu i shitjes së materialit të riciklueshëm kryesisht është i fokusuar në materialet e riciklueshme si: metali/alumini, plastika sipas disa llojeve të plastikës, letra dhe kartoni. Çmimi i shitjes varion në treg sipas bursës internacionale dhe ku çmimet kryesisht shkojnë sipas fraksioneve: letra 3-4-cent/kg; plastika 8-15cent/kg, alumini/hekuri deri në 70cent/kg. Për momentin aktiviteti i grumbullimit realizohet prej veprimtarisë joformale në shkallë të ulët përderisa ai i paketimit dhe presimit prej bizneseve të vogla lokale. Kjo veprimtari joformale nuk monitorohet prej komunës apo organeve tjera përgjegjëse.

Përpos fraksioneve të lartpërmendura, në rajonet përreth komunës së Deçanit ka iniciativë prej bizneseve të vogla tjera për grumbullimin e materialit qelq dhe përpunimin e tij, megjithatë janë në shkallë fillestare. Në çdo rrethanë, komuna duhet të hartojë politikë që adresojnë ndarjen në burim dhe riciklimin e mbeturinave si pjesë e objektivave për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave komunale dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të depozituara në deponinë rajonale të Pejës.

5.6 Kompostimi

Në Komunën e Deçanit nuk raportohen nisma për kompostim edhe pse potenciali parashikohet të jetë shumë i lartë pasi kjo komunë posedon një pjesë e konsiderueshme të popullsisë që jetojnë në zona rurale të cilët gjenerojnë sasi të vogla të mbetjeve inorganike dhe sasi të mëdha të mbetjeve organike që lidhet me veprimtarinë prodhuese të tyre. Vlen për tu përmendur fakti që edhe pse në këtë komunë ka potencial të lartë të gjenerimit të mbetjeve organike apo lëndë drusore si pasojë e hapësirave të gjelbra që posedon, aktualisht nuk ka ndonjë aktivitet për kompostim, ripërdorim dhe trajtim të biombetjeve drusore (pellet) etj.

5.7 Administrimi i mbeturinave të vëllimshme dhe rrymave tjera

Një faktor tjetër që ndikon në aspektin estetik dhe shëndetsor për qytetarët e komunës së Deçanit është edhe hedhja pa kriter të mbeturinave voluminoze, kryesisht inerte, mbeturinave të vëllimshme, të papranueshme për sistemin e mbledhjes së mbeturinave. Mbeturinat nga prishja e ndërtimeve apo të ashtu quajturat mbetje të ngurta janë mbetje si gurë, dhe, beton, tulla, etj., që mbeten nga veprimtaritë e ndërtimit, rindërtimit, riparimit dhe prishjes së ndërtesave, shtëpiave dhe strukturave të tjera. Shpesh këto mbetje hidhen të përziera me mbetje urbane duke impaktuar cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve apo edhe hidhen në mënyrë të pakontrolluar duke krijuar prezencë të deponive të egra ilegale të dëmshme për mjedis dhe shëndetin e banorëve. Momentalisht nuk ka ndonjë sistem të instaluar prej komunës apo

kompanisë së “Higjiena” për grumbullimin e tyre të veçantë (mbeturinat e vëllimshme). Komuna së fundmi ka përcaktuar një lokacion për dërgimin e mbeturinave inerte prej gjeneruesve të mbeturinave megjithatë zbatimi i rregullores për hedhje të kontrolluar të kësaj kategorie të mbeturinave nuk gjen zbatim tek prodhuesit e këtij fraksioni të mbeturinave.

Referuar organizimit të veçantë të grumbullimit për mbetjet prej eshtrave, sipas informatave nuk posedohet një organizim i veçantë apo trajtim i kësaj kategorie të mbetjeve të rrezikshme.

Mbetjet tjera të rrezikshme duke përfshirë mbetje spitalore prej klinikave të mjekësive familjave bashkohen me rrymën e mbeturinave të përgjithshme dhe dërgohen në deponi pa trajtim të veçantë. Krijimi i sistemeve të integruara të mbeturinave dhe organizimi i shërbimit referuar llojit të mbeturinave të gjeneruara kërkon angazhim të të gjithë akterëve në proces me rëndësi të veçantë edhe inspektoriatin. Komuna në planët e saj parasheh trajtimin e mbeturinave referuar rrymës që i përkasin si dhe krijimin e qendrave të ndarjes në njësi komunale duke i bashkërenduar me zhvillimin e fushatave të informimit për qytetarë.

5.8 Deponimi i mbeturinave

Shërbimi i deponimit të mbeturinave për komunën e Deçanit ofrohet nga kompania komunale “Higjiena”, përmes deponisë rajonale të Pejës, e cila gjendet në fshatin Sverkë në distancë prej 26 km në njërin drejtim. Mungesa e aseteve transportuese adeqate dhe trafiku rrugor parashihen si problematikë gjatë bartjes dhe deponimit të mbeturinave në deponi. Kostoja e deponimit ngarkon tarifën prej 3 Euro për çdo ton të mbeturinave komunale të deponuara, tarifë kjo sa gjysma e tarifës së aplikuar nga Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK). Mungesa e aktiviteteve të riciklimit e cila synon reduktimin e sasisë dhe volumit, si rrjedhojë reduktimin e kostove të transportit, adreson kërkesën e ngarkesës shtesë me kosto financiare referuar kosto të transportit, amortizimit të pajisjeve dhe eficiencës në kohë.

5.9 Shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shërbime tjera mirëmbajtjeje

Përpos organizimit të sistemit efikas për menaxhim të mbeturinave, impakt në aspektin mjedisor, estetik dhe shëndetsor të një komunë kanë edhe shërbimet e mirëmbajtjes së hapësirave publike. Referuar të dhënave, kompania publike komunale SH.A “Higjiena” përmes aktivitetit sekondar të kompanisë publike që bazohet në kontrata të veqanta me komunën e Deçanit është përgjegjëse sipas kushteve kontraktuale për:

- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, pastrimi i rrugëve, mirëmbajtja e gjelbrimit (kontratë tri vjeçare)
- Mirëmbajtja e kanalizimit të ujrave të zeza
- Pastrimi i borës në rrugët urbane (ende nuk është zbatuar)
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e memorialeve të dëshmorëve

Vlera e përafërt e kontratave për shërbime sekondare të kontraktuara (zbatuara) është rreth 91,320.00€.

5.10 Mjetet për ofrimin e shërbimit

Mjetet për ofrimin e shërbimit sipas të dhënave do të përmblihen në:

Kontenierë për grumbullim

Të dhënat paraqesin se, Komuna e Deçanit ka të shpërndarë në territorin e saj gjithsej 963 kontenierë sipas shërbimit derë më derë 5080 shporta 120 dhe 240 l apo nëpër pika të përbashkëta grumbullimi 160

Konteneire 1.1 mkub dhe 3 7t . E gjithë kjo infrastrukturë është në pronësi të komunës dhe në shfrytëzim të kompanisë publike.

Në tabelën më poshtë jepet lloji dhe numri i konteinerëve që operojnë në Komunën e Deçanit:

Tabela 5. Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave

NR.	LLOJI I KONTEJNERËVE	KAPACITETIT	NR. KONTEJNERËVE 2020	VITI I FILLIMIT TË PËRDORIMIT	GJENDJA E TYRE
1	Plastik	240 litra	1600	2018	E mire
2	Plastik	120 litra	3480	2019-2020	E mire
3	Plastik	1.1 m ³	80	2019	E mire
4	Metalik	1.1m ³	80	2019	E mire
5	Metalik (arkë)	7m ³	3	/	

Kamionë

Në bazë të të dhënave të mbledhura, Kompania Higjiena operon me nëntë mjete për mbledhjen e mbeturinave komunale, të cilat janë kryesisht me motorrikë të vjetëruar.

Tabela 6. Logjistika e operimit për grumbullimin e mbeturinave

Regjistrimi	Prodhuksi	Tipi i Asetit	Viti i prodhimit	Masa e lejuar bartëse(kg)
03-271-GN	Volvo	FLH 42 RD 18 A	2007	7146
03-469-CO	Man	/	1990	4700
03-681-AR	Iveco	/	2001	4500
03-391-CG	Mercedes – benz	Econic 2633	2004	10140
03-394-GN	Scania	P94 DB4X2LB 300	2004	6925
03-152-GO	Peugeot		2008	/
03-329-GP	Mercedes – benz	Econic 2628	2001	10850
03-584-DU	Man	T08	1996	10850
229-KS-517	Iveco	MP 308 E 37 H	1999	24550
/	Eskavator	/	/	/
03-270-228	Ferguson	/	/	1500

5.11 Financat dhe të hyrat financiare

Aktualisht Ndërmarrja publike Komunale “Higjiena” Decan realizon inkasimin apo vjeljen e tarifës së shërbimit. Sfidat e komunës në krijimin e ndërmarrjes komunale dhe shtrirjen e shërbimit në zonat pa mbulim dhe ku shërbimi kryhej pa leje të veçantë prej operatorëve joformalë në kontratë joformale me qytetarë, ka ndikuar në planifikimin e të hyrave të kompanisë. Duke qenë se shërbimi është shtrirë në fundin e vitit referent 2019, bartja e borxheve dhe përgatitja e faturave vijon edhe në vitin kalendarik 2020

prej kompanisë "Higjiena". Aplikimi I tarifave të përcaktuara në Rregulloren komunale për mbeturina ndahet sipas kategorive të klientëve ku tarifat e aplikuar janë:

- Në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë aplikohet tarifa fikse 4.65 eu në muaj;
- Në kategorinë e konsumatorëve komercialë tarifa varion prej 5.4 për subjektet e vogla shërbyese në 12.10 euro në subjektet të mesme dhe të mëdha komerciale (për zbrasje të kontenierit 1.1mkub). Tarifa e përcaktuar për zbrasje të kontenierëve 7mkub është e përcaktuar në vlerë 36.8 euro/muaj.

Të dhënat mbi aspektet financiare të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Deçanit janë paraqitur në dy tabelat në vijim, të cilat grupojnë përkatësisht (i) çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues dhe (ii) të kostos së dhënies së shërbimit e buxhetimit të tij.

(i) Çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues

Së pari, të dhënat e mbledhura tregojnë një diferencë të theksuar midis numrit të subjekteve të cilëve ju faturohet tarifa e shërbimit dhe kanë kanë realizuar pagësen e faturës, diferencë kjo e cila reflekton nivelin e mbulueshmërisë së shërbimit dhe faturimin paralelisht.

Sipas të dhënave të ofruara prej kompanisë inkasimi I kompanisë prej vitit 2018 është në rritje si efekt I shtrirjes së shërbimit në nivel territorial dhe referuar të dhënave të ofruara për vitin 2019 vlerësuar me numrin e bizneseve në faturim të kostos së dhënies së shërbimit në vitin 2019 dhe inkasimit të tij.

Tabela 7. Të dhëna lidhur me inkasimin për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, Higjiena

Inkasimi i të hyrave	2018	2019	2020 (6 mujor)	% inkasimit (6 mujore)
Amvisëri	49,842.43	77,101.32	93,093.97	69% ek residente
Biznes	28,881.65	41,913.71	18,649.94	45.5*
Institucione	19,109.44	43,966.91	27,436.90	89%
Të tjera	13,292.27	406.78	46,296.30	Sekondare
TOTALI:	111,125.79	163,388.66	185,477.11	

Duhet të merret në konsideratë që komuna ka bërë shtrirjen graduale të shërbimit dhe ka marrë ëprsisipë borxhet e akredituara prej subjekteve ku kryhet shërbimi. Megjithatë përlllogaritja e kostove

Tabela 8. Kostot potenciale të të ardhurave

		Kliente totale (te dhena prej komunes)	
Qyteti/Fshat	Ekonomi familjare	Biznese	Insitucione
Deçan	6,349	2250	34
Të hyra të inkasuara prej shërbimit(vjetore dhjetor 2019)	77,101.32€	41,913.71€	43,966.91€
Të hyra të planifikuara prej shërbimit 100% (vjetore)	286.866 €	230.576*€	43,966.91 €
% e inkasimit të tarifës së shërbimit 2019	27%	18%	100%

% e inkasimit të tarifës së shërbimit në gjashtëmujorin e vitit 2020	64%	16%	100%
--	-----	-----	------

*Numri ekonomive familjare sipas të dhënave nga komuna

Shuma potenciale e të ardhurave nga niveli aktual i shërbimit, sipas tarifave që zbatohen aktualisht për subjektet pagues është përlogaritur në bazë të numrit të familjeve që marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve, numrit gjithsej të bizneseve, si dhe numrit gjithsej të institucioneve në Komunën e Deçanit.

Sipas të dhënave të raportuara inkasimi për vitin referent 2020 (gjashtë mujori I parë) sipas shërbimit vetëm në klientët ku ofrohet shërbimi grumbullimit të mbeturinave është rreth 69% për amvisëri residente, rënie për biznese dhe 89% për institucione, sipas raportimit krahasues Arkëtimi për shërbim për të gjitha kategoritë (vitin 2019) të hyrat janë rreth 163,388.66 euro ndërkohë në gjashtë mujorin e parë të 2020 është 185,477.11 euro, e cila tregon një përqindje të mirë të rritjes së shkallës së inkasimit. Njëherësh komuna sipas kontratave të ndryshme për aktivitetet sekondarë që ofrohen prej kompanisë publike ofron pagësë konform buxhetit (viti 2019) sipas kontratës menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapsirave publike, pastrimi i rrugëve, mirëmbajtja e gjelbrimit për tri vite 15,624.00€, mirëmbajtja e kanalizimit të ujrave të zeza është 36,400.00€, pastrimi i borës në rrugët urbane (ende nuk është zbatuar) 72,558.00€, pastrimi dhe mirëmbajtja e memorialeve të dëshmorëve 49,920.00€. Sipas të dhënave të ofruara prej zyrtarëve komunalë aktiviteti sekondar i kontraktuar prej komunës në kompaninë Higjiena është në vlerë financiare rreth 364,128 euro në vit (2020 vit referent). Shpenzimet operative të ndërrmarjes për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në periudhën gjashtëmujore të vitit 2019 raportohen rreth 115 000 duke përfshirë kostot direkte, indirekte dhe shpenzime operative të ndërrmarjes. Shtrirja e shërbimit në nivel territorial, nevoja për pajisje shtesë opërimi dhe kapacitete njerëzore sjell rrjedhimisht rritje të shpenzimeve për grumbullimin e mbeturinave. Në vlerë të përafërt referuar përlogaritjeve sipas planit komunal (referuar PKMM 2018-2022), kostoja e ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave planifikohet rreth 200,169.00 euro në vit pa llogaritur kostot investime për shërbim. Nëse llogaritet kostoja e investimit atëherë kostoja për MM është rreth 505 mijë euro sipas planifikimeve në plan komunal.

5.12 Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga vlerësimi i gjendjes fillestare

Duke Konsideruar si bazë reference vitin 2019-2020. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Deçanit ka një kosto gjithsej prej mbi 200,000 euro/vit pa llogaritur kostot kapitale.

- o Shërbimi ofrohet përafërsisht për 100% të popullsisë.
- o Shpeshtësia (frekuenca) e mbledhjes së mbetjeve urbane është 7 herë / javë për zonën urbane të qendrës së qytetit dhe 1 herë në javë për zonat rurale ku përfshihen të gjitha njësitë e tjera administrative.
- o Me riorganizimin territorial të shërbimit referuar efektivitetit dhe eficiencës objektivi strategjik i komunës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve është plotësimi me infrastrukturë të grumbullimit për 1500 amvisëri në territorin e saj referuar politikave të mëparshme të komunës për pajisje dhe unifikim të mjeteve të kryerjes së shërbimit.
- o Me shtrirjen e shërbimit në komplet territorin dhe referuar mjeteve motorike të vjetëruara komuna duhet të adresojë ceshtjen për përmirësimin e kapaciteteve të operimit për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.
- o Deri me tani, Komuna ka përmbyshur objektivën e saj strategjike për shtrirje të shërbimit në njësi territoriale të territorit komunal.

5.13 Nevojat dhe prioritetet

Gjenerimi i mbetjeve në territorin e komunës ka efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, i cili është prioriteti kryesor i komunës Deçan nga pikëpamja ekonomike si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.

Nevojat të cilat duhen marrë parasysh në zbatimin e planit në harmoni dhe me planin komunal për menaxhim të mbeturinave të komunës janë renditur si me poshtë:

- Rehabilitimi i zonave me ndotje prej deponive të ilegale dhe revitalizimi i tyre duke i kthyer në zone të gjelbra me vlere rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë;
- Inventarizimi dhe diagnostikimi i vend-depozitimeve, si dhe përcaktimi i prioritetëve, planifikimi dhe raportimi;
- Zhvillimi i infrastrukturës së përshtatshme për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave;
- Aprovimi i një buxheti të mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave referuar planeve dhe objektivave;
- Hartimi i programeve për ndarje në burim të mbeturinave;
- Ngritjes së një qendre multifunksionale ose përndryshe Objekti për grumbullimin dhe Reduktimin e Mbeturinave që do të shërbejë për trajtimin e mbetjeve të ngurta komunale duke përfshirë, mbetjet voluminoze, kompostimin dhe selektimin e mbetjeve të riciklueshme;
- Krijimi i kushteve të duhura për donatorët ndërkombëtarë për të financuar infrastrukturën e nevojshme;
- Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve dhe monitorimi i shërbimit në përgjithësi.

Sipas qëllimeve të vendosura në planin për menaxhim të mbeturinave komunale, objektivat primare në menaxhim të mbeturinave komunale janë fokusuar në marrjen e masave emergjente për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës komunale për mbledhjen, transportin dhe depozitim të sigurt të mbeturinave komunale si dhe rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

Kjo do të përfshijë zbatimin e skemave për shtrirjen e shërbimit bazik në nivel të komplet territorit dhe popullsisë së shërbyer dhe aktivitete tjera që rrisin performancën për ofrimin e shërbimeve bazike, zbatimin e programeve të minimizimit të mbeturinave përfshirë ndarjen në burim për riciklim dhe kompostimin për të reduktuar në mënyrë progresive sasinë e mbeturinave për deponim final në deponi (2020-2022) si dhe trajtimin adekuat të mbeturinave me qëllim zvogëlimin e rrezikut që shkaktojnë në mjedis. Në të njëjtën kohë do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e financave komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Objektivat janë strukturuar duke marrë parasysh qëllimet e përcaktuara prej komunës së Deçanit në planin komunal për menaxhim të mbeturinave 2017-2022, duke analizuar objektivat e vendosura dhe duke analizuar gjendjen ekzistuese të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në komunë. Krahas saj, vlerësimi i gjendjes ekzistuese të sektorit rishikon përbushjen e objektivave të përcaktuara në plan dhe nevojën për plotësime shtesë apo rishikimin e tyre.

Përsa i përket realizimit të objektivave të arrira, në mënyrë të përmblodhur ato do të konsistojnë:

Qëllimi 1: Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të grumbullimit të mbeturinave; në të cilën janë të përbushura O1 dhe O2. Keto objektiva të përbushura do të ndërlidhen me O1: Riorganizimi i zonave për shërbime të grumbullimit të mbeturinave me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimit në pesë vitet e ardhshme dhe O2: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë territorin e komunës së Deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.

Ndërkohë që O3: Optimizimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave, referuar planit nuk është i përmbushur në tërësi.

Objektivi kryesor I planit bazohet në objektivat kombëtare për menaxhim të mbeturinave lidhur me ndërmarrjen e masave përmes së cilave, Komuna do të duhej të zvogëlojë sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen me qëllim ngritjen e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.

Në harmoni me këto politika, Komuna e Deçanit do të planifikojë objektiva specifike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Ngritjen e infrastrukturës për ndërtimin e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave (Zvogëlim – Ripërdorim - Riciklim) pra për të krijuar kushtet për funksionim më efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave
- Përmirësimi i shërbimit për mbledhjen e mbeturinave komunale (përmirësimi e sistemit aktual, zgjerimi/plotësimi i zonave të grumbullimit, ekzamenimi dhe harmonizimi i kapaciteteve për deponimin e mbeturinave).
- Edukimin e publikut, ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimi
- Rishqyrtimin e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave;

Në këtë kontekst, objektivat e PMIM për Komunën e Deçanit do të fokusohen në:

1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në mënyrë të unifikuar në nivel territorial.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eliminimin e të gjitha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brënda territorit të komunës.
3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar të tyre për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbeturinave.
4. Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

6. PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE KOMUNALE

6.1 Planifikimi strategjik dhe vizioni

Politikat e nivelit qendror dhe lokal në Kosovë në menaxhim të mbeturinave parashtrojnë si domosdoshmëri zhvillimin e alternativave të qëndrueshme përmes praktikave të trajtimit të mbeturinave sipas llojit të tyre. Vazhdimi i sistemit aktual të deponimit të mbeturinave nuk konsiderohet të jetë një opsion i qëndrueshëm si rezultat i zvogëlimit të kapacitetit të deponive vijuar me politikat sociale, ekonomike dhe mjedisore.

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturina kanë përcaktuar 2 periudha të rëndësishme kohore: faza e parë dhe e dytë (2013-2017 dhe 2017-2022) ku synohet përparimi drejt standardeve të BE dhe arritja e standardeve dhe objektivave të BE. Në këtë kuadër, politikat nacionale synojnë progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

Referuar politikave të nivelit lokal, zhvillimi i Planit Komunal për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave synon të adresojë zgjidhje efikase dhe me kosto efektive për të zvogëluar sasinë e mbeturinave të deponuara, për të menaxhuar në mënyrë efektive mbetjet e ngurta dhe për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të integruar të mbeturinave të komunës së Deçanit mori formë si një proces i analizimit të situatës aktuale dhe mundësive për hartimin e objektivave që synojnë menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave komunale.

Në fund, duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbeturinave, prioriteteve të përgjithshme si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, u përcaktua vizioni i komunës i cili synon të jetë:

“Deçani qytet ekologjik që promovon vlerat e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor përmes zhvillimit të ekonomisë së gjelbër dhe eko turizmit malor”

Objekti kryesor i planit bazohet në objektivat kombëtare për menaxhim të mbeturinave lidhur me ndërmarrjen e masave përmes së cilave, Komuna do të duhej të zvogëlojë sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen me qëllim ngritjen e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale:

Në harmoni me këto politika, Komuna e Deçanit do të planifikojë objektiva specifike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Ngritjen e infrastrukturës për ndërtimin e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave (Zvogëlim – Ripërdorim - Riciklim) pra për të krijuar kushtet për funksionim më efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave
- Përmirësimi i shërbimit për mbledhjen e mbeturinave komunale (përmirësimi e sistemit aktual, zgjerimi/plotësimi i zonave të grumbullimit, ekzamenimi dhe harmonizimi i kapaciteteve për deponimin e mbeturinave).
- Edukimin e publikut, ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimi
- Rishqyrtimin e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave;

Në këtë kontekst, objektivat e PMIM për Komunën e Deçanit janë:

1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në mënyrë të unifikuar në nivel territorial.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eliminimin e të gjitha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brënda territorit të komunës.
3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbeturinave.
4. Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

Zbatimi i këtij Planit do të shtrihet në planin kohor 5 vjeçar 2020 – 2025. Treguesit dhe buxheti i zbatimit të Planit monitorohen dhe rishikohen çdo vit në kuadër të procesit të përgatitjes së paketës fiskale dhe buxhetit vjetor të komunës.

6.2 Objektivat dhe Rezultatet e PMIM

Përcaktimi i objektivave shërben për të përcaktuar dhe menduar se çfarë do të jetë më e rëndësishme për Komunën e Deçanit, si dhe për të marrë një vendim përfundimtar mbi zhvillimin e shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave. Paraqitja e rezultateve ndihmon për të bërë zgjedhjet e duhura me fokus në përmirësimin e shërbimit dhe monitorimin e performancës së komunës së sektorit. Për të përmbushur objektivat e këtij plani, Komuna e Deçanit ka vendosur këto tregues për objektivat që do të realizohen nga zbatimi i Planit.

Objektivi 1: Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove dhe shërbimit në komunën e Deçanit.

Tabela 9. Objektivi I sipas PMIM

Objektivi 1: Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizim të kostove dhe shërbimit në komunën e Deçanit.							
Komuna Deçan		Mbulimi me infrastrukturë për shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave					
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2020	2021	2022	2023	2024	2025
Zona është e mbuluar 100 % me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.	Zona I	100%	100%	100%	100%	100%	100%
	Zona II	77%	100%	100%	100%	100%	100%

Totali	Komuna Deçan	88.5%	100%	100%	100%	100%	100%
---------------	-------------------------	--------------	------	------	------	------	------

Referuar numrit të amvisërive në komunë, në total janë 6349 amvisëri ndër të cilat 4810 residente dhe 1539 ek. Familjare jo residente.

Referuar Sistemi i grumbullimit të mbeturinave i cili përbëhet me infrastrukturën si në vijim:

- Shtëpitë individuale me kontejner 120l (në të gjithë zonën e shërbimit ubane dhe rurale);
- Banimet kolektive me kontejner 1.1 m³;
- Bizneset në zonën rurale dhe periurbane me kontejner 120 l;
- Bizneset në zonën urbane me kontejner 1,1 m³;

Komuna do të duhet të të planifikojë buxhet për blerjen e 1500 kontenjereve 120 l të nevojshëm për shërbim dhe të bëjë shpërndarjen e tyre në cdo amvisëri (tek amvisëritë residente), duke mbuluar në këtë mënyrë infrastrukturë të njëjtë të grumbullimit në nivel territori (në fundt të afatit kohor 2021).

Objekti 2: Ndarjen e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit

Në këtë drejtim kjo objektivë e caktuar synon të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare për reduktimin e mbetjeve.

Për të arritur këtë objektiv, Komuna e Deçanit do të synojë ofrimin e këtij shërbimi në dy standarde sipas ndarjes territoriale në dy zonat e shërbimit.

1. Zona e I-rë:
 - Zona Urbane Deçan: procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë në vitin 2021;
 - Qyteti i Deçanit: procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë në vitin 2021, në të gjitha institucionet shkollore dhe lagje pilot 300 amvisëri dhe zonë urbane 2 lokacione .
2. Zona e II-të
 - Në Zonën e II-të, procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të fillojë nga viti 2022;
3. Zona e III-të
 - Në zonën e III-të procesi i reduktimit nëpërmjet riciklimit planifikohet të zgjerohet përgjatë vitit 2022-2025.
4. E gjithë komuna
 - Përsa i përket riciklimit në zonat rurale të komunës së Deçanit do të filloje pilotimin e mbledhjes derë me derë të mbetjeve të riciklueshme 1 here në javë në zona të cilat do të përzgjidhen nga komuna gjatë vitit 2021.
 - Gjate viteve 2021-2023 shërbimi do të shtrihet në 50% të territorit të komunës.

Tabela e rezultateve dhe tregueseve të indikatorëve për Objektivin 3 paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Tabela 10. Objekti 2 sipas PMIM i ofrimit të shërbimit për ndarje në burim .

Objektivi 2: Ndarjen e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit

Komuna Deçan			Mbulimi me shërbimin e grumbullimi të diferencuar dhe ndarjen në burim				
Rezultati	# Zona	Viti	2021	2022	2023	2024	2025
		bazë 2020					
Në qytetin e Deçanit është vendosur një sistem efektiv për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve të riciklueshme	Zona I	0%	10%	20%	35%	45%	50%
	Zona II	0%	10%	20%	35%	45%	50%
Në qytetin e Deçanit është vendosur një sistem efektiv për mbledhjen e diferencuar të mbetjeve për kompostim	Zona I	0%	0%	15%	20%	25%	35%
	Zona II	0%	0%	15%	20%	25%	35%
Rezultati Komuna Deçan Riciklim		0%	10%	20%	35%	45%	50%
Rezultati Komuna Deçan kompostim		0%	0%	15%	20%	25%	35%

Objektivi 3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës

Referuar objektivës së caktuar Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata –riciklueshme dhe organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit.

Në këtë mënyrë parashikohet që në të gjithë territorin e komunës në fund të afatit të këtij plani sasia e mbetjeve që depozitohen në deponi do të reduktohen me rreth 27%. Në këtë masë nuk llogaritet mbetjet e tjera të cilat trajtohen në formë të veçantë.

Tabela 61. Objektivi i III sipas PMIM

Objektivi 3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës							
Komuna Deçan			Reduktimi i mbetjeve				
Rezultati	# Zona	Viti	2021	2022	2023	2024	2025
		bazë 2020					

% mbetjeve të reduktuara prej rrymës së mbeturinave	Zona I	0%	2%	9%	17%	22%	27%
	Zona II	0%	2%	9%	17%	22%	27%
Totali	Komuna Deçan	0%	2%	9%	17%	22%	27%

Objekti 4: Të realizojë Grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi

Për të realizuar këtë objekt, komuna duhet të organizojë sistem të:

0.4.1 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave shtazore

0.4.2 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave medicinale

0.4.3 : Menaxhim i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore

0.4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme

0.4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme-fraksioni të thata

0.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim -fraksioni organike

Komuna do të vendosë një sistem tarifar i cili do të mbulojë kostot e ofrimit të shërbimit të largimit të këtyre mbetjeve dhe trajtimit të tyre

Tabela 72. Objekti i IV sipas PMIM

Objekti 4: Të realizojë Grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi							
Komuna Deçan		Reduktimi i mbetjeve					
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2020	2021	2022	2023	2024	2025
% mbetjeve shtazore të grumbulluara të cilat janë eliminuar nga rryma e mbeturinave të përbashkëta.	Bisnese		80 %	90 %	95 %	95 %	95 %
% mbetjeve medicinale të grumbulluara të cilat janë eliminuar nga rryma e mbeturinave të përbashkëta.	Komplet territori	0%	20%	40%	60%	80%	95%
% e deponive ilegale të egra të eliminuara	Komplet territori	20%	80%	100%	100%	100%	100%
% e mbeturinave inerte të depozituara në deponinë inerte	Komplet territori	50%	90%	100%	100%	100%	100%

% e mbeturinave të vëllimshme të depozituara në qendrën e grumbullimit	Komplet territori	0%	50%	100%	100%	100%	100%
Totali	Komuna Deçan	35%	52%	76%	84%	92%	98%

Tabela: Objektivi 4 i ofrimit të shërbimit grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta.

Objektivi 5: Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e koston të shërbimit nga të ardhurat prej tarifës.

Për të realizuar këtë objektiv, komuna do të vendosë një sistem tarifar i cili do të mbulojë kostot e ofrimit të shërbimit të largimit të mbetjeve të ngurta urbane nga territori i komunës.

Gjithashtu norma e mbledhjes së tarifave do të planifikohet e njëjtë pavarësisht zonave të shërbimit. Kjo për arsye se llogaritja e kostove është ndarë sipas kategorive të prodhuesve të mbeturinave .

Në lidhje me koston (5.1) dhe të ardhurat (5.2):

Tabela 13. Objektivi 5.1 sipas PMIM

Objektivi 5.1 : Mbulimi i koston nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit dhe trajtimit të mbeturinave							
Indikatorët e Rezultatit 2021 - 2025							
Rezultati	# Zona	Viti bazë 2020 (gjashtë mujori vjetor)	2021	2022	2023	2024	2025
Kosto e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave mbulohet nga të ardhurat prej tarifës së këtij shërbimi	Ekonomi Familjare		80 %	85 %	95 %	95 %	100 %
	Institucione		100%	100%	100%	100%	100 %
	Bisnese	18%	85%	90%	90%	95%	100%

Tabela 84. Objektivi 5.2 sipas PMIM

Objektivi 5.2 : Rritja e mbledhjes së të ardhurat prej tarifës së shërbimit/Arkëtimi						
Indikatorët e Rezultatit 2021- 2025						
Rezultati	# Zona	2021	2022	2023	2024	2025
	Ekonomi Familjare	229 492	243 836	272 522	272 522	286 866
Tarifa e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave nga	Institucione	43,966.91	43,966.91	43,966.91	43,966.91	43,966.91

familjet mbledhet në të gjithë komunën						
	Bisnese	195 989	207 518	207 518	219 047	230 576
TOTAL Arketim (Euro)		469 447.91	495 320.91	524 006.91	535 535.91	561 408

7 VLERËSIMI DHE ANALIZA E PËRBËRJES SË MBETURINAVE KOMUNALE

7.1 Kriteret për planifikim

Në bazë të legjislacionit ekzistues, Plani Komunal për Menaxhim të IntegrUAR të MbeturINave do të fokusohet në planifikimin e programeve për minimizim dhe trajtim të sigurtë të mbeturinave sipas potencialit gjenerues të fraksioneve të mbeturinave komunale të gjeneruara, për të cilën Komuna e Deçanit është drejtpërdrejtë përgjegjëse. Përgjegjësia e komunës duke u referuar kompetencave të komunave në pajtim me Ligjin për Mbeturina do të bazohet ndër të tjerash në:

- Hartimin dhe miratimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave;
- Përcaktimet e lokacioneve, bazuar tek plani hapësinor, sipas nevojave përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Përcaktimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Caktimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për grumbullimin e mbetjeve.

Krahas saj, një planifikim i programeve efikase të komunës në menaxhim të mbeturinave do të bazohet në kapacitetin gjenerues dhe të mbeturinave komunale, sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbeturinave, mbeturinat komunale do të klasifikohen në:

- Mbeturina urbane (mbeturina të amvisërisë),
- Mbeturina të veçanta urbane (mbetje inerte e ndërtimore, mbeturina të vëllimshme: pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbeturina të rrezikshme që prodhohen brënda territorit të komunës.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbeturinave, Mbeturinat urbane ndahen në dy rryma, sipas burimit të origjinës: (MF) Mbeturinat e prodhuara nga familjet; (MB) Mbeturinat e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbeturinave nuk ndryshon nga karakteristikat e mbeturinave urbane. Ndërkohë, rryma të tjera të mbeturinave do të klasifikohen si mbeturina masive, mbeturina të ngurta (inerte) që prodhohen në familje dhe që do të trajtojmë si 'mbeturina të veçanta' për të cilat Komuna duhet t'i ofrojë alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

Një element kryesor i planifikimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave është "identifikimi dhe shqyrtimi i alternativave" të qëndrueshme duke ju referuar analizës së potencialit të gjenerimit të mbeturinave sipas fraksioneve dhe planifikimin e programeve për trajtimin e tyre. Planifikimi i programeve do të shqyrtojë mundësitë e ndryshme teknike dhe strategjike për menaxhimin e mbeturinave sipas planit të objektivave, vlerësimit të shkallës së zbatimit të tyre, avantazheve dhe disavantazheve ekonomike, ligjore, mjedisore, sociale si dhe teknologjive në dispozicion për këto alternativa.

7.2 Gjenerimi i mbeturinave

Për të parashikuar se si do të menaxhohen mbeturinat në të ardhmen për Komunën e Deçanit, duhet të vlerësohet gjenerimi aktual i mbeturinave që të parashikojmë ecurinë e tyre për një periudhë afatmesme (3-5 vite). Të dhëna të sakta për gjenerimin e mbeturinave nevojiten për planifikimin e një shërbimi të ri apo ndryshime në shërbimin ekzistues të grumbullimit të mbeturinave, për projektimin e tarifave lokale për konsumatorët, për hartimin e planit (për vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe përcaktimin e objektivave mbi fraksionet e mbeturinave) si dhe për procesin e monitorimit të zbatimit të planeve. Gjithashtu, ka rëndësi të përcaktohen cilat fraksione të mbeturinave janë nën përgjegjësinë e komunave dhe cilat jo, të klasifikohen mbeturinat sipas burimit të origjinës dhe të jepen zgjidhje për trajtimin e tyre, ku sipas burimit të klasifikohen nëse janë të dëmshme (të rrezikshme) apo jo dhe në lidhje me kushtet e trajtimit/përpunimit të mbeturinave dhe metodat për tu aplikuar që disponohen apo do duhet të sigurohen në të ardhmen prej komunës së Deçanit.

Një nga pengesat kryesore në komuna në Kosovë është mungesa e të dhënave statistikore lidhur me sasinë dhe llojet e mbeturinave të gjeneruara në burim për nivel territorial sipas komunave ku përgatitet planifikimi. Me qëllim parashikimin e administrimit të mbeturinave në të ardhmen në Komunën e Deçanit, është e rëndësishme llogaritja e prodhimit aktual të mbeturinave si dhe parashikimi për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë i shkallës së rritjes së tyre, në varësi me trendet e sjelljes konsumatore.

Këto të dhëna janë të rëndësishme për hartimin e planeve të sakta dhe mundësojnë llogaritjen e situatës aktuale dhe përcaktimin e objektivave si dhe procesin e monitorimit në periudhë kalimtare apo të vazhdueshme. Në mungesë të këtij informacioni, komuna rekomandohet që gjatë përgatitjes së planeve strategjike t'i referohen normave dhe të dhënave kombëtare sipas Strategjisë të Republikës së Kosovës për Mbeturinat dhe Planit të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave ku përllogaritet gjenerimi 0.9 kg/banorë/ditë për zonat urbane dhe gjenerim 0.4 kg/banorë/ditë për zonat rurale, apo mesatarisht 0.78 kg/banorë/ditë ; si edhe njëherësh t'i referohen raporteve mbi sasinë totale të deponimit të mbeturinave.

Gjatë periudhës 2019- 2020, prej zyrtarëve të kompanisë SHA."Higjiena" u grumbulluan të dhënat të nevojshme lidhur me sasinë e mbeturinave të grumbulluara në nivel komunal. Në bazë të këtyre të dhënave, duke iu referuar matjeve sipas metodave përkatëse dhe studimeve sipas raporteve të grumbulluara për këtë Komunë janë gjeneruar rezultate të besueshme për të ndërtuar strategjitë e ardhshme për menaxhimin e mbeturinave sipas rrymave të fraksionit të tyre.

Sipas të dhënave të grumbulluara, sasia totale e mbeturinave të grumbulluara për periudhë gjashtë mujore prej janar-qershor 2020 janë depozituar rreth 3,975 ton mbeturina në deponinë e Pejës prej kompanisë komunale "Higjiena". Shprehur në muaj rreth 622.5 ton në muaj janë grumbulluar prej shërbimit të komunës së Deçanit apo 20.75 ton në ditë mbeturina janë gjeneruar prej banorëve në komunë.

Duke marrë në konsideratë që grumbullimi i mbeturinave kryhet më shtrirje 100% mbulueshmëri shërbimi si edhe duke konstatuar prej informatave të kompanisë ku 70% e sasisë së mbeturinave të deponuara janë mbeturina të amvisërisë (edhe pse nuk ka ndonjë matje të saktë, andaj në konsideratë do të merret sasia totale he banorët resident në këtë periudhë të matjes), kryesisht prej amvisërive residente (4810 ekonomi familjare residente apo 24 050 banorë) referuar situatës do të konsiderojmë që, përafrojmë që rreth 0.64 kg në ditë është norma mesatare e gjenerimit për kokë banori në Komunën e Deçanit.

Përllogaritja e normës së gjenerimit të mbeturinave për kokë banori është variabël i ndryshueshëm që varet prej sjelljes së konsumatorit dhe faktorë të tjerë andaj rekomandohet komuna që analizën e gjenerimit të mbeturinave ta zhvillojë në kampione të caktuar në ekonomi familjare, biznese apo institucione në zona urbane dhe zona rurale.

Analiza e saktë e gjenerimit të mbeturinave për kokë banorë është indikator i përcjellës i të gjitha analizave të rrymave sipas fraksioneve në planin e menaxhimit të integruar të mbeturinave komunale.

Tabela 15. Gjenerimi i mbeturinave për banor në komunë të Deçanit referuar sasisë së deponimit (periudhë gjashtë mujore)

Numri i amvisërive totale ASK	Numri i popullsisë ASK 2011	Numri i amvisërive të shërbyera residente	Numri i përafërt banorëve në ekonomi familjare residente të shërbyer	Sasia totale e mbeturinave: amvisëri, biznese dhe institucione Periudha e llogaritur është 6 mujore (ton)	Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori		
					Ditë kg/ditë	Muaj kg/muaj	Vit kg/muaj
5,887	40 009	4810	32 227	3,975	0.64	19.2	230

Tabela 96. Gjenerimi i mbeturinave për periudhë 1 vjeçare në komunën e Deçanit

Numri i amvisërive të shërbyera	Numri i banorëve në ekonomi familjare të shërbyer	Sasia e mbeturinave: amvisëri, biznese dhe institucione X kg/ditë për banorë	Sasia mesatare e gjeneruar mbeturinave në nivel komunal		
			Ditë ton/ditë	Muaj ton /muaj	Vit ton /vit
5,887	40 009	0.64 kg ditë	26	780	9 360 ton

Referuar këtyre të dhënave sasia e mbeturinave të gjeneruara për kokë banori në muaj për vitin 2020 është 19.2 kg, ndërsa për ditë është rreth 0.64 kg. Krahasimi i këtyre rezultateve me normën mesatare të përlllogaritjes të ofruar prej nivelit qendror sa i përket shkallës së gjenerimit të mbeturinave për tërë Kosovën (mesatarja e llogaritur sipas agjensionit 0.78 kg mbeturinë/ditë/banorë, zona rurale 0.4 kg në ditë) ka dallim duke marrë në konsideratë karakterin gjysëm urban të komunës duke gjeneruar 0.14 kg me pak mbeturinë në ditë për kokë banori.

Kjo përlllogaritje merr në konsideratë vetëm llojin e mbeturinave të amvisërisë të grumbulluara dhe raportuara prej kompanisë komunale “Higjiena”, grumbullimi i së cilës konsiston vetëm për rrymën e mbetjeve të amvisërisë (jo rryma tjera të mbeturinave si psh mbetje voluminoze, prishjeve etj).

7.3 Përbërja e mbeturinave në komunën e Deçanit

Analiza e përbërjes së mbeturinave (analiza mercologjike/analiza e fraksioneve) komunale shërben kryesisht për të përcaktuar përbërjen e mbeturinave komunale dhe më konkretisht duke përcaktuar sasinë (peshën ose %) e fraksioneve të mbeturinave të riciklueshme, të kompostueshme apo mbeturinave të llojeve të tjera që gjenden brenda rrymës së mbeturinave komunale.

Përmes këtyre të dhënave do të mund të përcaktohet potenciali i mbeturinave komunale që mund të reduktohet, ripërdoret, kompostohet apo të trajtohet me teknika të tjera për përfitim energjie sipas

skenarëve dhe opsioneve praktike, ekonomike për trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave të ngurta urbane sipas objektivave zhvillimore.

Aktualisht nuk ka asnjë matje të rrymave të mbeturinave sipas llojit që gjenerohen në territorin kësaj komune. Studime të mëparshme të kryera në zona me tipologji të përafërt mund të na japin një pamje të përafërt të gjenerimit të këtyre rrymave edhe për Komunën e Deçanit.

Sipas analogjisë, Vlerësimi i sasisë së mbeturinave në përgjithësi dhe sasisë sipas fraksioneve, të cilat gjenerohen është bazuar mbi të dhënat e Komunës së Deçanit si dhe rezultatet e matjeve dhe të analizës së mbeturinave që janë organizuar nga GIZ në vitin referent 2012 në komunën e Prishtinës. Gjatë studimit të përbërjes së mbeturinave të marrura në burim, kampionët e analizuar të mbeturinave janë marrë në zona të caktuara dhe kohë të caktuar.




Figura 6. Diagrama e përbërjes së mbeturinave (raporti GIZ 2012/ AMMK 2014)

Duke u bazuar në rozen e përbërjes së mbeturinave (raporti GIZ 2011), përbërja mercologjike e mbetjeve është paraqitur në tabelën që vijon:

Tabela 107. Përbërja e mbeturinave në komunën e Deçanit sipas gjenerimit

Mbeturina	%	Sasia ditore sipas fraksionit ~	Sasia ditore Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë)	Sasia vjetore Komuna Deçan (ton/vit/2020)
Totali mbeturina	100.00%	0.64 kg/ditë	~19 kg/muaj	9 360
Te njoma	40.87%	~ 0.41	7.8 kg	3.838

<u>Të riciklueshme</u> ²	33.24%	~ 0.33	6.27 kg	3 089
Te tjera	25.89%	~ 0.26	~4.93 kg	2 433

Sasia e biodegradueshme organike është në përqindje më të lartë duke çuar drejt mundësisë së prezantimit të skemave të kompostimit të mbeturinave, kryesisht në zonat me shtëpi private apo në zonat rurale me kapacitet më të lartë për kompostim. Duhet të marrim në konsideratë që ky fraksion i mbeturinave (mbeturina organike) duke përfshirë edhe mbeturinat e gjelbra dhe të kafta prej hapësirave të gjelbëruara mund të variojë prej 41-70 % të përbërjes së mbeturinave totale komunale që gjenerohen në vit.

Tabela 118. Përbërja e mbeturinave të fraksionit të thata/të riciklueshme

Mbeturina	%	Sasia ditore sipas fraksionit	Sasia ditore	Sasia vjetore Komuna Deçan
		~	Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë)	(ton/vit/2020)
Totali mbeturina	100.00%	0.64 kg/ditë	~19 kg/muaj	9 360
<u>Të riciklueshme</u> ³	33.24%	~ 0.33	6.27 kg	3089
Leter / Karton	12.83%	0.13	2.47 kg	1217
Plastike	14.78%	0.15	2.85 kg	1404
Qelq	4.45%	0.04	0.76 kg	374
Metale	1.18%	0.01	0.19 kg	94

Për sa i takon mbeturinave të riciklueshme, letra, karton, plastika, qelqi përfaqësojnë një përqindje të konsiderueshme duke krijuar mundësinë e prezantimit dhe aplikimit të skemave për grumbullimin e ndarë të tyre dhe konsolidimin e një pikë të sortimit të mbetjeve të riciklueshme në komunën e Deçanit. Gjithësesi lind nevoja që periodikisht (1-2 herë në vit) këto matje të ribëhen për të pasur një pasqyrim më të qartë dhe të përditësuar të gjenerimit në përqindje të rrymave të mbeturinave, veçanërisht për të konstatuar Mbeturinat e rrezikshme, si Mbeturinat spitalore apo industriale që hyjnë në rrjedhën e mbeturinave në nivel lokal, me qëllim trajtimin e çështjes nga autoritetet lokale dhe qëndrore.

Lidhur me mbeturinat inerte, nuk posedohet ndonjë matje sasiore e saktë për përllogaritjen e tyre, andaj kjo sasi nuk merret në konsideratë në përllogaritjet e mësipërme. Referuar raportimit vjetor të komunës së Deçanit pranë AMMK, Komuna e Deçanit ka eliminuar në vitin referent 2019 rreth 40 deponi ilegale të dimensioneve të ndryshme, megjithatë prezente janë 21 deponi ekzistuese prej 2017 (periudha referente e verifikimit të deponive ilegale). Kryesisht sasia e deponive ilegale varion sipas madhësisë dhe do të ndahet në :

Tabela 129. Karakteristikat e përbërjes së deponive ilegale në komunën e Deçanit

Karakteristikat e deponive	Sasia në numër	Sasia në përqindje
Mbeturina të amvisërisë (A)	-	-
Mbeturina inerte / ndërtimore (N)	11	52%
Mbeturina industriale dhe të rrezikshme (R)	-	-
Mbeturina të vëllimshme (V)	-	-
Mbeturina të përziera (A, N, R, V)	10	48%
Totali:	21	100.00 %

7.4 Projektioni i rritjes së mbeturinave 2020 – 2025

Parashikimi i prodhimit të mbeturinave në të ardhmen lidhet ngushtë me rritjen e numrit të popullsisë në të shkuarën (Norma vjetore e rritjes në të shkuarën e llogaritur duke iu referuar tendencës së rritjes së popullsisë) si dhe prirjet për prodhimin e mbeturinave në të ardhmen.

Tabela 20. Projektioni i Rritjes së popullsisë

Viti		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Projektioni i rritjes së popullsisë	Nr popullsisë	41,808 ²	42 226	42 648	43 074	43 504	43 939	44 378	44 822	45 270

Bazuar në dokumentet zyrtare të Republikës së Kosovës, indeksi i rritjes së popullsisë parashikohet të jetë afërsisht 1% ku merret parasysh rritja e natyrshme por edhe migrimi dhe emigrimi. Në tabelën më poshtë parashikohet një trend i rritjes së popullsisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Deçanit gjatë 10 viteve të ardhshme.

Tabela 21. Rritja e popullsisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Deçanit gjatë 5 viteve të ardhshme

Viti		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Projektioni i rritjes së popullsisë	Nr popullsisë	41,808 ²	42 226	42 648	43 074	43 504	43 939	44 378	44 822	45 270
Gjerimi për banor kg/dite	2% rritje në				0.64	0.65	0.663	0.676	0.69	0.704
Projektioni i rritjes së sasisë së mbeturinave % (viti referent 2020)	kokë/banor					0.01	0.013			0.064*
Potenciali i gjenerimit të mbeturinave ton/vit					9 360 ton	10 321	10 585	10 950	11 288	11 633

Sipas këtyre parashikimeve rezulton që numri i banorëve në komunën e Deçanit në vitin 2025 do të rritet për 3 462 banorë nga numri aktual. Në vitin 2025 parashikohet që komuna e Deçanit të ketë 45 270 banorë. Sipas të dhënave bazuar në rritjen e popullsisë dhe zhvillimit social e shoqëror ku norma mesatare e rritjes së konsumit për banorë presupozohet të jetë 2% për vit në 10 vitet e ardhshme³. Nëqoftëse kësaj rritje i shtojmë edhe rritjen e popullsisë për 1 % në vit, rritjen e konsumit për 2% atëherë sasia e mbeturinave do të rritet për 0.64 % në 2025 duke marrë si referentë të dhënat prej vitit 2020.

Tabela 132. Rritja e gjenerimit të sasisë vjetore të mbeturinave për kokë banorë⁴

Viti		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Gjerimi për banor kg/dite	2% rritje në kokë/banor				0.64	0.65	0.663	0.676	0.69	0.704
Gjerimi për banor kg/vit	2% rritje në kokë/banor				233.6	237	242	247	252	257

Nga tabela më lart vërejmë që parashikimet për rritje të sasisë së mbeturinave për vitin 2020 do të jenë 233.6 kg/vit dhe 0.64 kg/ditë për kokë banorë, ndërsa në vitin 2025 sasia do të arrijë kuotën prej ~257 kg/vit apo përafërsisht 0.7kg/ditë për kokë banori.

Bazuar në potencialin e rritjes së popullsisë, në normat e rritjes së gjenerimit të mbeturinave dhe kapacitetit të gjenerimit të mbeturinave, do të mund të bëhet një llogaritje e sasisë totale sipas rrymës së gjenerimit të mbeturinave në nivel komunal,

Tabela 23. Llojet e mbeturinave vjetore të gjeneruara në Komunën e Deçanit

		2020	2021	2022	2023	2024	2025
Projeksioni i rritjes se popullsisë	Vlera referente	43 074	43 504	43 939	44 378	44 822	45 270
Potenciali i gjenerimit të sasisë totale të mbeturinave ton/vit		9 360 ton	10 321	10 585	10 950	11 288	11 633
Koeficienti i gjenerimit të mbeturinave për koke banori		0.64	0.65	0.663	0.676	0.69	0.704

⁴ Agjësia e Statistikave të Kosovës 2015,dhe Vlerësim Popullsia e Kosovës 2017 <https://askdata.rks-gov.net/>

* Diferenca e rritjes se norms se gjenerimit të mbeturinave

Fraksioni Organik	~ 0.41	3.838	4,232	4,340	4,490	4,628	4,769
Fraksioni të thata	~ 0.33	3 089	3,406	3,493	3,613	3,725	3,839
Fraksioni të tjera	~ 0.26	2 433	2,683	2,752	2,847	2,935	3,025




Figura 7. Rritja e sasisë së mbeturinave deri 2025 sipas fraksioneve të gjeneruara në Komunën e Deçanit⁵

Të paraqitura në diagram vërejmë tendencën e rritjes së sasisë së mbeturinave të riciklueshme sipas fraksioneve, dhe potencialin përbërës së mbeturinave totale që mundën të ofrojnë në industrinë e riciklimit.

Nga parashikimi (tabela më poshtë) pritet që të rritet sasia e letrës, plastikës, dhe e mbeturinave jo- të degradueshme (p.sh. metali dhe qelqi). Nga ana tjetër, këto rritje mund të rrisin vlerën kalorifike dhe potencialin riciklues të këtij fraksioni të mbeturinave të prodhuara. Në të njëjtën kohë, sasi të relative të gjeteve, mbetjeve drusore kanë gjasa të jenë të vlerave më të mëdha duke marrë në konsideratë tipologjinë e komunës me prezencë të lartë të hapësirave të gjelbra të cilat në mënyrë konstante kërkojnë përkujdesje në pastrimin e rregullt të tyre.

Tabela 144. Përbërja vjetore e mbeturinave të amvisërisë (2020)

⁵ https://ec.europa.eu/environment/enlarg/pdf/pilot%20ëaste/Kosovo_al.pdf

Mbeturina	%	Sasia ditore sipas fraksionit	Sasia ditore	Sasia vjetore Komuna Deçan (ton/vit/2020)
		~	Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë)	
Totali mbeturina	100.00%	0.64 kg/ditë	~19 kg/muaj	9 360
<u>Organike</u>	40.87%	~ 0.41	7.8 kg	3.838
<u>Të riciklueshme⁶</u>	33.24%	~ 0.33	6.27 kg	3089
Leter / Karton	12.83%	0.13	2.47 kg	1217
Plastike	14.78%	0.15	2.85 kg	1404
Qelq	4.45%	0.04	0.76 kg	374
Metale	1.18%	0.01	0.19 kg	94
Te tjera	25.89%	~ 0.26	~4.93 kg	2 433




Figura 8. Fraksionet e mbeturinave në vit (2020)

8 PLANI PËR MINIMIZIMIN E MBETURINAVE

Minimizimi i mbeturinave përfaqëson një tërësi të metodave, aktiviteteve dhe proceseve që kanë si qëllim reduktimin e volumit të mbeturinave të destinuara për trajnimin final. Bazuar në rekomandimet e dokumentave strategjikë dhe direktivave të BE-së, menaxhimi i mbeturinave duhet të marrë në konsideratë opsionet e mëposhtme:

- Parandalimi i mbeturinave: Për të siguruar mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjen e burimeve natyrore, gjenerimi i mbeturinave duhet të minimizohet sa më shumë dhe kur është e mundur të mënjanohet prodhimi i tyre që në burim, ose i quajtur ndryshe “reduktimi në burim” i mbeturinave;
- Ripërdorimi: Ri-përdorimi direkt i produkteve/materialeve të mbeturinave për të njëjtën qëllim dhe natyrë me përdorimin fillestar. Në rast se mbeturinat nuk mund të parandalohen, materialet apo produktet e tyre duhet të ri-përdoren direkt, ose të rinovohen/ përtërihen me qëllim ripërdorimin e tyre;
- Riciklimi/kompostimi: Kur mbeturinat nuk mund të parandalohen apo ri-përdoren, ato duhet të riciklohen ose të ri-përpunohen në një formë, që të mund të përdoren si material të dorës së dytë për një qëllim tjetër nga përdorimi fillestar.

Bazuar në “Hierarkinë e Mbeturinave” sipas Strategjisë Kombëtare për menaxhim të Mbeturinave, kur është e pamundur riciklimi i tyre, ato duhet të trajtohen me përfitim energjetik, ku energjia që çlirohet nga djegja e tyre duhet të përdoret për të zëvendësuar burimet jo të ripërtëritshme të energjisë.

Megjithatë, politika kombëtare orienton nivelin lokal që të ofrojë një sistem të integruar të menaxhimit të mbeturinave. Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave ka përcaktuar disa indikatorë në lidhje me sasinë e mbeturinave që duhet të riciklohen, kompostohen sipas afateve kohore. Politikat e menaxhimit të mbeturinave për Komunën e Deçanit, do të bazohen rreth implementimit të planeve që zbatojnë ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim duke synuar reduktimin e sasisë totale të mbeturinave që deponohen në deponi rajonale dhe duke stimuluar veprimtarinë e riciklimit dhe ato të kompostimit.

Të gjitha synimet e komunës do të plotësohen në zbatim duke u bazuar në mundësinë që kjo komunë ka përmes përcaktimit të lokacionit të objektit të kompanisë publike “Higjiena”, lokacion ky i cili mundëson hapësirë për zhvillimin e të gjitha aktiviteteve të cilat ndërlidhen me menaxhim të integruar të mbeturinave. Kërkesa për pakësimin e mbeturinave nuk kufizohet vetëm me përmbushjen e objektivave kombëtare, por edhe si mënyra e vetme për të zvogëluar barrën financiare të shkaktuar nga kostot e transportit dhe deponimit. Për më tepër, sipas sistemit të përdorimit të deponive të përbashkëta rajonale, do të shtyjnë autoritetet lokale dhe qendrore të gjejnë zgjidhje të tjera për të minimizuar koston mjedisore prej deponimit të mbeturinave, duke nisur zbatimin e skemave të riciklimit dhe kompostimit.

Sfidat kryesore për fillimin e reformave të riciklimit dhe kompostimit lidhen me kostot shtesë që komuna fillimisht duhet të përballojë për të ngritur sistemin e ndarjes së mbeturinave në burim. Ndaj, në rastin e komunës së Deçanit është e rëndësishme që të analizohet dhe planifikohet buxhet për ndërtimin e hapësirës për qendër të ndarjes dhe trajtimit të mbeturinave, me c’rast do të facilitojë dhe do të bëjë të qëndrueshëm cdo proces të ndarjes në burim dhe trajtimit sekondar të mbeturinave. Njëherësh, kostoja e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave nëse synohet të zgjerohet skema e ndarjes në burim në nivel të gjerë territorial, duhet të planifikohet të rritet me 25-30% vetëm nga kalimi në sistemin e thjeshtë të mbledhjes së mbeturinave drejt sistemit me 2- 3 shporta duke llogaritur koston e investimit fillestar në infrastrukturë për grumbullim dhe kostot për infrastrukturën për përpunim të mbeturinave. Në këtë këndvështrim mund të shihet në të ardhmen mundësia për kërkim të fondeve prej donatorëve apo nivelit qendror si edhe mundësia e aplikimit të skemave sipas partneritetit publiko privat, ku sektori privat mund të marrë përsipër blerjen e kontenerëve apo pajisjeve tjera që shërbejnë për zhvillimin e aktivitetit të separimit dhe riciklimit të mbeturinave (vetëm fraksionin për mbeturinat e riciklueshme).

8.1 Riciklimi i mbeturinave

Forcimi i biznesit dhe industrisë së riciklimit në vend dhe në rajonin e Dukagjinit do të jetë faktor i rëndësishëm së bashku me akterët kryesorë për zhvillimin e skemave të riciklimit. Aktualisht, në komunë skema e grumbullimit të mbeturinave është klasike, ku mbeturinat mblidhen dhe transportohen të përziera pa ndjekur procesin e ndarjes në burim.

Për momentin, në qytetin e Deçanit mungojnë pilotimet apo praktikat e ndarjes në burim për riciklim si pasojë e implikimeve financiare apo mungesës së kapaciteteve për operim të nevojshme për këtë veprimtari. Gjithashtu, ngritja e vetëdijesimit do të kërkojë fonde të tjera për të mbështetur programet dhe nismat ndërgjegjësuese dhe edukative për të rritur njohuritë, cilësinë dhe sasinë e përfshirjes së komunitetit. Baraspesha midis përfitimeve (përfshirë përfitimet ekonomike të shitjes së materialeve të ricikluara apo kostot e kursyera të depozitimit) dhe kostos së drejtpërdrejtë për ndarjen dhe transportimin e mbeturinave do të jetë një faktor thelbësor në zhvillim të këtyre veprimtarive në një shkallë më të gjerë. Po ashtu, kjo do të lidhet edhe me burimet e disponueshme financiare për të subvencionuar këto veprimtari prej anës së institucionit komunal.

Megjithatë, një prej detyrave të Komunës është që të nxisë dhe krijojë një mjedis të qëndrueshëm për zhvillimin e sektorit të riciklimit, duke ngritur një skemë efektive dhe efikase për grumbullimin e diferencuar të mbeturinave të riciklueshme si plastikë, letër dhe karton, metal, qelq apo produkte të tjera të cilat kanë interes të lartë në tregun vendor ashtu dhe në rajon.

Politika e Komunës së Deçanit për të zhvilluar dhe përmirësuar menaxhimin e mbeturinave në komunë do të bazohet në krijimin e parakushteve në hapësirën komunale që komuna I ka dhënë në shfrytëzim kompanisë publike "Higjiena" duke ofruar mundësi në të ardhmen për të realizuar trajtimin e mbeturinave sipas fraksioneve. Funksionalizimi i një qendër për ndarje dhe separim të mbeturinave në qendër të ndarjes dhe në burim duhet të bëhet përmes përgatitjes së një plani konkret për organizimin e sistemit dhe përllogaritjen e kostove së ndërtimit dhe funksionalizimit të skemës. Komuna dhe institucionet përkatëse bazuar në planin e funksionalizimit të lokacionit ku do të zhvillojë këtë veprimtari duhet të planifikojnë mjetet e nevojshme për mbështetjen dhe zhvillimin e veprimtarisë së riciklimit në këtë lokacion.

Sipas këtij skenari, hapësira e cila do të ofrojë kushte për aktivitete të riciklimit do ti jepet në shfrytëzim kompanisë Publike "Higjiena" për ta menaxhuar atë duke zhvilluar të gjitha veprimtaritë e trajtimit të mbeturinave dhe prej ku shitja e mbeturinave të riciklueshme, plehut organik përmes kompostimit në të ardhmen apo veprimtari tjera që synojnë reduktimin e sasisë së mbeturinave për deponim dhe kthimin e tyre në vlerë të shitjes, do të realizohet përmes ankandit publik në marrëdhëni me sektorin privat. Sipas këtij skenari, ku kostoja e investimit do të jetë prej institucioneve qendrore, lokale apo donatorë dhe prej të cilës ndërmarrja publike e cila posedon apo krijon kapacitete të reja të stafit që do të merret me veprimtarinë e riciklimit, do të këtë mundësi më të mëdha për të ulur shpenzimet e deponimit, për të krijuar gjenerim përmes shitjes së mbeturinave të riciklueshme dhe ku monitorimi i sistemit tenton të jetë me i lehtë prej institucionit komunal.

Përkrahja dhe nxitja e biznesit të riciklimit për të mbështetur skemat lokale të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave në zonat urbane të komunës do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të këtij sektori dhe do të ulë koston financiare të komunës.

Pavarësisht mungesës së eksperiencës së autoriteteve lokale dhe operatorëve të mbeturinave si dhe vetë komunitetit për të ndarë mbeturinat, mund të thuhet se ekzistojnë mundësi të mëdha në Komunën e Deçanit për të zhvilluar dhe zbatuar skema të përshtatshme për ndarjen apo mbledhjen e diferencuar të mbeturinave urbane përfshirë këtu edhe mbetjet drusore si potencial i gjenerimit në këtë zonë me hapësira të mëdha pyjore. Për këtë qëllim skemat e mëposhtme janë analizuar në funksion të mundësive për

zbatimin e tyre në zonat urbane të Komunës së Deçanit dhe referuar kapacitetit të gjenerimit të mbeturinave sipas fraksioneve dhe potencialit të gjenrimit ndër vite.

Paraprakisht, vlen të theksohet që Komuna e Deçanit ka ndërmarrë hapa të kujdesshëm në mënyrë graduale për shtrirjen e shërbimit primar (mbulueshmëria në nivel të komplet territorit) indikator ky që shtyn përpara zhvillimet e komunës për përmirësimin e mëtutjeshëm të sektorit të menaxhimit të mbeturinave kundrejt menaxhimit të qëndrueshëm të tyre dhe krijimin e një sistemi efikas të shërbimeve.




Figura 9. Kapaciteti i ritjes së gjenerimit të mbeturinave sipas rrymave të përbërjes

Sipas rekomandimeve komuna ofron potencial për zhvillim të programeve të ndarjes në burim përmes ndarjes në dy fraksione (përdorimin e dy lloje të shportave për klasifikim të mbeturinave) në fraksionin për të riciklueshme dhe fraksioni për mbeturina të tjera.

Referuar llojeve të mbeturinave për klasifikim dhe mbledhjen e diferencuar të mbeturinave ; programet e ndarjes në burim do të përbëhen nga aplikimi I :

- Sistemi parësor i ndarjes: Njihet gjerësisht si ndarja në burim dhe jep rezultatin më të mirë të ndarjes. Ndarja në burim i referohet ndarjes së materialeve të riciklueshme dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre. Këtu do të përfshihet ndarja në burim tek prodhuesi ku shërbimi i grumbullimit të mbeturinave bëhet derë me derë duke konsideruar: ekonomitë familjare në zona me banim individual, biznese potenciale dhe institucione (shërbimi aktual ofrohet përmes shportave 120 dhe 240l).
- Sistemi dytësor i ndarjes, nënkupton ndarjen e mbeturinave në pikat të grumbullimit të tyre (shërbimi aktual ofrohet përmes kontenierëve 1.1m/kub).
- Funkcionalizimi I qendrës të ndarjes (drop off) në zonën urbane të qytetit
- Sistem I qëndrueshëm për menaxhim të mbetjeve të ngurta përmes funksionalizimit të deponisë së mbeturinave inerte.

8.2 Programet për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave

Sipas të objektivave të vendosura komuna udhëzohet të zhvillojë programe të qëndrueshme për ndarjen e mbeturinave në burim dhe nxitjen e riciklimit; të ndërgjegjësojë qytetarët për përfitimet nga procesi i riciklimit, dhe njëherazi të përmirësojë cilësinë e shërbimit e të krijojë një eksperiencë të suksesshme për ta përhapur atë në të gjithë territorin e komunës.

Krahas saj, komuna ka si qëllim që të gjejë një skemë të qëndrueshme për menaxhimin e ndarjes interesuar për produktet e riciklueshme dhe integrimin e mbledhësve joformalë që operojnë në këtë sektor. Komuna synon të planifikojë të gjitha proceset e nismave të ndarjes duke përfshirë NPL "Higjiena", që është nën përgjegjësinë e Komunës.

Për t'i realizuar këto objektivat, komuna duhet të planifikojë nisjen e një pilot projekti në shkallë të vogël ku do të përfshihen paraprakisht:

- Një analizë të qartë të gjendjes aktuale në zonën e projektit pilot dhe kuadrit ligjor në mbështetje të riciklimit,
- Identifikimin dhe përcaktimin e rolit të aktorëve të interesit të cilët përfshihen në këtë proces;
- Përcaktimin e rolit të kompanisë "Higjiena"
- Një koncept të qartë teknik dhe financiar që do të bëjë të mundur zbatimin e suksesshëm të Planit dhe qëndrueshmërinë e rezultateve,
- Një plan të detajuar për vetëdijësimin dhe edukimin e qytetarëve;
- Një plan i detajuar aktivitetesh për zbatimin e projektit pilot.
- Një sistem treguesish të cilët do të shërbejnë për monitorimin dhe matjen e rezultateve.

Paraprakisht komuna e Deçanit do të duhet të përcaktojë zonën e pilot projektit dhe të zhvillojë një analizë të situatës në zonën e përzgjedhur e cila do të përmbajë të dhëna lidhur me numrin e banorëve, numrin dhe llojin e institucioneve, formën e shërbimit aktual, llojin e fraksionit të mbeturinës që do të tentojë ta zvogëlojë prej rrymës së mbeturinave duke e klasifikuar për riciklim.

Lidhur me këtë komuna rekomandohet të vijojë me planifikimin e aktiviteteteve dhe kostove respektive sipas sistemeve që synon të aplikojë.

8.3 Planifikimi dhe integrimi i sistemeve për ndarje në burim

8.3.1 Ndarja në burim e mbeturinave të riciklueshme përmes sistemit parësor

Ky sistem do të nënkuptojë ndarjen në burim të materialeve të riciklueshme dhe të ripërdorshme në pikën e prodhimit të tyre.

Këtu do të përfshihet ndarja në burim tek prodhuesi ku shërbimi i grumbullimit të mbeturinave bëhet derë me derë duke konsideruar:

- ❖ Ekonomitë familjare në zona me banim individual, biznese potenciale dhe institucione (shërbimi aktual ofrohet përmes shportave 120 dhe 240l).

Shtrirja e këtij shërbimi në komplet zonën urbane të komunës së Deçanit do të mundësojë që brenda afateve kohore 5 vjecare të reduktojë rreth 27% të sasisë totale të mbeturinave të gjeneruara prej zonës qendër si zona parësore me potencial të gjenerimit të sasisë së mbeturinave të riciklueshme si rrjedhojë edhe të potencialit të numrit të bizneseve që bart në të.

Sipas përlllogaritjeve bazuar në objektivën e reduktimit të sasisë së mbeturinave që dërgohen në deponi, objektivë kjo që synon reduktim në 27% të sasisë totale të sasisë deri në 2025.



Figura 10. Shporta për fraksione të riciklueshme (letë-karton, plastikë dhe kanaqe)

Nëse në 2025 sasia totale e përlllogaritur vjetorë është rreth 11 633 atëhere prej qytetarëve pjesë e skemës së ndarjes së mbeturinave në burim: në përpjestim vjetor rreth 3 140 ton mbetje te riciklueshme në vit duhet të shkojnë në tregun për riciklim.

Kjo sasi e shprehur në sasi kg/dit që duhet të eliminohen prej dërgimit në deponi nënkupton që rreth 8600 kg mbeturina në ditë duhet të jenë të ndara për riciklim.

Numri i banorëve që duhet të jenë të përfshirë në skemën e ndarjes në burim dhe që duhet të kenë qasje, do të jetë rreth 19 000 banorë në komunën e Deçanit deri në vitin 2025 (përlllogaritur me koeficientin e gjenerimit 0.7 kg/mbeturina në ditë).

Sipas kësaj përlllogaritje komuna në përidhë 4 vjecare duhet të integrojë skemën e riciklimit përmes ndarjen në burim (për fraksionin të thata) për rreth 3800 amvisëri.

Nëse komuna do të zgjedhë sistemin paresor (përmes një konteneri për të riciklueshme), ajo duhet të kalkulojë koston e investimit të infrastrukturës për selektim të fraksionit të thata:

Tabela 155. Investimi në shporta-infrastrukturë

Furnizim infrastrukturë	2021	2022	2023	2024
Shporta per ndarje në burim (ngj e verdhë)	500	500	1400	1400
Lloji	240l	240l	240l	240l
Cmimi për njësi	28	28	28	28
TOTAL INVESTIM (EURO)	14 000	14 000	39 200	39 200

Investimi në infrastrukturë mundet të jetë rezultat i mundësive për bashkëfinancim të komunës apo kompanisë publike me donatorë të tjerë të jashtëm.

Propozohet që bashkarisht komuna duhet të marrë parasysh të krijojë kapacitete të brendshme si dhe të zhvillojë fushatave të vetdijesimit në komunitet. Njëerësh është e domosdoshmë të përgatisë plan të monitorimit të vazhdueshëm të sasisë dhe cilësisë së ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në burim. Sipas zërave të kostove propozohet që komuna të ndajë buxhet për vetdijesim në periudhë disa vjecare duke e harmonizuar me planin e zgjerimit të skemës së ndarjes në burim dhe nevojave të realizimit të planit.

8.3.2 Ndarja në burim e mbeturinave të riciklueshme përmes sistemit dytësor

Përdorimi i sistemit aktual të grumbullimit të mbeturinave urbane shërben si një bazë për të vënë në funksionim dhe prezantuar sistemin e mbledhjes së diferencuar të tyre. Kjo mënyrë mund të jetë praktike vetëm kur qytetarët dhe bizneset janë mësuar me këtë lloj sistemi dhe do të mund të përshtaten më mirë me ndryshimet. Paraprakisht planifikimi i pilotimeve të ngjajshmë duhet të përcillet me kapacitete operative për grumbullim të vecantë të dedikuar vetëm për mbeturina të riciklueshme me frekuencë cdo ditë apo në ditë të alternuara si edhe me fushatë vetdijesimi të vazhdueshme, monitorim si edhe stimulim qytetar. Kjo metodë është e preferueshme kryesisht në qytete të mëdha ku është i pamundur krijimi i sistemeve individuale për ndarjen e mbeturinave, por modeli i operimit për grumbullim dhe planifikimi i destinacionit final për trajtim do të jetë mjet kyç për një sistem të qëndrueshëm. Sistemi i grumbullimit të ndarë të mbeturinave për riciklim sipas skemës për system të përbashkët, në zonën me banim kolektiv në qytetin e Deçanit do të përfshijë:

- Përlllogaritjen e infrastrukturës së nevojshme për rrjetin e kontenierëve shtesë që duhet të parashihet të shpërndahen nëpër Pikat aktuale të grumbullimit të cilat plotësojnë kriteret dhe kapacitetet për zbrastje për qytetarë në zonën qendër dhe shërbehen aktualisht me operim 1-2 herë në ditë, do të marrin parasysh:

Numri i pikave të grumbullimit:

Rrjeti i pikave të grumbullimit të përbashkëta në zonën pilot do të përbëhet sipas përlllogaritjes së numrit të PGM, që sigurojnë një mbulim total dhe të njëtrajtshëm për mbledhjen e mbeturinave të ndara në dy rryma:

- Mbeturina të njoma dhe të tjera;
- Mbeturina të thata të riciklueshme (kryesisht plastikë, letër/karton, metale dhe xham)

Planifikimi i lokacioneve:

Pikat e grumbullimit do të jenë më të dendura në zonën me aktivitet tregtar (ku janë vendosur bizneset);

- Vendosja e pikave të grumbullimit;
- Vlerësohet se për një mbulim sa më të mirë, vecanërisht për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të riciklueshme, është e nevojshme që të bëhen disa lëvizje, heqje dhe shtesa të pikave ekzistuese sipas nevojave gjatë periudhave kalimtare.

- Numri i kontenierëve dhe kompozimi për cdo pikë grumbullimi:

Lloji i kontenierëve:

Kombinacioni i pikave të grumbullimit që do të përbëhen nga:

- Kontenierë për Mbeturinat e pariciklueshme – të njoma (kontenier 1.1 mkub metalik apo plastic me ngjyrë të gjelbër apo të hirtë);
- Kontenierë për Mbeturinat e riciklueshme – të thata – letër/karton, plastikë,metale, xham (me ngjyrë të verdhë ose mbulesë/kapak me ngjyrë të verdhë);
- Kontenierë rrjetë për njësitë tregtare me gjenerim të madh (kontenierët rrjetë për grumbullimin e letrës/kartonit dhe plastikën).
- Pikat e grumbullimit për institucionet do të jenë të vecanta dhe në përputhje me numrin e tyre në zonë;

Numri i kontenierëve

Numri i kontenierëve të përbashët për Mbeturinat e pariciklueshme (të njoma) do të llogaritet mbi bazën e kriterëve:

- Dendësia e mbetjeve në kontenier për mbushjen 70 % plot e llogaritur sa 165 kg/m³;
- Mbushja 70% plot;
- Frekuenca e grumbullimit 1 herë në ditë.
- Numri i kontenierëve të përbashkët për mbeturinat e riciklueshme (të thata) do të llogaritet mbi bazën e kriterëve:
- Dendësia mbetjeve në kontenier për mbushjen 50 % plot e llogaritur sa 75 kg/m³,
- Mbushja 50% plot;
- Frekuenca e grumbullimit 1 herë në ditë

Përvojat e pilotuara në nivel rajonal rekomandojnë fillimisht aplikimin e sistemit me ty kontenierë (shporta) për grumbullimin e mbeturinave urbane. Kjo do të përfshijë krijimin e një opsioni me dy kode ngjyrash për konsumatorët për depozitimin e ndarë të mbeturinave sipas llojit në të riciklueshme dhe në të tjera.

Si alternativë e dytë propozohet vendosja e rrjetave metalike pranë pikave grumbulluese me qëllim nxitjen e riciklimit përmes imazhit vizuel dhe ngritjen e vetëdijes publike. Aktualisht sipas planit të vendlokacioneve të pikave të grumbullimit rekomandohet të vendosen nga një kontenier për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme (plastikë/Alumin). Opsionë të cilat janë përdorur paraprakisht dhe kanë rezultuar efikase për sa i përket nisjes së ngritjes së vetëdijes qytetare munden të gjejnë zbatim me përdorimin e rrjetave metalikë, të vendosura pranë PGM në zonat me banim kolektiv në qytet si edhe të përdorura prej bizneseve dhe institucioneve për grumbullim të ndarë të mbeturinave të riciklueshem kryesisht nëpër PGM plastikë/alumin dhe nëpër bisnese të integrohet edhe ndarja në burim e letrës/kartonit apo qelqit.

Sipas shpërndarjes së PGM në zonën urbane të qytetit komuna e Deçanit duhet të tentojë të nisë pilotimin në zonën qendër dhe nëpër banesat kolektive që kanë të inkuadruara PGM pranë hapësirave të brendshme dhe me pas të bëjë shtrirjen në zona të tjera.

Për realizimin e këtij intervenimi propozohet që në 2 lokacione në qytet dhe pranë institucioneve edukative dhe institucione tjera, të bëhet pozicionimi i Rrjetave metalike ose kontenierë të verdhë të posaçëm për ndarje në burim, të cilat duhet të jenë të pajisura edhe me instruksionet si do të bëhet klasifikimi i mbeturinave në to. Njëhërësh ky zbatim duhet të shoqërohet më aktivitete të vetëdijesimi dhe takime të vazhdueshme me komunitet me qëllim krijimin e një bashkëpunimi të ngurshtë me qytetarët e zonave të

pilotimit. Ky pilotim i parë parashihet që të bëhet gjatë vitit të parë dhe të shtrihet në vazhdim në komplet zonat më banim kolektiv dhe banim individual në pjesën urbane të qytetit

Zonat e synuara për të nisur një pilot projekt të ndarjes në burim në vitin 2021 rekomandohen do të jenë:

1. Zona qendër me banim kolektiv që shërbehet përmes pikave të grumbullimit, ku pranë lokacioneve të PGM rekomandohet të vendoset kontenier I vecantë vetëm për mbeturina të riciklueshme me ngjyrë të ndryshme prej kontenierëve ekzistues 1.1 m/kub; praktikë e mirë rezulton edhe vendosja e një rrjete metalike destinuar për grumbullim të vecantë të mbetjeve të riciklueshme. Rekomandohet që sistemi fillimisht të nisë në 2 PGM

2. Lagje në zonën qendër në të cilën shërbimi realizohet në sistem derë më derë. Rekomandohet të përzgjidhet një lagje me shtëpi individuale ku si fillim gjatë pilotimit 200 amvisëri të jenë pjesë e programit për ndarje në burim të mbeturinave të riciklueshme

3. Bizneset në zonën qendër të bëjnë klasifikimin e mbeturinave përmes pozicionimit të rrjetave metalike për bisnese apo përmes sistemit me qese më ngjyrë të vecantë dhe grumbullim të mbeturinave të riciklueshme sipas orareve dhe ditëve të caktuara. Rekomandohet që të analizohet prej anës së komunës dhe kompanisë lloji i mbeturinave që gjenerohen më së shumti prej bizneseve në zonën qendër.

4. Institucionet në tërësi në zonën e urbane së Komunës së Deçanit në një fazë të parë; duke planifikuar vendosjen e të gjitha institucioneve në programin e ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në burim. Infrastruktura përcjellëse për ndarje në burim nëpër institucione edukative apo dhe institucione tjera rekomandohet të jetë në formë të rrjetave metalikë më forma atraktive për fëmijë, me qëllim që ti nxisë në praktikimin e skemës për ndarje në burim.




Figura 11. Zona qendër

Tabela 166. Lista e institucioneve

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
1	SHFMU "Sylejmon Vokshi"	Prilep				
2	SHFMU "Bajram Curri"	Strellc i Epërm				
3	SHFMU "Esad Mekuli"	Maznik				
4	SHFMU "Dëshmorët e Kombit"	Strell i Ulët				
5	SHFMU "Ardhmëria"	Beleg				
6	SHFMU "Sylë Alaj"	Drenoc				
7	SHFMU "Heronjtë e Dukagjinit"	Glllogjan				
8	SHFMU "Lan Selimi"	Lumbardh				
9	SHFMU "Avni Rrustemi"	Irnziq				
10	SHFMU "Dëshmorët e Baballoqit"	Baballoq				
11	SHFMU "Drita"	Gramaqel				
12	SHFMU "Faik Konica"	Ratsih				
13	SHFMU "Dëshmorët e Vokshit"	Pobërgjë				
14	SHFMU "Jusuf Gërvall"	Prapaqan				
15	SHFMU "Kuvendi i Verrave të Llukës"	Lluke e Epërme				
16	SHFMU "Isa Bolitini"	Isniq				
17	SHFMU "Rexhep Kadrija"	Rastovic				
18	SHFMU "Lidhja e Prizrenit"	Deçan				
19	SHMT "Tafil Kasumaj"	Deçan				
20	Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"	Deçan				
21	Paralele e SHFMU "Sylë Alaj"	Vokshë				
22	Paralele e SHFMU "Lan Selimi"	Llukë e ulët				
23	Paralele e SHFMU "Jusuf Gërvalla"	Dubovikë				
24	Paralele e SHFMU "Isa Boletini"	Lëbushë				
25	Qerdhja e femijëve "Fatosat" (private)	Deçan				

Kostoja e paraparë për nisjen e pilot projektit për ndarje në burim në vitin 2021 duke përfshirë institucionet dhe lokacionet e përbashkëta për grumbullim të mbeturinave (5 lokacione) do të mund të përlogaritet:

Tabela 177. Pilotimi për Ndarje në burim të fraksionit të riciklueshëm përmes sistemit me rrjeta metalike (2021-2022)

Furnizim infrastrukturë	Sasia	Cmimi njësi	TOTAL
Kontenierë për riciklim/Shporta rrjeta metalike 3 m/kub shkolla	25	300	7500
Kontenierë për riciklim/Shporta rrjeta metalike 3 m/kub për qytet PGM	5	300	1500
Pllakatë informuese	5	100	500
Material informativ (broshura)	10000	0.16	1600
TOTAL INVESTIM INFRASTRUKTURE			11,100

Vendosja e objektivave për ndarje në burim të fraksionit të mbeturinave komunale në periudhë afatmesme:
Nevoja me infrastrukturë bazike për ndarje në burim të fraksionit të Riciklueshme (2021-2022):

Tabela 188. Infrastruktura bazike për ndarje në burim të fraksionit të Riciklueshme (2021-2022)

Furnizim infrastrukturë	Sasia Kontenierë për ndarje amviseri/sistem paresor	Sasia Kontenierë për riciklim/Shporta rrjeta metalike 3 m/kub shkolla dhe qytet	Pllakatë informuese	Material informativ (broshura)	KOSTO
2021	500	10	10	3000	18 480
2022	500	20	20	7000	23120
Total infrastrukturë	1000	30	30	1000	
Kosto njësi	28	300	100	0.16	

Referuar kostove të investimit për infrastrukturë bazike për implementimin e një programi për ndarje në burim të mbeturinave të riciklueshme për dy vitet e para të planifikimit , kjo do ti kushtojë komunë së Deçanit rreth 41 600 euro pa përllogaritur kostot direkte për ngritjen dhe funksionalizimin e një sistemi të grumbullimit të veçantë të mbeturinave komunale dhe aktivitetet përcjellëse për sortimin, presimin dhe riciklimin e mbeturinave të thata të riciklueshme duke përfshirë mbetjet nga plastika,metali, letra/kartoni..

Varesisht potencialit të tregut në Kosovë komuna duhet të përcaktojë rrymën e mbeturinave do të synojë të ndajë prej rrymës së përgjithshme të mbeturinave që shkojnë në deponi.

Gjithashtu do të rekomandohet komuna që të funksionalizojë edhe qendrën e ndarjes në lokacion të caktuar ku qytetarët të kenë mundësi të dërgojnë vetë materiale tjera të riciklueshme që nuk e grumbullon përmes infrastrukturës për ndarje në burim.

Në zërat e kostove më poshtë vlerësohet kostoja e investimit ndër vite për zhvillimin e programit të ndarjes në burim të mbeturinave të riciklueshme të fraksionit të thatë në komunën e Deçanit.

Tabela 199. Zgjerimi I skemës së ndarjes në burim në tërësi territoriale në afate të caktuara (2021-2025)

Furnizim infrastrukturë	2021	2022	2023	2024
SYNIMI I KOMUNES %				
Kosto per infrastrukture	17 000	20 000	39 200	39 200
Kosto përcjellese (broshure, pllakata)	1480	3121	1000	1000
Kosto vetedijesimi (video, ligjerata, monitorim, postera etj)	4000	4000	4000	4000
TOTAL INVESTIM	22 480	27 121	44 200	44 200
TOTAL				138.001 EURO

Siç vlerësohet në tabelë, programi I ndarjes në burim implementuar në rreth 42% të popullsisë së komunës do ti kushtojë komunës rreth 138 001 Euro në një perishë 4 vjeçare të investimit duke përllogaritur edhe kosto shtesë të vetëdijesimit dhe informimit për ngritje të sistemi. Kjo kosto synon të ndahet sipas viteve respektivisht objektivave të përcaktuara.

8.4 Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave organike - kompostimi i mbeturinave

Një argument i rëndësishëm në favor të kompostimit është fakti se një pjesë e madhe e familjeve në komunë jetojnë në zona rurale, ku ekzistojnë mundësi reale për zhvillimin e kompostimit familjar, ku një pjesë e familjeve që merren me aktivitet bujqësor mund të përdorin kompostin si ushqim për kafshë apo si pleh organik. Nisur nga fakti që xxx% e familjeve në territorin e Komunës jetojnë në zona rurale dhe sasia e mbeturinave organike përbën rreth xxxxxx% të sasisë së mbeturinave që gjeneron komuna. Në këtë situatë kompostimi përfaqëson një alternativë të rëndësishme trajtimi për të shmangur Mbeturinat nga deponimi final.

Kompostimi në nivel individual (sistem i decentralizuar në cdo shtëpi) paraqet një nga metodat më të parapëlqyera të kompostimit që rekomandohet për t'u përdorur në familjet në zonat urbane dhe rurale. Kjo metodë është më pak e kushtueshme dhe më e efektshme duke u bazuar në kapacitetin e gjenerimit të mbeturinave organike sipas fraksionit megjithatë kërkon angazhim dhe vetëdije të lartë qytetare. Ky proces është mjaft i rëndësishëm nga ana mjedisore, pasi ul ndjeshëm sasinë e mbeturinave që hedhin familjet për trajtim final, duke ulur në këtë mënyrë edhe koston transportit dhe të trajtimit final të mbeturinave. Në rastin e mbeturinave drusore, të cilat në zonat rurale janë të shumta, komuna mund të

ofrojë shërbimin e copëtimit (grirjes) për familjet që ndërmarrin një nismë të tillë, duke copëtuar Mbeturinat drusore, disa herë në vit apo të nisë grumbullimin e organizuar të këtij fraksioni të rrymës së mbeturinave.

Metoda të tjera të kompostimit, që praktikohen në vendet e tjera të zhvilluara janë:

- Kompostimi i mbeturinave në mjedis të hapur, kompostimi në nivel komuniteti
- Kompostimi me çlirim pasiv gazi
- Kompostimi me sistem kapës të gazit
- Kompostimi i mbyllur
- Kompostimi në konteinerë.

Për rastin e Komunës e Deçanit, përveç kompostimit në nivel individual, një ndër metodat për të përshtatshme për kushtet dhe koston relativisht të ulët që ka, mund të jetë nisja e skemës së centralizuar të grumbullimit të mbeturinave organike dhe ato që derivojnë prej hapësirave të gjelbërta me c'rast mund të reduktojë sasi të mëdha të mbeturinave që dërgohen në deponi apo edhe të krijojë përfitime përmes trajtimit të këtyre mbetjeve.

Kompostimi në mjedis të hapur. Kjo lloj metode nuk ka një kosto të lartë për investimin fillestar dhe mund të japë rezultate mjaft të favorshme, jo vetëm për uljen e sasisë së mbeturinave që shkojnë për trajtimin final, por edhe në prodhimin e nje sasive të konsiderueshme komposti si pleh organik, që mund të përdoret nga komuna për qëllime publike. Komuna mund të inkurajojë procesin e kompostimit, duke ofruar mbështetje financiare (grante, skema bashkëfinancimi); duke miratuar politika fiskale të favorshme për kompostimin e mbeturinave; duke kategorizuar sistemin aktual të tarifave dhe duke vendosur sanksione të veçanta në rast të mos zbatimit të tyre.

Në kushte aktuale, ku zbatimi i skenarëve për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave organike ka kosto të lartë, Komuna e Deçanit, mund të fillojë të testojë procesin e kompostimit të mbeturinave organike, duke e prezantuar si një projekt pilot në një nga lagjet e komunës që ka më shumë potencial dhe ka interes. Ajo mund të zgjedhë të fillojë kompostimin në komunitet në mjedis të hapur për të parë mundësinë e zgjerimit të skemës edhe në zona të tjera. Sugjerohet që të nisë zbatimin e kësaj skeme në një zonë të mirëorganizuar më shtëpi privatë duke synuar shtrirjen në zona tjera sipas planeve që komuna do të zbatojë në të ardhmen.



Figura 12. Skema praktike të kompostimit në mjedis të hapur për Mbeturinat organike, skemë kompostimi në shtëpi

Komuna mund të realizojë aplikimin e skemave të kompostimit sipas skenareve të ndryshëm duke përfshirë:

Kompostim në system të decentralizuar: qytetari praktikon kompostimin në hapësirat e tij.

Në këtë rast politikat e komunës duhet të parashohin mbështetjen për qytetarë me pajisje kompostuese sipas llojeve të ndryshme dhe ku njëherësh duhet të ngrihet një grup punues brënda sektorit për të zbatuar politikat për vetëdijesim dhe monitorim të sistemit.

Sipas planeve të komunës, në tabelën më poshtë përshkruhen kostot e ngritjes së një sistemi të kompostimit shtëpiak sipas planeve aftamesme dhe afatgjata në komunë respektivisht duke u bazuar në objektivat e vendosura në planin për menaxhim të integruar të mbeturinave:

Tabela 30. Kostot e ngritjes së një sistemi të kompostimit shtëpiak

Furnizim infrastrukturë	2023	2024	2025	Total kosto
Nr amvisërive ne projekt	500	680	291	1471
INFRASTRUKTURE				
Enë kompostuese	500	680	291	1471
Cmimi për njësi ene	50	50	50	
Kosto infrastrukturë	25 000	34 000	14 550	73 550
Material informativ (broshura,postera)eu	500	500	500	1500
TOTAL INVESTIM	25 500	34 500	15 050	75 050

Sipas planeve të komunës parashihen që në fazën e parë (2023) të testohet praktika e kompostimit shtëpiak në 500 amvisëri në lagje në zonën qendër të qytetit me tipologji të banimit individual dhe me profil lagje të mireorganizuara dhe që kanë kapacitet të prodhimit të mbeturinave organike dhe ato të oborreve, për të tentuar në fazën e radhës zgjerimin e pilotimit të kompostimit shtëpiak në 680 amvisëri tjera për vitin 2024.Në formë graduale propozohet që zgjerohet kjo skemë në zona rurale duke aplikuar metoda të kompostimit shtëpiak apo në formë të centralizuar të kompostimit në komunitet.Këto pilotime propozohet të implementohen përmes zbatimit të kampanjave të vetëdijesimit në komunitet dhe monitorimit të vazhdueshëm të sasisë së reduktuar të mbeturinave gjatë implementimit,me qëllim matjen e efikasitetit të projektit. Kostoja që komuna udhëzohet të planifikojë për periudhën 4 vjeçarë në implementimin e planit për reduktimin e sasisë së mbeturinave organike përmes kompostimit shtëpiak në 1471 amvisëri shtesë në qytet apo në zona rurale (pajisje me kapacitet më të lartë komposti), përllogaritet të jetë rreth 75 050 euro. Ndërkohë që investimi në nivel territorial në komunën e Deçanit në aplikimin e kësaj skeme përllogaritet në kosto rreth 294 350 euro, pa përfshirë kostot për vetëdijesim dhe monitorim.

Kompostim në sistem të Centralizuar:

Sipas këtij opsioni komuna e Deçanit do të parashohë të integrojë në planin e saj ndarjen në burim të fraksionit të mbeturinave organike. Në këtë rast komuna duhet të posedojë hapësirë ku do të depozitojë

dhe trajtojë mbeturinën organikë të grumbulluar prej amvisërive dhe prej aktivitetit të pastrimit të hapësirave të gjelbra në territorin komunal. Duke marrë në konsideratë topologjinë e komunës së Deçanit si një komunë më hapësira të mëdha pyjore dhe shpërndarje të popullsisë kryesisht në zona rurale dhe me bujqësi të zhvilluar, skema e centralizuar e grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave organike qëndron si një opsion i qëndrueshëm në menaxhim të kësaj rryme të mbetjeve. Në skemat e kompostimit në shtëpi në të dyja format është thelbësore që pronari i shtëpisë të kuptojë funksionimin e kompozuesit dhe cilat materiale mund të ndajë për kompostim.

Duke u bazuar në teknologjinë e përdorur në qendrën e kompostimit, Produkti final që mund të përfitohet prej aktivitetit të grumbullimit të diferencuar të fraksionit organik dhe mbetjeve pyjore do të konsistonte në pleh organik fertilizues i cili përdoret në bujqësi dhe mund të ofrohet pa pagesë për qytetarët e komunës (referuar politikave që përcakton komuna) apo të shitet në treg. Shitja e produktit përfundimtar mund të sigurojë të ardhura për të ndihmuar në financimin e skemës. Për më tepër, përdorimi i produktit përfundimtar është thelbësor për të realizuar përfitimin e plotë mjedisor nga kompostimi, dhe kështu që është e rëndësishme të sigurohet që kjo të arrihet.

Duke marrë parasysh skemat e komunitetit dhe ato të centralizuara, një sistem i organizuar i mbledhjes së ndarë duket se është më shumë efektive bazuar në mbledhjen e lëndës së parë organike të pastër ku përzjerja me lëndë drusore rezulton në një produkt përfundimtar me cilësi më të lartë. Në aplikim e kësaj skeme, Komuna me përkrahje edhe të donatorëve tjerë duhet të ndërmarrë politika që ti pajisë ekonomitë familjare me kontejnerë për mbeturina organike ose qesë me materie ekologjike të biodegradueshme për mbledhjen e mbeturinave të kompostueshme falas. Operimi dhe grumbullimi i mbeturinave organike mund të ndryshojë nga një deri në dy herë në javë. Plani i operimit të kompanisë duhet të përshtatet sipas ndryshimeve në programet që Komuna do të nisë në territorin e saj, duke marrë në konsideratë potencialin e gjenerimit sipas rrymave të mbeturinave që do të trajtohen dhe karakteristikat e rrymave (në këtë rast fraksioni organik në temperatura të larta dekompozohen dhe shkaktojnë erë dhe shqetësime mjedisore nëse nuk instalohet frekuencë e duhur e grumbullimit).

Përderisa kostot kapitale dhe operacionale që lidhen me ngritjen dhe funksionimin e një skeme kompostimi në formë të centralizuar nuk mund të shmangen, mundësitë për të minimizuar kostot duhet të zbatohen prej grumbulluesit. Për shembull, shumë skema të kompostimit ndajnë automjetet e grumbullimit pa i adaptuar ato (dhe gjithashtu kostot përkatëse) me skemat për të mbledhur mbeturinat e tjera të amvisërive.

Referuar politikave të komunës për aplikimin e kësaj skeme duhet të përcaktohen paraprakisht: faktorët kryesorë të suksesit për kompostimin e mbledhjes së veçantë:

- Vendorsjen e objektivave të qarta, të arritshme për skemën;
- Përcaktim i llojeve të mbetjeve që institucioni komunal synon ti largojë prej rrymës së mbeturinave;
- Sigurimi i infrastrukturës për zhvillimin e skemës së ndarjes në burim të mbeturinave organike në mënyrë që të jetë efektive dhe gjithashtu e përshtatshme për familjet;
- Sigurimi i tregut për produktin përfundimtar;
- Menaxhim dhe planifikim i qëndrueshëm financiar;
- Organizimi i një fushate të gjerë publiciteti dhe informimi për skemën.

Në këtë rast komuna do të marrë në konsideratë kostot paraqitura dhe do të synojë të gjejë mbështetje prej nivelit qendror apo donatorëve të huaj.

Ky system për reduktimin e mbetjeve organike në burim do të ngrihet në dy faza sipas:

Funksionalizimi i qendrës dhe sistemit për grumbullim të diferencuar të mbeturinave organike rekomandohet të bëhet në faza:

- Duke marrë në konsideratë që komuna I ka ofruar në dispozicion kompanisë publike Higjiena një hapësirë mbi 2 ha toke në shfrytëzim për nëvoja operative

Faza e parë (2023 – 2024) do të përfshijë:

- Ndërtimin dhe pajisjen e qendrës të kompostimit
- Plotësimin me infrastrukturë për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave
- Plotësimin me infrastrukturë për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra në komunën e Deçanit
- Shtrirjen e shërbimit të diferencimit të mbeturinave organike në zonë rurale

Faza e dytë (2024-e tutje) do të përfshijë

- Shtrirjen e shërbimit në nivel territorial

Në terma të përgjithshëm, kjo objektivë për zhvillimin e aktivitetit të kompostimit do të kushtojë:

Tabela 201. Kosto për zhvillimin e aktivitetit për kompostim

Faza e I-te (2023 – 2024)		Shuma Euro
QENDRA PËR KOMPOSTIM	Punime ndërtimi	300,000*
	Pajisje të lëvizshme	200.000*
	Pajisje me shporta	32 362
	Shuma Faza e I-te	532 362
Faza e II-te (2024 – 2025)	Pajisje me shporta për mbeturina organike	97 152
	Shuma Faza e II-te	97 152

Kosto infrastrukture shporta për mbetje organike:

Furnizim infrastrukturë	2023	2024	2025	KOMPLET TERRITORI
-------------------------	------	------	------	-------------------

Shporta 120l per mbetje organike(ngjyre kafe me ajrosje)	500	680	291	5887
Nr amvisërive	500	680	291	5887
Cmimi për njësi	22	22	22	22
TOTAL INVESTIM NË SHPORTA	11 000	14 960	6402	129 514

Aplikimi i kësaj skëme në 1000 familje brenda vitit 2024 planifikon të reduktojë minimalisht rreth 54 ton në vit mbeturinë organike që shkon në deponi si dhe të krijojë mundësi të përfitimit të plehut organik për nevoja të ekonomive familjare që e aplikojnë metodën e kompostimit shtëpiak. Preferohet që gjatë pilotimeve të aplikohet e ndarjes në burim të rrymës së fraksionit organik në zonat kryesisht rurale që kanë potencial gjenerimi të fraksionit organik si pasojë e veprimtarisë së punës në bujqësi. Monitorimi dhe raportimi i saktë i sasisë së mbeturinave të reduktuara do të jetë indikator ,i cili do të pajisë komunën me informata për zgjerimin e mëtutjeshëm të aplikimit të kësaj skeme të minimizimit të mbeturinave në burim.

8.5 Menaxhimi i mbeturinave voluminoze dhe ndërtimore

Sipas kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e këtij fraksioni të mbetjeve është përgjegjësia e prodhuesit (familje, biznes apo industri) që të largojë dhe transportojë mbeturinave inerte, ndërtimore apo voluminoze që mund të gjenerojë nga aktiviteti që kryen, për ti hedhur ato në vendet e përcaktuara nga pushteti lokal për këtë qëllim. Ndonëse ekziston ky kuadër ligjor, i cili përcakton mjaft mirë detyrat për secilin aktor të përfshirë, megjithatë mungojnë ose janë të pakta komunat në nivel vendi që kanë nisur një sistem të mirëfilltë të funksionalizimit të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave të vëllimshme si dhe ato inerte.

Në kuadrin ligjor theksohet se këto vende të përcaktuara për depozitimin e mbeturinave inerte/ndërtimore/voluminoze duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të posacme dhe duhet të pranojnë vetëm këto lloj mbeturine, dhe jo përzjerje apo përpunime të këtyre mbeturinave me elementë të tjerë, pasi ato mund të jenë të rrezikshme.

Të gjitha venddepozitimet e mbeturinave inerte kanë të njëjtën mënyrë operimi si deponitë/landfillet për Mbeturinat urbane, ku gjeneruesi i mbeturinave duhet të paguajë një tarifë kundrejt sasisë së mbeturinave inerte që transporton, e cila mbulon koston e operimit të fushës, trajtimit të tyre dhe mbylljen përfundimtare të saj. Në raste tjera ku komuna merr përsipër kostot e deponimit të mbetjeve inerte apo të vëllimshme, institucioni komunal duhet të parashohë koston për trajtimin e tyre. Përzgjedhja e lokacionit për ndërtimin e mbeturinave inerte duhet të respektojë rregullat e vendosura prej institucioneve qendrore, sipas të cilave ndalohet ndërtimi i venddepozitimeve të përkohshme të mbeturinave inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:

- Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujqor;
- Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum;
- Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me pikën e parë.

Deponitë e mbeturinave inerte mund të jenë deponi lokale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbeturinave të prodhuara brënda territorit të një komune ose deponi rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbeturinave të shumë komunave (Ligji për Mbeturina). Njësitë e qeverisjes lokale mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit, ku do të mund të ndërtohet deponia rajonale dhe të mënyrës së funksionimit të tij. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbeturinave në deponinë e inerteve dhe venddepozitimet e përkohshme të mbeturinave inerte (hapësira që komuna përcakton si venddepozitim të përkohshëm dhe lejon grumbullimin e mbeturinave inerte), janë të detyruar të raportojnë pranë drejtorisë në Komunë dhe Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë për të dhënat e mbeturinave që trajtojnë.

Bazuar në raportin mbi deponitë ilegale sipas përbërjes së mbeturinave që gjinden nëpër deponi ilegale, shërbejnë si indikator për zgjidhje të problemit të këtij fraksioni të mbetjeve në Komunë.

Komuna e Deçanit e ka të paracaktuar një lokacion për depozitimin e mbeturinave inerte, i cili është në proçes të funksionalizimit me infrastrukturë bazike sikurse njëherësh duhet të kompletohet me dokumentacionin përkatës ligjor për kriteret për leje mjedisore brënda vitit 2021.

Komuna e Deçanit rekomandohet që të përcaktojë kushtet për operimin dhe funksionalizimin e lokacionit për mbeturinat ndërtimore dhe mbeturinave voluminoze duke stimuluar ripërdorimin apo riciklimin e tyre. Komuna do të jetë përgjegjëse për caktimin e formës së menaxhimit të këtij lokacioni dhe trajtimit në të. Më pas do të jetë përgjegjësi e prodhuesve të mbeturinave që të obligohen që Mbeturinat inerte apo të vëllimshme ti dërgojnë në lokacionin e paracaktuar, ku komuna ka të drejtë të zhvillojë politikat e mëtutjeshme lidhur me pagesën që do të bartet tek operatori dhe formën e menaxhimit të deponisë inerte që do të ndërtojë.

Paraprakisht duhet të merren në konsideratë aktivitetet përcjellëse me implikime buxhetore që do të përkojnë me funksionalizimin e qendrës së ndarjes për mbeturina inerte dhe ato të vëllimshme. Këtu do të përfshihen:

- Specifikimet teknike për funksionalizimin e deponisë për mbeturinat inerte
- Specifikimet teknike për ndërtimin e qendrës së ndarjes për mbeturinat e vëllimshme
- Furnizimin me pajisjet përkatëse për operim Brenda deponisë dhe qendrës së grumbullimit të mbeturinave

Lidhur me menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme rekomandohet të zhvillohet një sistem i mirëfillt ku përveç se qytetari mund të dërgojë vetë këtë kategori të mbeturinave në lokacionin e saktuar nga komuna, gjithashtu shërbimi për transportimin e tyre nga gjeneruesi duhet të kryhet nga kompania publike sipas kontratave të vecanta dhe i dërgon në qendër të ndarjes për trajtimin e tyre. Në këtë drejtim komuna dhe kompania duhet të përcaktojnë tarifën për kryerjen e këtij shërbimi duke e rishikuar dhe në rregulloren komunale për menaxhim të mbeturinave.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare për grumbullimin e vecantë të mbeturinave të vëllimshme në formë sistematike udhëzohet komuna që të implementojë aksione pranverorë/vjeshtore (2 herë në vit) për grumbullimin e kësaj kategorie të mbeturinave pa pagesë prej anës së kompanisë publike.

9 ZHVILLIMI I PLANIT PËR MENAXHIM TË INTERGUAR TË MBETURINAVE

9.1 Alternativa e përkohshme për reduktimin e mbeturinave komunale

Komuna ndërton/ shfrytëzon objekt për dërgimin dhe selektimin e mbeturinave të riciklueshme:

1. Kontraktimi i procesit tek operatorët privatë si pjesë e shërbimit të grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve.

Në kuadër të këtij opsioni, komuna e Deçanit, në këtë rast kompania "Higjiena" në rast se nuk posedon hapësirë/object ku mund të zhvillojë aktivitetin e selektimit dhe përpunimit të mbeturinave të riciklueshme që do të mblidhen nëpërmjet sistemit të grumbullimit të diferencuar, do të parashohë të sigurojë kontratë me operatorë private. Komuna do të mbulojë kostot e grumbullimit dhe transportit për grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme, përderisa kostot e selektimit dhe përpunimit do të sigurohen nga operatori dhe do të mbulohen nga të ardhurat prej shitje së materialit të riciklueshëm.

2. Funksionalizimi i një qendre për Selektimin e Mbetjeve të Riciklueshme në Deçan. Në rast se komuna posedon hapësirë ku mund të nisë procesi i selektimit dhe përpunimit të mbeturinave të riciklueshme, atëherë ky opsion do të kërkojë investime nga buxheti i komunës ose me mbështetjen e ndonjë donator të mundshëm për të funksionalizuar dhe ngritur një qendër për selektim të mbetjeve të riciklueshme. Në këtë rast duhet të planifikohen kostot për pajisjet bazë për presim dhe paketim të mbeturinave të riciklueshme, instalimet e nevojshme në objekt, kostot e administrimit të kësaj qendre dhe kostot e grumbullimit dhe transportit të diferencuar të mbeturinave të riciklueshme (fraksioni të thata). Edhe në këtë opsion, munden të bëhen marrëveshje kontraktuale me operatorë privat të interesuar.




Figura 13. Lokacioni I propozuar për Qendrën për selektim dhe riciklim (Deçan)

Qendra Selektimit do të shërbejë për depozitimin e përkohshëm të kësaj kategorie të mbeturinave, ndarjen e tyre në rryma të veçanta, paketimin dhe përgatitjen për tregun e industrisë së riciklimit. Shpenzimet e selektimit dhe përpunimit do të mbulohen nga të ardhurat prej shitjes së materialit të riciklueshëm.

Produkti i kësaj qendre do të jenë materialet e riciklueshme të ndara sipas kërkesave të tregut dhe që përbehen kryesisht në:

1. Letër – karton;
2. Plastike me densitet të lartë;
3. Plastikë me densitet të vogël
4. Metale, kryesisht alumin (kanaçe pijesh freskuese etj.),
5. Qelq (pasi të jetë gjetur tregu i shitjes së këtij produkti)

Fotot në vijim ilustrojnë procesin dhe produktet nga selektimi dhe përgatitja për riciklim e materialeve që janë mbledhur nëpërmjet sistemi të grumbullimit të diferencuar në komunën e Vushtrrisë, Kosovë).



9.2 Alternativa e qëndrueshme për reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave komunale

Ndërtimi I objektit për Reduktimin dhe Riciklimin e mbeturinave

Ky opsion ngrihet mbi ndërtimin e dhe funksionimin e Objektit për Reduktimin dhe riciklimin e Mbeturinave i planifikuar si një qendër komplekse për trajtimin e mbetjeve për riciklim dhe kompostim apo edhe trajtimin e mbetjeve voluminoze. Plani ka parashikuar ndërtimin e këtij objekti në tre faza, dy prej të cilave do të zhvillohen në kuadrin kohor 2022 – 2023, ndërsa faza e tretë përtej horizontit të këtij plani. Financimi I objektit planifikohet të mundësohet nga burimet e komunës, buxheti i shtetit dhe donacione.

Komuna do të mundësojë menaxhimin e këtij objekti duke zgjedhur një prej instrumenteve:

- Ndërrmarjen komunale për shërbime publike "Higjiena";
- Me sipërmarrje me një apo konsorcium operatorësh privat, ose
- Në kuadër të një Partneriteti Publiko – Privat.

Në çdo rast, komuna do ta paraprijë zgjedhjen e saj mbi bazën e një Studimi Fizibiliteti dhe plani menaxhimi.

Objekti për Reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave ka për qëllim që të sigurojë kushtet teknike për reduktimin e mbeturinave nëpërmjet selektimit të mbetjeve të riciklueshme të thata, kompostimin e mbeturinave të riciklueshme të njoma, administrimin e mbetjeve voluminoze dhe optimizimin e kostove të transportit.

Sipërfaqja e tokës e kërkuar për zhvillimin e objektit është rreth 0.5 ha-1 ha, ndërsa kosto totale e ndërtimit dhe pajisjeve vlerësohen në rreth 1.3 milion Euro. Komuna duhet të synojë të gjejë burime të tjera për ndërtimin e këtij objekti sipas fazave të ndërtimit të tij.

Ndërtimi dhe funksionalizimi I objektit rekomandohet të bëhet në faza:

- Duke marrë në konsideratë që komuna I ka ofruar në dispozicion kompanisë publike Higjiena një hapësirë mbi 2 ha toke në shfrytëzim për nëvoja operative Faza e parë (2022 – 2023) do të përfshijë :
 - o Punimet kryesore të ndërtimit, përfshirë rrethimin, ndriçimin, drenazhimin, rrugët e qarkullimit dhe sheshet e operimit;
 - o Pajisjet /hapësirën për qendrën e ndarjes së mbeturinave të vëllimshme , dhe hapësirat e selektimit për mbetjeve e riciklueshme të thata.
- Faza e dytë (2023 – 2024) do të përfshijë:
 - o Ndërtimin dhe dhe pajisjen e impiantit të kompostimit.
- Faza e tretë (përtej vitit 2024), do të përfshijë:
 - o Ndërtimin dhe funksionimin e ciklit të plotë të selektimit të mbetjeve të riciklueshme dhe riciklimit

Në terma të përgjithshëm, ky objekt do të organizohet në hapësirë si në skicën e mëposhtme:

Ndërtimi i tij supozohet të bëhet në faza andaj edhe hapësira ku intervenohet do të ndahet sipas qëllimit të fazës.



Figura 14. Skema e organizimi të qendrës në tërësi

Tabela 212. Planifikimi i kostove sipas fazave

FAZA E I-RE (2022 – 2023)		SHUMA EURO
PËRGATITJA E PLATOSË/SHËSHIT DHE OBJEKTIT/MBULOJËS/DRENAZHE ETH	Punime ndërtimi	150.000
QENDRA PËR NDARJEN E	Pajisje te fikse (peshore, kontenierë, prese etj)	200.00
MBETJEVE TE RIKIKLUESHME DHE VËLLIMSHME	Pajisje te lëvizshme	100.00
	Projektim, VNM, Supervizimi	
	Shuma Faza e I-re	450.000
FAZA E II-TE (2023 – 2024)		SHUMA EURO
NJËSIA E KOMPOSTIMIT	Punime ndërtimi	300,000
	Pajisje të lëvizshme	200.000
	Shuma Faza e II-te	500.000
FAZA E TRETE (PËRTEJ 2024)		
NJËSIA E SELEKTIMIT TE	Punime ndërtimi	150,000

MBETJEVE TË RIKIKLUESHME NGA ATO MIKSE	Pajisje të fikse	200.000
	Pajisje të lëvizshme	100.00
	Shuma Faza e III-te	450.000
	SHUMA TOTALE	1,300.000

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, komuna do të planifikojnë dhe ekzekutojë hartimin e një Studimi Fizibiliteti të hollësishëm dhe të një raporti për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për këtë objekt. Vënia në funksionim e objektit do të kushtëzojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, fillimisht (deri në vitin 2021) me dy rryma (të riciklueshme të thata dhe të përziera; dhe mbas vitit 2024 në tre rryma, respektivisht, të riciklueshme të thata, të riciklueshme të njoma dhe të përziera.

Ndërtimi Objektit të Trajtimit dhe Riciklimit të Mbeturinave dhe organizmi dhe shtrirja e grumbullimi të diferencuar të mbetjeve fillimisht në dy rryma dhe në vijim aplikimi i ndarjes në tre rryma duke u shtrirë gradualisht në të gjithë territorin e komunës, do të bëjë të mundur reduktimin e mbetjeve që do të depozitohen në deponi mbas vitit 2025 minimalisht në 70% të sasisë që do të gjerohet në territorin e Komunës së Deçanit.

9.3 Organizimi i shërbimit të qëndrueshëm për mbeturinat të vëllimshme dhe mbetjeve jourbane

Të gjitha planet komunale afatmesme dhe afatgjata për Komunën e Deçanit lidhur me minimizim të mbeturinave dhe funksionimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave komunale do të ndërlidhen me funksionalizimin e hapësirës për grumbullim, sortim dhe presim të mbeturinave të riciklueshme (pa përllogaritur sistemet e decentralizuara të kompostimit përmes kompostimit shtëpiak); si edhe duke përfshirë dhe trajtimin e mbeturinave të vëllimshme shtëpiake (orendi, qilima, pajisje elektronike etj).

Deri sa të realizohet kjo, komuna mundet të nisë aplikimin e skenarëve të ndarjes në burim duke tentuar të shfrytëzohë hapësirë të qasshme brenda lokacionit ku komuna është duke ndërtuar objektin e kompanisë komunale "Higjiena", në të cilin kompania mundet të dërgojë në formë të ndarë vetëm mbeturinën e riciklueshme, apo duke bashkëpunuar më sektor të interesuar privat lidhur me dërgimin dhe trajtimin e mbeturinave të riciklueshme në këtë hapësirë.

Paralelisht me ngritjen e skemës së ndarjes në burim, paraqitur komuna duhet të planifikojë koston financiare për ndërtimin e hapësirës ku do të zhvillojë aktivitetet për separim dhe presim apo dhe grumbullimin e materialeve tjera të riciklueshme.

Ky plan kërkon disa faza të ndërmjetme, deri në realizimin e tërësishëm dhe krijimin e mundësive prej anës së komunës për sigurimin e fondeve për realizimin e saj.

Faza 1. Përgatitja e planit për ndërtimin e qendrës së ndarjes në Komunën e Deçanit

Komuna udhëzohet të hartojë një plan për për ndërtimin e qendrës së ndarjes në hapësirat e objektit të kompanisë "Higjiena" duke marrë parasysh të gjitha aktivitetet lidhur me sortimin, presimin, riciklimin e mbeturinave apo skenarë të tjerë që vafORIZOJNË mundësimin e aplikimit të skemave të ndarjes së mbeturinave organike në burim dhe kompostimin e mbeturinave përmes praktikimit të metodave aerobe dhe anaerobe.

Në këtë kontekst sipas planit inxhinjerik udhëzohet të:

- Ndërtohet infrastruktura e nevojshme e objektit facitues si qendër ndarje
- Të plotësohet gradualisht me pajisjet e nevojshme për aktivitetin e sortimit, ballimit të materialit të riciklueshëm referuar kostove kapitale të investimit

Ky plan do të përfshijë:

1. Punime gjurmimi - mbushje ngjeshje dhe transport dheu;
2. Punime për kanalizimet e ujrave të shiut dhe ujrave të zeza;
3. Punime për furnizimin me ujë të pijshëm dhe ujë për shërbime të tjera dhe rrymë elektrike;
4. Rrethimi i hapësirës me rrjetë teli ose panele llamarine të valëzuar dhe një portë me rrëshqitje me qëllim që të jetë i ndarë me objektin kryesor të administratës së kompanisë Higjiena apo me parkingun e kamionëve;
5. Furnizimi dhe vendosja e një peshore deri 40 ton;
6. Asfaltim i sheshit/ platosë;
7. Furnizimi dhe vendosja e Dy kontenerëve për zyra, akomodimin e puntorëve,
8. Ndricim i jashtëm, ndricim i platformës së grumbullimit dhe objektit të magazinimit të mbeturinave të riciklueshme;
9. Ndërtimi i një mbuloje metalike për komplet lokacionin ku pozicionohen kontenerët e vecantë kapriatë metalike me h = 5~ 6 m.
10. Vendosja e min 4 kontenerëve arkë 5-7 ton për selektimin e materialeve (varësisht prej llojit që do të pranohen në qendër)
11. Vendosja e kamerave të sigurisë

Faza 2. Faza e funksionalizimit sipas standarteve të qendrës së ndarjes:

Rekomandohet të hartohet plani për funksionalizimin me standarte bashkëkohore e qendrës së ndarjes duke llogaritur në tërësi: a) koston e investimit për ndërtimin funksional të tij dhe pajisjeve për zhvillim të aktiviteteve të grumbullimit dhe riciklimit të mbeturinave brenda qendrës b) si dhe hartimi i planeve operacionale duke përfshirë funksionimin, ndarjen e përgjegjësisë dhe planifikimin e kostove të mirëmbajtjes së qendrës së ndarjes.

Tabela 223. Kostot e përafërta për ndërtimin e qendrës së grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme dhe riciklueshme sipas planit kohor 2022 – 2023

FAZA E I-RE (2022 – 2023)		SHUMA EURO
PËRGATITJA E PLATOSË/SHËSHIT DHE OBJEKTIT/MBULOJËS/ DRENAZHE ETJ	Punime ndërtimi plato-objekt metalik me mbuloje	123.000
PAJISJE FIKSE ELEMENTARE	Peshore, kontenerë 7t, 1.1m/kub, prese, kabinë, kamera, etj	120.00
PAJISJE TE LËVIZSHME	Pirunierë/mjete tjera	50.00
	SHUMA FAZA E I-RE	295 000

Në Faza të tjera komuna duhet të bëjë plotësimin më infrastrukturë të nevojshme për sortim dhe zgjerimin e lokacioneve tjera ku do të zhvillohet veprimtaria e sortimit dhe riciklimit si dhe ajo e kompostimit.




Figura 15. Organizimi i hapësirës për dërgimin e mbetjeve të riciklueshme dhe mbetje të vecanta (voluminoze, elektroshtëpiake riciklueshme etj) prej kompanisë dhe prej qytetarëve / Plan demonstrativ

❖ ORGANIZIMI I SHËRBIMIT PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE JO-URBANE

Në këtë kategori do të përfshihen:

Mbeturinat medicinale

Autoritetet lokale duhet të monitorojnë në bashkëpunim me Inspektoratin për menaxhimin e mbeturinave spitalore dhe të parandalojnë përzierjen e tyre me Mbeturinat urbane.

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, komuna nuk duhet të lejojë përzierjen mbeturinave spitalore në shërbimin e saj të menaxhimit të mbeturinave. Në Ligjin për Mbeturina neni 38, Menaxhimi i mbeturinave të veçanta nga neni 4. Paragrafi 1. Nën-paragrafi 1.15. i këtij ligji, bëhet sipas metodave, të cilat nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Menaxhimi i mbeturinave të veçanta përcakton qartë detyrimet e prodhueseve të mbeturinave spitalore dhe fazat e kryerjes së këtij procesi deri në asgjësimin e tyre.

Lidhur me këtë komuna/kompania rekomandohet të lidhë kontratë me spitalin rajonal të Pëjës e cila ka kapacitete për asgjësimin e këtij lloji të mbeturinave. Kompania duhet të krijojë kapacitete për grumbullimin e vecantë të këtij lloji të mbeturinave që vijnë prej qendrave të mjekësisë familjare dhe ambulancave private duke i dërguar në formë të vecantë.sipas kontratave të vecanta.

Mbeturinat elektrike dhe elektronike (MEE)

Bazuar në Ligjin Për Mbeturina, neni 43 janë të përcaktuara rregullat lidhur me menaxhimin e këtyre mbeturinave; ndër të cilat, neni 43.2 Mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike nuk duhet të përzihen me mbeturinat e llojeve tjera.43.3 Ndalohet deponimi i mbeturinave elektrike dhe elektronike nëse më parë ato nuk janë trajtuar.43.4. Mbeturinat e lëngëta nga pajisjet elektrike dhe elektronike duhet të grumbullohen të ndara dhe trajtohen në mënyrën e duhur.Prej nenit 43.5 -43.8 Përcaktohen përgjegjësitë e prodhuesit, importuesit apo zotëruesit e të mbeturinave elektrike dhe elektronike. Në këtë kontekst,sipas legjislacionit,autoriteti lokal,njëherësh Komuna e Deçanit duhet të ndërtojë qendra për grumbullimin e diferencuar të MEE që gjenerohen nga familjet dhe të pengojë depozitimin e tyre të përbashkët në deponi. Njëkohësisht, duhet t'i kërkojë zotëruesve të MEE të respektojnë rregullat lokale për grumbullimin e tyre dhe të monitorojnë zbatimin e tyre.

Mbeturinat nga vajrat e përdorur

Është e rëndësishme që komuna të parashohë masa për grumbullimin e këtij lloji të mbeturinave, me qëllim shmangien e ndotjes në mjedisit, dhe në të njëjtën kohë të përfitohet nga riciklimi dhe përdorimi i kësaj lënde.

Për këtë qëllim, industria, konsumatorët dhe garazhet e automjeteve duhet të përfshihen në iniciativat e grumbullimit të kësaj lënde, duke mos i derdhur, por duke i dorëzuar ato pranë grumbulluesve të autorizuar apo të krijohet mundësi të ndarjes së veçantë të kësaj lënde në qendrën e grumbullimit.Në të ardhmen, komuna mund të parashohë krijimin e skemave publike-private për grumbullimin, depozitimin dhe riciklimin e këtyre mbeturinave, duke e shoqëruar sistemin me një sërë sanksionesh lokale administrative në veprime të derdhjes pa kriter të tyre.

Mbeturinat nga gomat e përdorura

Nuk ka të dhëna zyrtare mbi sasinë e mbeturinave nga gomat e përdorura që gjenerohet në komunën e Deçanit dhe nuk ekzistojnë aktivitete formale të grumbullimit të tyre në nivel lokal si edhe qëndror.

Inspektimi i aktiviteteve private të paligjshme të grumbullimit dhe tregtimit të gomave të përdorura, regjistrimi, mbledhja e të dhënave mbi sasinë e këtyre mbeturinave si dhe parandalimi i përdorimit të tyre për djegie të pakontrolluar, mbeten detyrat parësore të autoriteteve lokale.

Përvoja nëpër komuna në Kosovë tregon rastet e shpeshta të ndotjes ilegale prej përdorimit të gomave për djegie, kur gomat digjen në mënyrë të pakontrolluar duke shkaktuar ndotje masive. Duke qënë që ato kanë një vlerë kalorifike të lartë, këto mbetje paraqesin një product me vlerë energjitike për të furnizuar impiantet e ardhshme të trajtimit energjetik të mbeturinave (nëse do ndërtohen një i tillë në rajon apo në vend). Megjithatë, në të gjitha format e organizimit të këtij fraksioni të mbeturinave prej nivelit qendror, komuna duhet të caktojë një lokacion të veçantë për grumbullimin provizor të kësaj kategori të mbetjeve. Lidhur me këtë, organizimi i një lokacioni për këtë kategori të mbeturinave në një hapësirë të caktuar të hapëesirës së jashtme të objektit Higjienë mundet të jetë alternativë provizore për menaxhim të duhur, por që synon të reduktojë hedhjen joformale të këtij lloji të mbeturinave në hapësira të territorit të komunës së Deçanit.

10 RI-ORGANIZIMI I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE DHE NË NIVEL KOMUNAL

Skenari 1: Administrimi i zakonshëm i mbeturinave dhe qendra për grumbullim të mbeturinave të riciklueshme

Ky skenar bazohet në përqasjen e zakonshme të organizimit të shërbimeve të mbeturinave duke filluar nga grumbullimi i mbeturinave nga pikat e përbashkëta apo derë më derë dhe dërgimin e tyre në deponi prej anës së Kompanisë komunale “Higjiena”.




Figura 16. “Skema e menaxhimit të mbeturinave – Skenari 1”

Siç mund ta shohim edhe nga skema, në këtë skenar rekomandohet funksionalizimi i qendrës për grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme, ku qytetari do të dërgojë në këtë qendër mbeturinat e riciklueshme të ndara sipas rregullave të përcaktuara nga komuna e Deçanit. Menaxhimi i qendrës do të bëhet prej kompanisë publike Higjiena dhe përmes proceseve të sortimit do të destinohen për tregun e shitjes sipas fraskioneve të ndara. Rryma e mbeturinave të përziera asesi nuk duhet të destinohet në qendër të grumbullimit por dërgimi i tyre behët në mënyrë direkte në deponinë rajonale në Pejë.

Zbatueshmëria: Kjo skemë është vazhdim i skemës aktuale të mbledhjes së mbeturinave. Ajo gjen zbatim për momentin dhe rezultati mund të jetë mjaft i kënaqshëm në një nivel optimal të largimit të mbeturinave të mbeturinave të vëllimshme dhe të riciklueshme nga rryma e mbeturinave që dërgohen në deponi përmes angazhimit dhe vullnetit qytetar.

Efektiviteti (cilësia): Për sa i përket efektivitetit dhe cilësisë së shërbimit, ky skenar në kushtet e reja të planifikimit të shërbimit (financimit, mjetet, riorganizimi i lëvizshmërisë) mundëson një përmirësim të dukshëm. Sidoqoftë është e nevojshme në këtë skenar të bëhet një informim i publikut lidhur me aplikimin e këtij skenari si edhe të gjinden format e stimulimit financiar për të rritur interesin qytetar për ndarjen dhe dërgimin e mbeturinave të riciklueshme në qendrën e ndarjes.

Performanca e pakësimit të mbeturinave: Në lidhje me pakësimin e mbeturinave dhe perspektivës së saj për përmbushjen e objektivave, ky skenar duket më pak i preferuar dhe më pak efektiv për sa kohë që ai mbështet vetëm në interesin qytetar për ndarjen dhe dërgimin e mbeturinave të riciklueshme në një lokacion të caktuar.

Aspektet sociale: Ky sistem kërkon qëndrim aktiv të banorëve dhe bizneseve, ndaj ai duhet të inkurajojë pjesëmarrjen e tyre përmes mekanizmave tariforë apo modalitete tjera të ofruara prej kompanisë apo komunës. Si skenar ofron shërbim të barabartë, ku të gjithë qytetarët kanë qasje të dërgojnë vullnetarisht mbeturinat e riciklueshme apo dhe ato të vëllimshme ku zhvillimi i politikave sociale të komunës mundet të jetë element shtytës për inkurajimin qytetar.

Si përfundim, ky skenar përfaqëson një mënyrë praktike dhe me kosto të ulët operimi, por nuk ofron kushtet optimale për zhvillimin e skemave efektive të minimizimit të mbeturinave.

Skenari 2: Administrimi i Kombinuar i Mbeturinave

Në kontest, ky skenar i administrimit të mbeturinave bazohet në sistemin e mbledhjes individuale në burim mbi të cilat janë aplikuar skemat e ndarjes dhe mbledhjes së mbeturinave të riciklueshme. Ky skenar parashikon ndryshimin gradual nga sistemi aktual i mbledhjes drejt atij të kombinuar. Duke ju referuar përbërjes merceologjike të mbeturinave si edhe duke konsideruar objektivat që parashikon strategjia kombëtare e mbeturinave për menaxhimin e integruar të mbeturinave, komuna synon të ndërmarrë hapa në ndarjen e mbeturinave në burim. Kjo gjë duhet të bëhet në bashkëpunim me operatorë të interesuar për grumbullimin e materialeve të riciklueshme, por mund të bëhet edhe nga vetë komuna me ndërmarrjen e saj komunale për grumbullim dhe transportim të mbeturinave. Paraprakisht komuna rekomandohet të nisë fushata ndërgjegjësose me komunitetin dhe me projekte pilot në zonë të caktuar për ta shtrirë më tutje sistemin e ndarjes në burim në tërë territorin komunal.

Për këtë rekomandohet që ky proces të fillojë në zonat me dendësi të lartë (aty ku shërbimi kryhet 7 herë/javë), në shtëpi me banim individual aty ku shërbimi bëhet 1 herë në javë dhe derë më derë, pranë institucioneve apo pranë bizneseve si edhe në çdo subjekt që shpreh dëshirën për të bashkëpunuar në këtë aspekt.

Zbatueshmëria dhe cilësia e shërbimeve: Zbatimi i sistemit individual të ndarjes në burim kërkon pjesëmarrjen aktive të komunitetit. Për sa i përket cilësisë së shërbimeve, nëse banorët dhe bizneset bien dakord të marrin pjesë aktivisht në këtë skemë individuale të mbledhjes së mbeturinave, kjo me siguri do të zgjidhë shumë probleme me situatën aktuale të administrimit të mbeturinave. Ky skenar propozohet të vihet në zbatim pas aplikimit të tij në një zonë pilot, ku janë parë sjelljen e banorëve apo subjekteve aty dhe më tutje të planifikohet zgjerimi në territorin komunal. Kjo do të kërkojë, si fillim zgjedhjen e një zone të mirë pilotimi dhe aplikimin e disa masave nxitëse, si tarifim të reduktuar për konsumatorët që do t'i ndajnë mbeturinat në burim. Një zonë e mirë pilot mund të jetë një zonë me përqendrim të lartë të familjeve me nivel të vetëdijes së lartë lidhur me pagesën e tarifës si dhe me potencial të gjenerimit të sasisë së mbeturinave të riciklueshme sipas të ardhurave të ekonomive familjare në zonë.

Performanca në funksion të minimizimit të mbeturinave: Kjo ofron një perspektivë të mirë për ngritjen e një sistemi efektiv dhe cilësor për ndarjen në burim të mbeturinave, gjë që do të çonte në përkrahjen e skemave të riciklimit dhe kompostimit në të ardhmen dhe do të siguronte respektimin e plotë të objektivave kombëtarë dhe lokale për pakësimin e sasisë së mbeturinave të deponuara. Si përfundim, skenari i kombinuar i administrimit të mbeturinave paraqet një sistem të përmirësuar që është i përqendruar në performancën e përgjithshme të shërbimit për sa i përket cilësisë dhe pakësimit të mbeturinave, por duket mjaft i ndjeshëm dhe i varur nga shkalla e përfshirjes së publikut si dhe kapacitetet operative të grumbullimit. Ai kërkon aftësi të menaxhimit të mirë nga autoritetet vendore për të vepruar me efektivitet dhe efikasitet për uljen e kostove apo politikave tjera që komuna mund të zgjedhë në të ardhmen.

Sipas këtij skenari për Administrim të Kombinuar i Mbeturinave do të vijojnë rekomandimet lidhur me masat paraprake dhe koston financiare që atribuohet për këtë skemë.

Implementimi i objektivës së planit për ndarjen në burim dhe riciklimin e mbeturinave sipas sistemit:

Skema individuale – Sistemi parësor

Sistemi i mbledhjes individuale nga familjet dhe bizneset përbën bazën për ngritjen e sistemit të ndarjes së mbeturinave. Duhet thesuar se sistemi i ndarjes në burim duket më i rekomandueshëm si zgjedhje fillestare për nisje sistemi për ndarje në burim, krahasuar me sistemin e ndarjes së mbeturinave në rrugë përmes lokacioneve të përbashkëta në pika grumbulluese. Nga kjo pikëpamje, angazhimi i drejtpërdrejtë i pronarëve apo personave të kontaktit të bizneseve apo familjeve siguron më shumë ndërgjegjshmëri, efektivitet dhe mundësi financimi sesa sistemi i hapur (në pika grumbullimi të përbashkëta mbi të cilin mbështetet skema e përbashkët). Ndarja në burim mund të jetë më praktike dhe e efektshme për amvisëritë, biznesin dhe industrinë, ku duhet të mundësohet shërbimi individual i grumbullimit të mbeturinave. Shportat për ndarjen e mbeturinave në burim mund të vendosen në çdo amvisëri ku shërbimi kryhet derë më derë, njësi të madhe biznesi apo institucion shtetëror duke ndjekur të njëjtën teknologji si sistemi i mbledhjes individuale. Sistemi duhet të jetë sa më i thjeshtë duke synuar vetëm ato mbetje apo komponentë që mund të riciklohen sipas tregut të shitjes në nivel vendi. Për këtë arsye, sistemi me dy kontenierë të vegjël duket më i favorshëm se të tjerët. Rekomandohet të caktohet një kodi me ngjyra për alternativën me dy kontenierë që konsumatorët ta kenë parasysh rregullat kur vendosin të depozitojnë mbeturinat aty. Ngjyrat duhet të përcaktohen qartësisht që në fillim:

Kodi i ngjyrave për fraksione për kontenierët për ndarje në burim nënkupton:

- Në kontenierin me ngjyrë të verdhë do të depozitohen Mbeturinat plastike, letër dhe karton kanaçet metalike (Të riciklueshme).
- Në kontenierin me ngjyrë të gjelbërt (aktualisht që posedohet prej amvisërisë) do të depozitohen mbetje të tjera.
- Kontenier për ndarje të fraksionit organikë (system I centralizuar kontenier 120l ngjyrë e kaftë/ system I decentralizuar komposter shtëpiak sipas sistemit të integruar)
Në të ardhmen rekomandohet që komuna të shtojë rrymat e ndarjes në burim sipas llojit të mbeturinave, duke vendosur shporta me ngjyrë/kod tjetër me qëllim diferencimin sipas llojit.

SKENAR 3 – Përfshirja e sektorit privat në menaxhim të mbeturinave të riciklueshme

Ky skenar do të duhet të merret në konsideratë në mungesë të kapaciteteve për investim prej anës së institucioneve lokale dhe qëndrore dhe administrim prej anës së Kompanisë Publike dhe ku

parashihet përfshirja e sektorit privat, me anë të konçesionit apo PPP dhe ku kompania private investon në ngritjen e sistemit për ndarje në burim dhe ku do të inkurajohet si një mekanizëm për ofrimin e zgjidhjes më të mirë ekonomike që do të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore dhe menaxheriale në funksionalizimin e sistemit. Identifikimi dhe nxitja e biznesit të riciklimit që është aktiv në lokalitet apo rajon do të jetë një nga detyrat kryesore të komunës për të mbështetur riciklimin në qytet. Skemat publik - privat në shtetet e zhvilluara mbeten zgjidhje alternative për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori, megjithatë në nivel vendi dhe lokal përvojat e mëhershme nuk janë treguar të suksesshme në këtë drejtim. Në të gjitha skenarët e mundshëm rekomandohet që sistemi të jetë i organizuar përmes instalimit të ndarjes në burim të fraksioneve të riciklueshme, me qëllim që sistemi të jetë profitabil për kompaninë publike apo private. Më poshtë janë paraqitur edhe rolet sipas sektorëve që interferojnë në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe ku koordinimi i ndërsjellë krijon parakushte për zhvillime të projekteve të qëndrueshme.

Në këtë këndvështrim sektori publik (komuna) duhet të: i) Të përcaktojë marrëveshje të qarta institucionale;

ii) Të qartësojë përgjegjësitë lidhur me këtë shërbim; iii) Fragmentizim vetëm nëpërmjet operatorit të shërbimit dhe rregullatorit; iv) Politika për qeverisje të mirë; v) Transparence dhe llogaridhënie.

Roli i sektorit privat në menaxhimin e mbeturinave

Në sektorin e menaxhimit të mbeturinave sektori privat mund të kontribuojë në 2 forma në marrëdhënie me komunën:

I. Pjesëmarrja e sektorit privat (PSP) - kontraktimi direkt i shërbimit nga kompanitë private të interesuara qoftë për grumbullim të mbeturinave të përgjithshme apo grumbullim vetëm për mbeturinat e riciklueshme.

II. Partneritet Publik Privat (PPP) –varësisht prej shërbimit të nevojshëm prej komunës, në grumbullim apo në menaxhim të deponisë inerte apo qendrës së grumbullimit. Ky opsion merret në konsideratë në rast të mungesës së kapaciteteve për menaxhimin të shërbimit dhe investime të nevojshme prej anës së kompanisë publike apo komunës.

Respektivisht për Komunën e Deçanit, rekomandohet që komuna duhet të bëjë përlogaritjen e kostonë së shërbimit të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave në tërësi, si edhe të krijojë kushte të marrjes përsipër të pagesës së shërbimit dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të grumbullimit të mbeturinave prej anës së qytetetarëve.

Më tutje, përfshirja e drejtpërdrejtë e sektorit privat në fushën e menaxhimit të mbeturinave mundet të merret parasysh sipas dy opsioneve si më poshtë:

1. Në rast të mungesës së kapaciteteve prej kompanisë publike për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të riciklueshme bazuar në politikat komunale. Në këtë rast duhet të bëhet rishikimi i tarifës së paguar prej anës qytetare për grumbullimin e mbeturinave të përgjithshme dhe atyre të riciklueshme.

2. Në rast të mungesës së kapaciteteve për investime në infrastrukturë separimi, ambalazhimi, kompostimi etj, të mbeturinave të riciklueshme prej anës së komunës apo kompanisë komunale.

Madhësia e ndërmarrjeve të krijuara në këto raste mund të jetë ndërmarrje të vogla dhe të mesme, të cilat mund të jenë të formën e joint venture me publikun, duke përfshirë grupe të ndryshme komunitare apo subjekte joqeveritare. Përfshirja e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbeturinave ka shumë përparësi, pasi ofron shërbim më eficient, fleksibël për të njëjtën kosto, ka akses të lehtë në kapital (blerje makinerish/pajisje zëvendësuese etj), dhe ofron shërbim të rregullt mirëmbajtjeje duke u bazuar në parimin e kontrollit të cilësisë. Në mënyrë që përfshirja e sektorit privat në shërbimet e menaxhimit të mbeturinave të jetë sa më efektive dhe të japë rezultatet e

duhura në territor duhet të merren në konsideratë disa parakushte: i) Partneritet i barabartë; ii) Garë në përgjedhjen e përfaqësuesve të këtij sektori; iii) Objektiva të qarta dhe kontrata të mirëdefinuara me komunën; iv) Monitorime të vazhdueshme dhe penalitete nga ana e komunës për firmën kontraktore; v) Pagesa të rregullta për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit dhe për të mos ulur cilësinë; vii) Përfshirje të publikut.

Megjithatë sipas vlerësimeve dhe potencialit të komunës dhe kompanisë komunale për qasje në fonde shtetërore apo të donatorëve të ndryshëm dhe potencialit të saj në resurse njerëzore tregohet se kompania publike komunale "Higjiena" ofron mundësi për të krijuar kapacitete për krijimin e strukturës që operon drejtpërsëdrejti në grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave. Në këtë rast, mundësia e përfshirjes së sektorit privat do të jetë lehtësisht e zbatueshme sipas korelacionit të bashkëpunimit të kompanive private me kompaninë publike në procesin e perpunimit apo shitjes së drejtpërsëdrejtë të mbeturinave të riciklueshme në të ardhmen.

10.1 Plani financiar i shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve

KOSTO E SHËRBIMIT 2021-2025

Kosto e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave ndahet sipas llojit të shpenzimit dhe veprimtarisë së shërbimit që kryhet përmes tij, në zërat e mëposhtëm:

- A. Kosto operative
 - a. Kostot e mirëmbajtjes: mjete të shërbimit
 - b. Kostot e grumbullimit: karburant i përdorur gjatë shërbimit
 - c. Kosto transporti: karburant i përdorur gjatë shërbimit
 - d. Kosto depozitimi: shpenzimet për trajtimin e mbetjeve në deponi
 - e. Kosto personeli: shoferë dhe punëtorë
 - f. Kosto amortizimi: mjete të shërbimit
 - g. Kosto larje dhe dezinfektim: për kontenerët

- B. Kosto kapitale
 - a. Kosto e blerjes së mjeteve të shërbimit

Në realizimin e shërbimit marrin pjesë, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, dhe drejtues e nëpunës specialistë të bashkisë, shpenzimet për të cilët vlerësohen në masën 8 % të kostos operative dhe përfshihen në zërin:

- C. Kosto administrative

Rëferuar kostove indirekte dhe administrative përfshijnë pagat indirekte të NPL Higjiena, shpenzimet administrative si dhe kostot e tjera për aktivitete profesionale për nevojat e kompanisë (fushatave vetëdijësuese etj). Duke u bazuar në situatën referente se NPL Higjiena ka të angazhuar një staf të madh administrativ referuar parallogaritjeve, për rrjedhojë plani nuk parasheh ngritje të mëtejme të kostove administrative përgjatë periudhës planifikuese si në regrutimin e stafit të ri ashtu edhe në shpenzimet përcjellëse.

- D. Të ardhurat neto të planifikuara

Të hyrat e shërbimit i referohen të hyrave nga grumbullimi i mbeturinave, shërbimeve sekondare dhe shërbimeve tjera sipas kontratave të veçanta dhe këto të hyra realizohen përmes NPL Higjiena.

- E. Kosto e menaxhimit të mbeturinave

Llogaritja e kostove të mësipërme është në përputhje me metodën e Llogaritjes së Kostos së Plotë dhe në zbatim të Planit Teknik dhe Operacional të realizimit të shërbimit për menaxhim të

mbeturinave. Këtu përfshihen të gjitha kostot e menaxhimit të mbeturinave përfshi kostot e grumbullimit, pastrimit dhe deponimit që barten nga NPL Higjiena si dhe kostot e ndarjes, riciklimit dhe procesimit të mbeturinave që mbarten nga Komuna apo palë të treta të kontraktuara.

10.2 Kosto operative të shërbimit

Kostot operative vjetore të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave për vitet 2020-2025, me TVSH, paraqiten në tabelën në vijim, duke marrë si referent planifikimet financiare deri më tani dhe shpenzimet operative të ndërmarrjes në periudhë gjashtë mujore të vitit kalendarik 2019.

Tabela 234. Shpenzime operative

	Kosto derivate	Kosto direkte indirekte dhe administ.	Kosto administrati ve	Kosto mirëmbajtje	Kosto deponim	Totali kosto operative
Planifikimi I shpenzimeve 2019	48,973 €	116,235 €	6,975	15,266	12,720 €	200,169.00
Shpenzime referent 01.07.2019-31.12.2019	17,130.55	71,713.15	5,681.21	10,736.60	9,696.13	114957.64
Shpenzime vjetore sipas vlerave të kompanisë	37 686***	143,426.3**	11,362.42	21,473.2	12 720*	213,948.00
						224,645.4****

*duke marrë në konsideratë shtrirjen e menjëhershme të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në fund të vitit 2019

**Rritja e kostove indirekte varion sipas kontrateve sekondare të kompanisë me komunë

***10% e totalit të kostos referente shpenzime të derivateve të paraqitur prej NPL Higjiena e shtuar në përlogaritje,

****5% mbi kosto totale, kjo vlerë ka për qëllim të korrigjojë vlerat në vite të zërave të kësaj kostoje, llogaritur mbi bazën e çmimeve aktuale, me inflacionin mesatar vjetor të mundshëm, si dhe me shumën e një fondi rezervë i cili duhet të mbulojë shpenzime të papritura ose në rritje për arsye të tjera të paparashikueshme

Referuar kostove bazë referente në tabelën më poshtë parashihet projeksioni I kostove operative për periudhë kohore 2020-2025.

10.3 Kosto kapitale

Kosto kapitale përfaqëson investimin në automjete dhe pajisje ku respektivisht për Komunën e Deçanit do të përfshijnë kostot për:

- Realizimin e shërbimit të bartjes së mbeturinave, të cilat përfshijnë kontenierë, kamionë që do të përdoren për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave.
- Realizimin e infrastrukturës për deponinë inerte
- Realizimin e infrastrukturës për qendrën e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme

- Realizimin e infrastrukturës për përcjellëse për qendrën e reduktimit dhe riciklimit të mbeturinave
- Sigurimin e kontenierëve për ndarje në burim, përfshirë enët kompostuese (sipas sistemit të decentralizuar)

Kostot investive për realizimin e shërbimit të bartjes së mbeturinave

NPL Higjiena posedon gjithsej 11 kamionë, ndër të cilët 2 janë jashtë përdorimi dhe 7 prej tyre janë në gjendje të amortizuar dhe sit ë tillë duhet të parashihen të zëvendësohen ndër vitet në vijim. Plani investiv është bazuar në nevojat e përlogaritura sipas nevojave të NPL Higjiena dhe kapacitetit të punës së kamionëve ekzistues. Sipas situatës së paraqitur, do të nevojiten 3 kamionë ndër të cilët një më me kapacitet 7 ton dhe dy të tjera me kapacitet 10 ton.

Kostot investive për Sigurimin e kontenierëve për unifikim të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave

Aktualisht NPL Higjiena posedon infrastrukturë në gjendje të mirë për zbrasjen e mbeturinave në kontenierë si rezultat i ndihmës financiare prej anës së donatorëve dhe komunës për sigurimin me infrastrukturë për realizimin e shërbimeve të zbrastjes së mbetjeve. Megjithatë me qëllim unifikimin e sistemit të grumbullimit komuna dhe kompania duhet të planifikojnë sigurimin e 1500 kontenierëve 120 l për grumbullim të mbeturinave, shpërndarja e të cilave do të bëhet sipas planeve për plotësim me infrastrukturë për shërbim të grumbullimit të mbeturinave.

Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës për deponinë inerte

Në këtë kosto do të përfshihen kostot e investimit në funksionalizimin e lokacionit të planifikuar për deponimin e përkohshëm të mbeturinave inerte, lokacion ky i cili duhet të përshtatet me kushtet bazike për operim të sigurtë. Duke qenë se komuna parasheh të marrë përsipër këtë kosto, kjo nënkupton që ndarja e kostove mund të variojë sipas mundësive investive prej anës së komunës respektivisht buxhetit të sektorit.

Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës për qendrën e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme dhe të riciklueshme

Në këtë kosto do të përfshihen kostot e investimit në funksionalizimin e lokacionit të planifikuar për deponimin dhe trajtimin e përkohshëm të mbeturinave të vëllimshme. Funksionalizimi i një pike grumbulluese të përkohshme për mbeturinat voluminoze mund të planifikohet në një fazë të parë të bëhet pranë deponisë inerte për tu ndërtuar dhe plotësuar më tutje në qendrën për reduktim dhe riciklim të mbetjeve. Duke marrë parasysh se komuna synon të nisë programet e riciklimit, relativisht në koston e investimit do të planifikohet edhe infrastruktura bazike për zhvillimin e aktivitetit të sortimit dhe paketimit të mbeturinave të riciklueshme përfshirë këtu edhe investimin në mjet grumbullues.

Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës përcjellëse për qendrën e reduktimit dhe riciklimit

Referuar politikës nacionale sipas Strategjisë për menaxhim të integruar të mbeturinave, planifikimet e komunës sipas zërave të kostove do të adresohen në ndërtimin e infrastrukturës përcjellëse që ndihmojnë në ngritjen e sistemeve të qëndrueshme të trajtimit të mbeturinave sipas llojeve. Këtu do të parashihen kostot e investimit për ndërtimin e qendrës për reduktim dhe riciklim të mbeturinave sipas planifikimit të detajuar për zbatimin e tij. Shpërndarja e kostove do të bëhet sipas fazave bazuar në kapacitetet komunale për investim të tillë.

Kostot investive Sigurimin e kontenierëve dhe infrastrukturës për ndarje në burim, përfshirë dhe enët kompostuese.

Në këtë kosto do të përfshihen kostot e investimit të infrastrukturës përcjellëse për zbatimin e ndarjes në burim sipas programeve të riciklimit dhe kompostimit përmes sistemeve të decentralizuara në nivel komunal. Sipas linjave të investimit do të përlogariten kostot e sigurimit të shportave për ndarje në burim dhe enëve kompostuese.

Në tabelën në vijim janë ofruar të dhëna të detajuara mbi investimet kapitale përgjatë periudhës 2020-2024.

Tabela 245. Projektionet e investimeve kapitale

	2021	2022	2023	2024	2025
Kostot e investimeve kapitale	395 000	270 000	457 200	273 200	767 550
Kosto e investimeve për kontenierë 120l për plotësim për grumbullim bazik	27 000	-	-	-	-
Kosto për kamionë për grumbullim	100 000	-	-	-	-
Kosto kamion mbeturina riciklueshme	30 000	-	-	-	-
Kontjenerët për riciklim dhe ndarje në burim/system paresor	14 000	14 000	39 200	39 200	-
Kontjenerët për riciklim dhe ndarje në burim/system dytësor	3000	6000	-	-	-
Kompostere shtëpiake	-	-	25 000	34 000	14 550
Kontenierë për organikë 3-5 ton	-	-	-	-	3000
Qendra Për ndarje dhe riciklim	100 000	100 000	250 000	-	-
Njesia për kompostim	-	-	-	200 000	300 000
Pajisje për qendrën e riciklimit dhe optimizim shërbimi	-	-	-	-	450 000
Deponia e materialeve inerte (vetëm ndërtimi infrastrukturor dhe shtrim i rrugës)	121,000	-	-	-	-
Pajisje për përpunim mbetje inerte	-	150 000	143 000	-	-

Siç shihet në tabelën më lart, projektioni i investimeve do të zhvillohet me synim të përgatitjes së Komunës për nisjen dhe zbatimin e politikave nacionale për reduktim riciklim të mbeturinave, duke synuar trajtimin adekuat të mbetjeve sipas llojit të tyre. Kjo do të nënkuptojë që deri në vitin 2025 synimet e Komunës së Deçanit do të paraprijnë procesin duke krijuar infrastrukturën përcjellëse për trajtimin e mbetjeve inerte, mbetjeve të vëllimshme, të riciklueshme sipas fraksioneve duke përfshirë dhe kompostimin central të mbetjeve organike. Kjo do të nënkuptojë që përtej periudhës kohore prej vitit 2025 komuna posedon potencial infrastrukturor që të harmonizojë dhe zgjerojë planet e reduktimit dhe riciklimit të mbeturinave në njësi territoriale dhe të zhvillojë potencial dhe për mundësinë e bashkëpunimit me komunat përreth përmes qendrës të riciklimit dhe kompostimit .

Kosto shtesë

Përkrah kostos së shërbimit të menaxhimit të mbeturinave, një buxhet shtesë është i nevojshëm të parashikohet për disa shpenzime mbështetëse të cilat kanë për qëllim përmbushjen e objektivave të qëndrueshmërisë financiare. Këto shpenzime mbështesin veprimtaritë e komunës si më mëposhtë:

1. Ndërgjegjësim dhe edukimi i banorëve për mbrojtjen e mjedisit

Kjo veprimtari planifikohet të mbështesë rritjen e efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave të shërbimit nga subjektet pagues, në masën e përmbushjes së objektivave të vendosur në këtë drejtim, të paraqitur si më sipër. Plani i veprimit parashikon shpenzime vjetore shtesë gjatë gjithë periudhës 2020-2025, të cilat mund të shtrihen dhe në periudha të mëvonshme, në varësi të objektivave të mëtejshme të komunës së Deçanit.

2. Ngritja e bazës së të dhënave të subjekteve pagues

Një bazë të dhënash mbi subjektet gjeneruese të mbetjeve, në formatin e një programi kompjuterik, është një instrument i domosdoshëm për vënien në zbatim të sistemit të tarifimit të shërbimit të menaxhimit të tyre dhe rritjes së efektivitetit të mbledhjes së të ardhurave nga tarifa. Një identifikim i saktë i këtyre subjekteve: vendndodhjes së tyre, madhësisë e gjendjes financiare të tyre, llojit të aktivitetit në rast biznesi etj. i mundëson autoriteteve vendore ndjekjen e rasteve të subjekteve që nuk paguajnë dhe zbatimin efektiv të masave shtrënguese. Edhe në këtë rast, NPL Higjiena dhe komuna e posedojnë një system të databazës sipas të dhënave të adresave, baza e të dhënave duhet t'i shërbejë drejtpërdrejt përmbushjes së objektivave të vendosur për rritjen e % së mbledhjes së të ardhurave të shërbimit, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë financiare.

Baza e të dhënave duhet të përditësohet çdo vit kalendarik dhe mund të përdoret për ndërlidhjen e listave të klientëve dhe tarifimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve, në rast të përshtatshëm.

10.4 Kostot investive për realizimin e PMIM

Tabela 36 Tabela përmbledhëse e investimit

Investimet e parapara në PMIM për vitin 2021					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipasi objektivave të PMIM
Kosto e investimeve për kontenierë 120l plastikë	1500	18	27 000€	Sipas skemës së shërbimit derë më derë, sigurimi i kontenierëve i referohet planit të komunës për unifikim dhe plotësim të sistemit të grumbullimit referuar politikave komunale për rritje të shkallës së pagesës dhe nr të kontratave.	O1: Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizim të kostove dhe shërbimit në komunën e deçanit.
Kosto për kamionë për grumbullim me kapacitet 7-10 ton	3	Cmim variabël	100 000	Bazuar në gjendjen fizike dhe vjetërsisë të kamionëve me të cilët operon NPL higjiena, rekomandohet që kjo kompani të zëvendësojë apo plotësohet me 3 kamionë për operim.kjo do të synojë të ngrisë cilësinë e shërbimit sipas operimit të rregullt dhe të reduktojë kostot operative dhe të mirëmbajtjes. Sipas praktikës prej komunës, çmimi në kosto parasheh furnizim me kamionë të përdorur.	O1: Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizim të kostove dhe shërbimit në komunën e deçanit.
Kosto kamion mbeturina riciklueshme me kapacitet 5-7 ton	1	30 000	30 000	Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën për zbatimin e skemës për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare për reduktimin e mbetjeve. Sipas praktikës prej komunës, çmimi në kosto parasheh furnizim me kamionë të përdorur.	O3: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës O.4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme
Kontenierët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem parësor 240 l ngjyrë e verdhë	500	28	14 000	Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata –riciklueshme dhe organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të riciklimit në 500 ekonomi familjare/bisnese	O3: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës

Kontenierët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem dytësor Rrjetë metalike/konteni erë të posaçëm për riciklim	10	300	3000	Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata –riciklueshme dhe organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve në 5 institucione edukative dhe në 5 lokacionet e pikave të grumbullimit në qytet	O3: Të garantojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Ndërtimi i Qendrës Për ndarje,grumbullim dhe riciklim		Cmime sipas njësive të kostove	100 000	Bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave sipas objektivave të parapara në strategjinë kombëtare për Menaxhim të integruar të mbeturinave dhe zgjidhjes së problematikës së komunës për mbetjet e vëllimshme dhe objektivave të komunës për zbatimin e programeve për reduktim dhe riciklim të mbetjeve,zvogëlim të ndotjes dhe kostove të deponimit, me qëllim që sistemi të jetë i qëndrueshëm komuna duhet të parashohë trajtimin e mbetjeve të vëllimshme dhe të riciklueshme. Njësia për mbetje të vëllimshme do të ndihmojë në krijimin e një sistemi të integruar për banorët e komunës. Përmes këtij investimi realizohet ndërtimi i pjesshëm i qendrës(mbulesës dhe dhomat e magazinimit). Ky investim nuk përfshin kosto të tokës pasi që lokacioni parashihet në pronë komunale dhënë në shfrytëzim NPL higjiena.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi O.4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme O.4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme
Deponia e materialeve inerte (punime ndërtimi infrastruktur dhe shtrim i rrugës)		Cmime sipas njësive të kostove	121 000	Bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave,objektivave kombëtare sipas Strategjisë për menaxhim të integruar të Mbeturinave dhe zgjidhjes së problematikës së komunës për mbetjet inerte,komuna do të parashohë ndërtimin e lokacionit për deponi inerte dhe funksionalizimin bazik të tij.bazuar legjislacionit për lokacionet/deponitë ndër të tjerash lokacioni duhet ti përmbajë kriteret e përcaktuara dhe të ketë qasje rrugore për funksionim. Kosto e investimeve pra nuk përfshin kostot e tokës por kostot për ndërtimin e rrugës për në deponi dhe kosto të ndërtimit të deponisë.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave sipas llojit me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi
Totali 2021		395 000			
Investimet e parapara në PMIM për vitin 2022					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipasi objektivave të PMIM

Kontenierët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem parësor 240 l ngjyrë e verdhë	500	28	14 000€	Sipas objektivave dhe strategjisë nacionale, Komuna Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata –riciklueshme. Zbatimi i skemës së riciklimit të frasionit të thatë do të zgjerohet në 500 amvisëri shtesë sipas zgjerimit gradual të skemës së riciklimit.	O3: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Kontenierët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem dytësor Rrjetë metalike/kontenierë të posaçëm për riciklim	20	300	6000	Sipas objektivave dhe strategjisë nacionale, Komuna Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata –riciklueshme. Zbatimi i skemës së riciklimit të frasionit të thatë do të zgjerohet në 20 institucionet edukative në komunë.	O3: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Ndërtimi i qendrës për ndarje të mbetjeve të vëllimshme dhe aktivitete për riciklim		Cmime sipas njësive të kostove	100 000	Bazuar në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave sipas objektivave të parapara në strategjinë kombëtare për Menaxhim të integruar të mbeturinave dhe zgjidhjes së problematikës së komunës për mbetjet e vëllimshme dhe objektivave të komunës për zbatimin e programeve për reduktim dhe riciklim të mbetjeve, zvogëlim të ndotjes dhe kostove të deponimit, me qëllim që sistemi të jetë i qëndrueshëm komuna duhet të parashohë trajtimin e mbetjeve të vëllimshme dhe të riciklueshme. Njësia për mbetje të vëllimshme do të ndihmojë në krijimin e një sistemi të integruar për banorët e komunës. Përmes këtij investimi realizohet ndërtimi i pjesshëm i qendrës (mbulesës dhe dhomat e magazinimit). Ky investim nuk përfshin kosto të tokës pasi që lokacioni parashihet në pronë komunale dhënë në shfrytëzim NPL higjiena.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogëlimit të sasisë që përfundon në deponi O.4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme O.4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme
Pajisje për përpunim të mbetjeve inerte		Cmime sipas njësive të kostove	150 000	Plotësimi me infrastrukturë operative në deponinë për inerte ku do të bëhet trajtimi i materialit inert me qëllim rishfrytëzimin e materialeve ndërtimore dhe uljen e impaktit mjedisor prej deponimit të tyre në lokacion. Në këtë qendër NPL higjiena do të zhvillojë aktivitetin e selektimit dhe presimit të mbetjeve të riciklueshme.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogëlimit të sasisë që përfundon në deponi O.4.3 : Menaxhim i qëndrueshëm i mbeturinave ndërtimore
Totali Kosto Investive në 2022			270 000€		

Investimet e parapara në PMIM për vitin 2023					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipasi objektivave të PMIM
Kontenerët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem parësor 240 l ngjyrë e verdhë	1400	28	39 200 €	Sipas objektivave dhe strategjisë nacionale, Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata –riciklueshme. Zbatimi i skemës së riciklimit të fraksionit të thatë do të zgjerohet në 1400 amvisëri shtesë	O3: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Ene për kompostim shtëpiak (sistem i decentralizuar)	500	50	25 000	Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit organik për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Zbatimi i skemës së kompostimit të fraksionit të thatë do të nisë në 500 amvisëri në zonë urbane dhe rurale ku synohet rreth 40% e gjenerimit ditor në këto amvisëri të reduktohet; duke nënkuptuar reduktim të kostove operative dhe të deponimit.	O3: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë së mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës it. O.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organike
Qendra për ndarje dhe riciklim		Cmime sipas njësive të kostove	250 000	Plotësimi me infrastrukturë operative në qendrën e grumbullimit dhe magazinimit. Në këtë qendër NPL higjiena do të zhvillojë aktivitetin e selektimit dhe presimit të mbetjeve të riciklueshme.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimin të veçantë dhe zvoglimin të sasisë që përfundon në deponi O.4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme O.4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme
Pajisje për përpunim të mbetjeve inerte		Cmime sipas njësive të kostove	143 000	Plotësimi me infrastrukturë operative në deponinë për inerte ku do të bëhet trajtimi i materialit inert me qëllim rishfrytëzimin e materialeve ndërtimore dhe uljen e impaktit mjedisor prej deponimit. Në këtë qendër NPL higjiena do të zhvillojë aktivitetin e selektimit dhe presimit të mbetjeve të riciklueshme. kjo kosto përfshin vetëm kosto të pajisjeve për zhvillim të aktivitetit në deponi.	O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimin të veçantë dhe zvoglimin të sasisë që përfundon në deponi O.4.3 : Menaxhim i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore

Totali Kosto Investive në 2023			457 200€		
Investimet e parapara në PMIM për vitin 2024					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipasi objektivave të PMIM
Kontenierët për riciklim dhe ndarje në burim/sistem parësor 240 l ngjyrë e verdhë	1400	28	39 200 €	Sipas objektivave dhe strategjisë nacionale, Komuna Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit të thata –riciklueshme. Zbatimi i skemës së riciklimit të frasionit të thatë do të zgjerohet në 1400 amvisëri shtesë.	03: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës
Enë kompostuese	680	50	34 000	Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Zbatimi i skemës së kompostimit të frasionit të thatë do të nisë në 680 amvisëri në zonë rurale (fshatrat më në largësi) ku synohet rreth 40% e gjenerimit ditor në këto amvisëri të reduktohet; duke nënkuptuar reduktim të kostove operative dhe të deponimit.	03: Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës 0.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organike
Ndërtimi i qendrës për kompostim		Cmime sipas njërive të kostove	200 000	Krijimi i qendrës për reduktim,riciklim dhe kompostim të mbeturinave do të ndihmojë komunën që të zvogëlojë deri në 70% të sasisë së mbetjeve të deponuara.njëherësh trajtimi i mbeturinave përmes aktivitetit të qendër synon të krijojë të hyra shtesë(përmes shitjes nga riciklimi apo kompostimi)për operatorin (NPL higjiena) me çrast rritjen e efikasitetit dhe performancës së shërbimit. Meqënëse deçani ka hapësira të gjelbra kjo ofron material për kompostim gjatë aktitetit të pastrimit të tyre.kompostim mund të përdoret për qytetarët e komunës për aktivitete bazike të kultivimit.kjo kosto do të përfshijë investimin bazik për qendrën për kompostim duke u bazuar në investimet në ndërtim dhe pajisjet bazike për zhvillimin e aktivietit të kompostimit.	04: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi 0.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organike
Totali Kosto Investive në 2024			273 200€		
Investimet e parapara në PMIM për vitin 2025					
Investimi i planifikuar	Sasia	Kostoja njësi	Kostoja totale	Qëllimi i investimit	Përputhshmëria sipasi objektivave të PMIM

Enë kompostuese	291	50	14 550 €	Komuna synon të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për tu depozituar në deponi përmes aktivitetit të (ndarjes në burim) të fraksionit organike për zbatimin e aktivitetit të kompostimit. Zbatimi i skemës së kompostimit të fraksionit të thatë do të nisë në 291 amvisëri në zonë rurale (fshatrat më në largësi) ku synohet rreth 40% e gjenerimit ditor në këto amvisëri të reduktohet; duke nënkuptuar reduktim të kostove operative dhe të deponimit.	02: Rritja graduale e mbulueshmërisë me shërbime në tërë teritorin e komunës së deçanit me qëllim të mbulimit të plotë deri në fund të vitit 2019.
Ndërtimi i qendrës për kompostim			300 000	Plotësimi i qendrës me pajisje operative për aktivitetin e kompostimit respektivisht, mjete motorrike, pajisje për kositje masive dhe për pastrim të hapësirave pyjore, pajisje grumcuese, sita sipas dimensioneve etj.	04: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi 0.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organike
Kontenierë për grumbullim të mbetjeve organike 3-5 ton	3	3000		Me qëllim të furnizimit të njësisë për kompostim me material organik prej mbetjeve të fruta perimeve, komuna parasheh vendosjen e kontenierëve të mëdhenj në tregun e fruta perimeve apo në biznes që ka gjenerim të kësaj kategorie të mbeturinës. Kjo ndihmon në aktivitetin e kompostimit dhe përfitimit të plehut cilësor si produkt final.	04: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi 0.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organike
Pajisje qendrën e riciklimit dhe optimizim shërbimi			450 000	Plotësimi me pajisje për zhvillimin e aktivitetit të riciklimit në qendër do të konsistojë në blerjen e shiritit asortues, pajisje për ballim, larje dhe grimcim të mbetjeve të riciklueshme sipas llojit. Kjo qendër paraprin planeve afatgjata për zgjerim të skemës së ndarjes në nivel territori komunal si potencial edhe për bashkëpunim me komunë tjetër e interesuar të zbatojë politika të ngjajshme. Aktiviteti i riciklimit në shkallë të gjerë përpos se redukon kostot e transportit dhe deponimit krijon mundësinë për gjenerim të të hyrave për ndërmarjen komunale.	04: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi 0.4.4 Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme 0.4.5 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme-fraksioni të thata

					O.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organike O 5: Mbulimi i kosto nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit dhe trajtimit të mbeturinave
Totali Kosto Investive në 2025			767 550€		

11 PLANIFIKIMI I MBULIMIT TË KOSTOVE

Qëndrueshmëria financiare e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave do të mbështetet në faktorët e mëposhtëm:

1. Efektivitetin e organizimit të shërbimit,
2. Eficiencën e kosto së shërbimit,
3. Efektivitetin e monitorimit të shërbimit,
4. Sistemin e tarifimit nëpërmjet të cilit mbulohet kosto e plotë e shërbimit,
5. Efektivitetin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e shërbimit.

Secili prej tyre është faktor kyç për të gjithë ciklin e menaxhimit financiar të shërbimit; kjo do të thotë se mbarëvajtja në lidhje me njërin mund të ndihmojë të gjithë ciklin, sikurse mos përmbushja e tij mund ta pengojë operimin e rregullt të kompanisë.

Të katër faktorët të cilët përcaktohen nga efektiviteti dhe eficiencëa, janë parime udhëheqëse të planifikimit të shërbimit të kryer në Komunën e Deçanit për vitet në vijim; kjo do të thotë se sistemi i organizimit të shërbimit, monitorimit të tij dhe i mbledhjes së të ardhurave në këtë plan janë parashikuar të sigurojnë efektivitet të ciklit të plotë të shërbimit dhe eficiencën të kosto së tij. Gjithashtu, qëndrueshmëria financiare do të varet nga aftësia e burimeve njerëzore për përmbushjen e këtyre faktorëve.

Sa i përket faktorit të katërt, një sistem tarifimi nëpërmjet të cilit mbulohet kosto e plotë e shërbimit, lidhur me këtë komuna e ka hartuar rregulloren lidhur me tarifën e aplikuar në cili mbulon vlerën e kosto së shërbimit.

Megjithatë meqenëse inkasimi realizohet prej NPL "Higjiena" aftësia e burimeve njerëzore të kompanisë për të funksionalizuar në mënyrë efikase sistemin e tarifimit është përcaktuese për qëndrueshmërinë financiare të shërbimit. Sipas të dhënave të ofruara shkalla e inkasimit në bizneset është e vogël dhe kjo mundet të ndikojë në qëndrueshmërinë e shërbimit në të ardhmen. Atëherë politikë për tu adresuar për NPL Higjiena mbetet rritja e inkasimit në bizneset përmes gjenerimit të faturës sipas listës së bizneseve aktive në komunë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e nevojshme për përlogaritjen e të hyrave në vite për subjektet pagues për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.

Si vit referent do të merret planifikimi 2019 dhe do të bëhen përlogaritjet sipas të dhënave të ofruara prej NPL Higjiena sipas numrit të amvisërive residente dhe jo residente si dhe bizneseve aktive në komunë dhe të hyrave të planifikuara prej shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.

Tabela 37. Projektioni i të hyrave të shërbimit prej MM

Komuna Qyteti/Fshat	Klientë të faturuar = shërbyer			Klientë të shërbyer					Totali në shërbi m
	Amviseri	Bisnese	Insitucione	Ek familjare joresidend	Bisnese Vogla-mesme- medha			Insituci one	
Deçan	4810	409	34	1539	V	M	M/I	34	---
Të hyra të inkasuara prej shërbimit(vjetore)		18% inkasim	43,966.91 €		521	1575	158	43,966.9 1	
Të hyra të planifikuara prej shërbimit 100% (vjetore)	268.398 €		43,966.91 €	18.468 €				43,966.9 1 €	
% e inkasimit të tarifës së shërbimit 2019	286.866 €	230.576*€	43,966.91 €						

*Përlogaritja prej bizneseve është bërë me marzhe racionale duke llogaritur shkallën e inkasimit më shkallën e faturimit

Tabela 38. Projektioni i të hyrave të shërbimit/Inkasimi

Komuna			Kliente totale (te dhena prej komunes)		TOTAL
Qyteti/Fshat		Ekonomi familjare	Bisnese.	Insitucione	
Deçan		6,349	2250 (referent 18% faturim)	34	
		286.866 €	230.576*€	43,966.91 €	
Të hyrat e NPL Higjiena (vjetore dhjetor 2019)	2019	77,101.32€	41,913.71€	43,966.91€	162,981.94
Të hyrat e NPL Higjiena	2020	186,187.94 70%	41,913.71€ %	43,966.91€	272,068.56
Të hyrat e NPL Higjiena	2021	229 492 80 %	195 989 85 %	43,966.91€ 100%	469 447.91
Të hyrat e NPL Higjiena	2022	243 836 85 %	207 518 90 %	43,966.91 100%	495 320.91
Të hyrat e NPL Higjiena	2023	272 522 95%	207 518 90%	43,966.91€	524 006.91
Të hyrat e NPL Higjiena	2024	272 522 95%	219 047 95%	43,966.91€	535 535.91

Në tabelën më sipër janë paraqitur vlerat e të ardhurave të planifikuara për t'u realizuar nga tarifat e përlogaritura dhe sipas numrit të familjeve, bizneseve dhe institucioneve të vendosura në komunën e Deçanit.

Referuar planifikimeve vetëm prej shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të hyrat prej shërbimit prej vitit 2020 do të mund të mbulojnë koston e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave dhe prej vitit 2021-2025 NPL Higjiena siguron kapacitet me të hyra vetanake për investime capital për përmirësim të eficiencës së shërbimit. Në këtë llogaritje nuk përfshihen aktivitetet sekondare të kompanisë të cilat balancojnë financiarisht koston e shpenzimeve dhe investimeve prej kompanisë. Sistemi tarifor i aplikuar sipas rregullores komunale mundëson mbulimin e koston së shërbimit në masën 100 % me të ardhurat nga tarifa, duke filluar që në vitin 2020. Në fund të çdo viti, buxheti financiar i shërbimit duhet të rezultojë i balancuar, tërësisht me burime të të ardhurave prej inkasimit dhe kontrata tjera të kompanisë.

Krahas të hyrave prej tarifës së shërbimit, aplikimi i sisteme të trajtimit të mbeturinave në vitet në vijim do të synojë të zvogëlojë kostot operative të kompanisë dhe të gjenerojë të hyra përmes aktivitetit të sortimit dhe riciklimit apo kompostimit në të ardhmen. Gjithashtu vlen të ceket që drejtimi i politikës komunale në menaxhim të mbeturinave do të harmonizohet me objektivat e përcaktuara prej nivelit qendror përmes Strategjisë Kombëtare për Menaxhim të IntegrUAR të Mbeturinave që përkojnë me reduktimin e mbeturinave sipas parimit të hierarkisë dhe zvogëlimit të ndotjes. Kjo do të nënkuptojë që kostoja e investimit do të bazohet në politikat dhe mundësitë për investim prej komunës përmes mjeteve vetanake, nivelit qendror dhe donatorëve të huaj. Mundësitë e zhvillimit të projekteve për menaxhim të integruar të mbeturinave në nivel Rajonal do të mund të jenë favorizuese për Komunën e Deçanit duke synuar përmbushjen e objektivave sipas Strategjisë Kombëtare referuar politikave për reduktim dhe riciklim të mbeturinave.

Mëgjithatë, në një projektion të përlogaritjes së gjenerimit të të ardhurave prej aktivitetit të riciklimit në nivel territorial kjo do të nënkuptonte:

Tabela 39. Projektioni i të ardhurave prej skemës së ndarjes në burim në nivel territorial

Projeksioni i rritjes së popullsisë Nr popullsisë	Vlera referente	43 074	43 504	43 939	44 378	44 822	45 270	Cmimi referent 2019*
Potenciali i gjenerimit të sasisë totale të mbeturinave ton/vit		9 360 ton	10 321	10 585	10 950	11 288	11 633	
Koeficienti i gjenerimit të mbeturinave për koke banori		0.64	0.65	0.663	0.676	0.69	0.704	
Fraksioni Organik	~ 0.41	3.838	4,232	4,340	4,490	4,628	4,769	
Fraksioni të thata	~ 0.33	3 089	3,406	3,493	3,613	3,725	3,839	234 080
VLERA E SHITJES		234 080	258 101	264 694	273 788	282 275	290 913	

*Çmimet e shitjes së materialeve të riciklueshme variojnë prej bursës ndërkombëtare sipas kërkesës së tregut. Në një përlogaritje me çmimet referente të vitit 2019 do të mund të llogarimisim çmimin për materialin plastikë (120 euro/ton), letër (40 euro/ton), alumin (180 euro/ton). Sipas përbërjes në një vlerë mesatare për këtë fraksion nënkuptojmë se:

Tabela 40. Kosto referente sipas tregut të shitjes të materialit të riciklueshëm

Mbeturina	%	Sasia ditore sipas fraksionit	Sasia ditore	Sasia vjetore Komuna Deçan	Kosto shitje Euro
		~	Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë)	(ton/vit/2020)	
Totali mbeturina	100.00%	0.64 kg/ditë	~19 kg/muaj	9 360	
<u>Organike</u>	40.87%	~ 0.41	7.8 kg	3.838	
<u>Të riciklueshme⁷</u>	33.24%	~ 0.33	6.27 kg	3089	
Leter / Karton	12.83%	0.13	2.47 kg	1217	48 680*
Plastike	14.78%	0.15	2.85 kg	1404	168 480*
Qelq	4.45%	0.04	0.76 kg	374	
Metale	1.18%	0.01	0.19 kg	94	16 920*
Te tjera	25.89%	~ 0.26	~4.93 kg	2 433	

*Çmimi refert I shitjes (2019) për plastikë 120 euro/ton, letër (40 euro/ton), alumin (180 euro/ton).

12 KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

12.1 Rregullorja komunale

Komuna e Deçanit posedon rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave, ku përcaktohet qartë roli dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbeturinave, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbeturinave, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht, meqënëse komuna synon të zhvillojë planë për administrimin e qëndrueshëm të mbeturinave dhe të funksionalizojë qendra për trajtimin e rrymave të veçanta, kjo rregullore udhëzohet që të përfshijë:

- Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbeturinave;
- Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbeturinave;
- Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve të veçantë sipas programeve për reduktim dhe riciklim, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;

j. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbeturinave sipas programëve për reduktim dhe riciklim të aplikuar prej komunës (kompania publike apo operatorë të tjerë të mbeturinave, industria e mbeturinave)

- Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të licencuar;
- Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm sipas planit për ndarje në burim;
- Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit dhe rregullat për depozitim;
- Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
- Regjistrimi i konsumatorëve që aplikojnë masa për reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave;
- Mbajtja e të dhënave historike për mbeturina prej operatorit publik në vendlokacionet e depozitimit apo shkarkimit dhe pranimi të përkohshëm të mbetjeve të riciklueshme, vellimshme, inerte;

12.2 Zbatimi i rregullores dhe sanksionet

Rregullorja lokale për menaxhim të mbeturinave shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Kuvendi Komunal. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin "ndotësi paguan", ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbeturinave, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për shkurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët komunalë që janë nën juridiksionin e komunës. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbeturinave.

12.3 Licencimi mjedisor

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor në nivel vendi do të kërkojë përmirësime në sistemin e licencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. Sipas legjislacionit kombëtar:

- Komunitat duhet të bashkëpunojnë me nivelin qendror kur miratojnë të ushtrojnë veprimtari apo projekt për administrimin e mbeturinave;
- Komuna duhet të marrë miratimin prej nivelit qendror për vendet e depozitimit të mbeturinave të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore;
- Të kontrollohet vazhdimisht përmbushja e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbeturinave (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-urbane).

12.4 Pjesëmarrja e sektorit privat

Ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e menaxhimit të mbeturinave, sipas parimeve ku:

- Sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare;
- Skemat e minimizimit të mbeturinave që kërkojnë financime në teknologji (makineri dhe kontenierë) mund të jenë shumë të përshatshme për një bashkpunim PPP;
- Aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve të komunës;

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbeturinave voluminoze, mbeturinave të riciklueshme apo dhënia me koncension e impianteve apo aktiviteteve për trajtimin mbeturinave, duhet të shihet si një

mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbeturinave. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore. Në të gjitha situatat komuna duhet të vendosë standarte të ofrimit të shërbimit, të monitorojë performancën periodike të shërbimit të ofruar duke pasur autoritetin e plotë të penalizimit konform kontratave.

Sektori privat mund të marrë pjesë në secilën nga veprimtaritë e administrimit të mbeturinave të ngurta, siç jepet edhe më poshtë:

- Ofrimi i kamionëve apo makinerive të rënda për trajtim të mbetjeve inerte apo mbetje tjera të vëllimshme. – me qira ose marrëveshje qiraje me pronarët e pajisjeve
- Pastrimi i akseve rrugore dhe zonave pyjore për zhvillimin e aktiviteteve të trajtimit të këtyre mbetjeve – me kontratë shërbimi
- Ofrimi i kontenierëve të posaçëm për skemat e minimizimit të mbeturinave
- Operimi i qendrave të ndarjes – me kontratë shërbimi ose koncesion

12.5 Mbështetja politike

Manaxhimi i mbeturinave dhe pastërtia e qytetit duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për qytetin dhe banorët e tij dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Kuvendi Komunal për të arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë kuvendi komunal duhet të shikojë me prioritet mbështetjen e projekteve, iniciativave lokale për modernizimin e këtij sektori, përmirësimin e buxhetit, investimet, dhe nga ana tjetër komuna duhet të sigurojë transparencën maksimale ndaj kuvendit dhe publikut për të gjitha veprimet që ajo ndërmerr.

Kjo marrëdhënie reciproke do të mundësojë paanësinë politike për çështjet që lidhen me mjedisin dhe pastërtinë e qytetit. Mbetet detyrë e stafit të komunës sipas kompetencave të drejtorisë dhe sektoreve tjerë që këtë çështje t'ia argumentojë dhe adresojë në mënyrë profesionale kuvendit komunal me qëllim marrjen e dakordësisë në miratimin e zbatimit të planeve të menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave si dhe buxhetin përkatës për zbatimin e tij.

13 NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të manaxhimit të mbeturinave, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në qytet, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë funksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. Suksesi i çdo skeme riciklimi bazohet plotësisht nga mbështetja e qytetarëve. Konsumatorët si : familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushatë të vazhdueshme ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të mbledhjes, duke zbatuar kërkesat të hedhjes dhe ndarjes së mbeturinave dhe duke penguar materialet e padëshirueshme (psh. mbetjet e rrezikshme), të hyjnë në rrjedhën e mbeturinave të mbledhura. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbeturinave dhe pastërtisë së qytetit, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbeturinave.

Ka disa mënyra për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbeturinave dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektive për arritjen e objektivit. Kjo mund të arrihet duke hartuar një plan ndërgjegjësimi i cili do të mundësojë: i) ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat e komunës të mbledhjes, riciklimit të mbeturinave, pastërtisë së qytetit dhe koston e shërbimit të menaxhimit të

mbeturinave; ii) ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore; ii) nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

13.1 Metoda për komunikim dhe informim

Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesit në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të re) mund të jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe të kostos së ulët si edhe shpejtësisë që ofron. Gjithashtu mund të shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme (festa, tubime, koncerte), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë.

Në programet e riciklimit apo minimizimit të mbeturinave metoda më e mirë është ajo “derë më derë”. Kjo metodë fton konsumatorët në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbeturinave në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret. Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për llojet e mbeturinave që mund të riciklohen, kompostohen dhe mënyrën se si ato duhet të veprojnë për t’u bërë pjesë e procesit.

Përdorimi i komputatorëve apo makinave të tjera që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave apo kontenierët për informim mbetet një detaj tjetër i cili përmban impact vizuel për qytetarë. Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbeturinave duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme një slogan domethënës për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

13.2 Pjesëmarrje qytetare

Një çështje tjetër e rëndësishme është krijimi i mekanizmave për marrjen e mendimeve dhe reagimit të qytetarëve: si mund të ftohet publiku t’i japë institucioneve komunale mendime apo opinione ose komente për shërbimin e mbeturinave.

Dy metodat kryesore për të marrë mendimin e publikut janë:

- Mundësia e publikut për t’u ankuar: komuna apo operatori i shërbimit duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacionit për të marrë ankesat. Numri i ankesave dhe zgjidhja e tyre është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbeturinave.
- Vlerësimi i kërkesës dhe sondazhi/studimi i “vullnetit për të paguar”: Për të vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë për të paguar, është e nevojshme të komunikohet me përfituesit e mundshëm të shërbimit lidhur me alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin dhe tarifat. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t’u përfshirë në sondazh, mostra që duhet të realizohet është midis 100 dhe 200 të intervistuar. Kjo praktikë duhet të kryhet në periodikisht nga komuna, ose sa herë ajo e shikon të arsyeshme për të marrë opinionin e publikut në lidhje me vlerësimin e performancës të shërbimit.

14 PLANI VEPRIMIT

Objektivi Strategjik	Veprimet e parapara	Përgjegjësitë	Afatet kohore
1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove dhe shërbimit në komunën e Deçanit.	1.1. Sigurimi i kontejnërve për 1500 amviseri rezidente në zonat urbane dhe rurale	Komuna Deçan, Kuvendi komunal	2021
	1.2. Përgaditja e listave të amvisërive për furnizimin me kontejner	NPL Higjiena	
	1.3. Informimi publik i amvisërive për furnizimin me infrastrukturë	Komuna Deçan NPL Higjiena	
	1.4. Shpërndarja e kontejnerëve nëpër amvisëri	NPL Higjiena	
2. Ndarjen e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit	2.1. Prokurimi i kontejnerëve për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme, 500 copë 280 l dhe kontenierë për sistem të përbashkët 10 copë	Komuna Deçan, Kuvendi komunal	2021-2025
	2.2. Përgatitja e koncept planit për organizmin e sistemit të ndarjes së mbetjeve në zonat pilot fillimisht me 500 amvisëri për nisjen e ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në burim	Komuna Deçan,	
	2.3 Përfshirja graduale e të gjitha institucioneve shkollore në procesin e ndarjes.	Komuna Deçan	
	2.3.1 Krijimi i klubeve ekologjike në shkollë		
	2.4 Kontraktimi i kompanisë për kampanjën e vetëdijesimit	Komuna Deçan NPL Higjiena	
	2.5 Zhvillimi i kampanjes së vetëdijesimit dhe informimit për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim		
	2.5.1 Zhvillimi kampanjës së vetëdijesimit për grumbullim të ndarë të mbetjeve të vëllimshme sipas aksioneve mujore/stinore të kompanisë	Komuna Deçan	
	2.5.2 Përcaktimi i orarit të grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme sipas kërkesave/kontratave dhe informimi qytetar		

	2.5.3 Përcaktimi i tarifës së grumbullimit për mbetje të vëllimshme dhe informimi qytetar		
	2.5.4 Përcaktimi i orarit për grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme dhe informimi qytetar		
	2.6 Sigurimi i kamionit të vecant për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	
	2.6.1 Krijimi i njësisë operative për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme		
	2.7 Përcaktimi i lokacionit për deponim dhe trajtim të mbeturinave të riciklueshme		
	2.8 Përgatitja e dokumentacionit për sigurimin e pëlqimit mjedisr		
	2.8 Shpërndarja e kontejnerëve për riciklim	Komuna Deçan NPL Higjiena	2021; 2022;2023; 2024; 2025
	2.9 Monitorimi i procesit të ndarjes në burim	Komuna Deçan NPL Higjiena	2021
	2.9.1 Përgatitja e planit të operimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme		
	2.8 Zgjidhja e formes dhe sigurimi i tregut për shitje të mbetjeve të riciklueshme		
	2.10 Rregullimi i lokacionit për trajtimin e mbetjeve te riciklueshme	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2020-2023
	2.10.1 Sigurimi i pajisjes për paketimin e mbetjeve te riciklueshme		
	2.10.2 Sigurimi i shiritit për selektimin e mbetjeve te riciklueshme		

	2.10 Përcaktimi i zonës së dytë për zgjerim në ndarjen e mbeturinave të riciklueshme, 500 amvisëri në zonë urbane dhe sub urbane;	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2022
	2.11 Prokurimi i kontenierëve për riciklim sipas sistemit parësor dhe dytësor . 500 shporta 280l dhe 20 kontenierë rrjetë/ 1.1m3 ngjyrë e verdhë		
	2.10.1 Kontraktimi i kompanivë për vetëdijesim		
	2.10.2 Zhvillimi i kampanjës së vetëdijesimit dhe informimit për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim		
	2.10.3 Shpërndarja e kontejnerëve për riciklim		
	2.10.4 Monitorimi i procesit të riciklimit		
	2.10.5 Rishikimi i planit të operimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme		
	2.10.6 Rishikimi i planit operativ për grumbullimin e mbeturinave të përgjithshme		
	2.11 Përcaktimi i zonës së tretë për zgjerim në ndarjen e mbeturinave të riciklueshme, 2800 amvisëri në zonë urbane apo rurale	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2023-2025
	2.11.1 Kontraktimi i kompanivë për vetëdijesim		
	2.11.2 Zhvillimi i kampanjës së vetëdijesimit dhe informimit për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim		
	2.11.3 Shpërndarja e kontejnerëve për riciklim		
	2.11.4 Monitorimi i procesit të riciklimit		
	2.11.5 Rishikimi i planit të operimit për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme		
	2.11.6 Rishikimi i planit operativ për grumbullimin e mbeturinave të përgjithshme		
3. Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të riciklueshme brenda territorit të komunës	3.1 Caktimi i zonës pilot dhe përgatitja e koncept planit për nisjen e ndarjes së mbeturinave organike në burim në 500 amvisëri në zonë urbane dhe rurale 3.1.1 Prokurimi i enëve kompostuese	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2023

	3.1.2 Kontraktimi i kompanisë për zhvillimin e kampanjës së vetëdijesimit dhe informimit për ndarjen e mbeturinave organike në burim		
	3.1.3 Shpërndarja e komposterëve		
	3.1.4 Monitorimi i procesit të kompostimit		
	3.2 Hartimi i koncept planit për zgjerimin e zonës për kompostim		
	3.2.1 Zgjerimi i zonës për kompostim në 971 amvisëri sipas dy fazave - kontraktimi i kompanisë për promovim	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2024-2025
	3.2.2 Zhvillimi i kampanjës së vetëdijesimit		
	3.2.3 Shpërndarja e komposterëve		
	3.2.4 Monitorimi i procesit të kompostimit		
	3.3 Prokurimi i 971 enëve kompostuese	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2023-2025
	3.3.1 Shpërndarja e komposterëve		
	3.3.2 Zbatimi i planit për vetëdijesim dhe informim		
	3.3.2 Monitorimi i procesit të kompostimit		
	3.4 Përgatitja e planit për ndërtimin e njësisë për kompostim dhe pajisja me leje mjedisore	Komuna Deçan, Kuvendi komunal	
	3.4.1 Përgatitja e termave specifike për pajisje		
	3.4.2 Prokurimi i pajisjeve për aktivitetin e kompostimit të centralizuar		
4. Të realizojë Grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi	4.1 Përgatitja e dokumentacionit për sigurimin e pëlqimit mjedisr	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2020; 2021;
	4.2 Rethimi i lokacionit për mbetje inerte dhe funksionalizimi bazik		
	4.3 Rregullimi i rruges për qasje në deponine inerte		
	4.4 Eliminimi i mbetjeve inerte ilegale në komunë sipas raportit 2019-2020		

	4.4.1 Kampanja informuese për mjedis të pastër dhe mbi grumbullimin e veçantë të mbetjeve inerte		
	4.4.2 Përcaktimi i orarit të pranimit të mbeturinave inerte		
	4.4.3 Përcaktimi i tarifës së depozitimit të mbetjeve inerte		
	4.5 Sigurimi i infrastrukturës për përpunimin e mbetjeve inerte	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2022-2023
	4.6 Krijimi i njësisë administrative për menaxhimin e deponisë së përkohshme inerte	NPL Higjiena	2023
	4.7 Kampanja informuese për mishtorët, therrëtorët, dhe fermat që të pajisen me kontejnera të vecantë për mbeturina shtazore	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2021
	4.8 Përcaktimi i modelit të operimit për grumbullim të veçantë të mbetjeve prej mishtoreve, therrëtorëve, ferma etj.	Komuna Deçan, Kuvendi komunal NPL Higjiena	2021
	4.8.1 Përcaktimi i tarifës së grumbullimit për mbetje të veçanta		
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës	5.1 Rishikimi i strukturës organizative të kompanisë Higjiena	DSHPSH NPL Higjiena	2020-2021
5.1 Mbulimi i kostos nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit	5.2 Trajnimi i stafit të kompanisë Higjiena sipas njësive		
5.2 Rritja e mbledhjes së të ardhurat prej tarifës së shërbimit	5.3 Rishikimi i bazës së të dhënave lidhur me klientët rezidentë dhe plotësimi i listave sipas numrit të klientëve në komunë		
	5.4 Zhvillimi i kampanjës së komunikimit për pagesën e tarifës së grumbullimit të mbeturinave		

Komuna Deçan

2020